

**25.05.2021
Ora 19:12**

RENDI I DITËS

Projektvendimi "Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 38, datë 09.05.2021 të subjektit ankues koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim PD-AN, për zonën zgjedhore Qarku Shkodër".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PD, LSI, PS

Z. E. Lako: Atëherë, riçelim seancën për shqyrtimin e ankimit nr.38 të subjektit ankues Partia Demokratike e Shqipërisë me objekt kundërshtimin e vendimit nr.342, datë 04.05.2021, për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin në zonën zgjedhore Qarku Shkodër. Në seancën e kaluar kërkuan dy anëtarë të komisionit për të dhënat e kryqëzuara për Qarkun Shkodër nga sistemi PEI. Për këtë shkak ne shtymë seancën për ditën e sotme. Mesa jam në dijeni këto të dhëna kanë dalë, palët kanë marrë nga një kopje të këtij rezultati apo jo zoti Sekretar i Përgjithshëm!

Z. Y. Merkaj: Po, e kemi shpërndarë një kopje.

Z. E. Lako: Atëherë, do ju lutesha subjektit ankues partia Demokratike nëse keni diçka në lidhje me këtë provë.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. M. Logu, Përfaqësues i PD-së: Faleminderit! Zoti kryesues i seancës prova që ne kemi marrë nga ana e administratës së Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve në fakt flet për 13 shenja gishtërinjsh që janë përdorur për identifikimin e 34 zgjedhësve, që ka potencialisht siç kemi thënë edhe në raste të tjera, ndjekim sërish të njejtën logjikë e cila në vlerësimin tonë do të thotë që potencialisht 13 persona kanë votuar 34 herë siç provohet nga dokumenti që na është dhënë në dispozicion. Në momentin që do parashtrojmë ose do të relatojmë konkluzionet tona përfundimtare sigurisht që do të përmendim arsyet pse e kërkuam marrjen e kësaj prove çka kërkon të vërtetojmë me të, dhe si ne kërkojmë të vlerësohet nga ana e Komisionit Ankimeve dhe Sanksioneve kjo provë. Kështu që falenderojmë administratën zgjedhore për vënien në dispozicion të kësaj prove në një kohë të shkurtër ne mendojmë që jemi gati për të kaluar në fazën e konkluzioneve përfundimtare në qoftë se nga ana e subjektit Lëvizja Socialiste për Integrim nuk ka kërkesa të tjera procedurale, faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Logu! Nga ju Zoti Kaziaj?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit zoti Lako, dhe ne jemi njohur me dokumentin që na është vënë në dispozicion nga administrata për kryqëzimin e të dhënave të identifikimit elektronik për Qarkun Shkodër. Ashtu siç tha edhe kolegu raste e dyshuara janë 13 që potencialisht kanë votuar për një numër më të lartë personash. Kjo në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor po ashtu edhe me ligjin penal të themi. Falenderojmë sekretarin e përgjithshëm që na e ka vënë në dispozicion, faleminderit.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. E. Lako: Gjithë këto falenderime që ka marrë zoti sekretar përgjithshëm mos bie në sy kam hall. Mirë anëtarët e KAS?

Z. M. Logu, Përfaqësues i PD-së: Mendojmë që është e rëndësishme të themi që në këtë punë intensive që po bëhet këtu këto ditë të thuhet edhe fjalë vlerësuese kur puna kur bëhet siç duhet apo jo.

Z. E. Lako: Patjetër, kjo është kryesorja. Nga anëtarët e KAS ka ndonjë koment mbi provën e paraqitur. Nga palët zoti Logu tha që nuk kanë kërkesa të tjera nga subjekti tyre ka ndonjë kërkesë tjetër para se të japim.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Nuk kemi zoti Lako!

Z. E. Lako: Faleminderit! Atëherë ftojme palët për pretendimet përfundimtare zoti Logu do ju lutesha pa ju ndërhyrë në disponimin e pretendimeve që për ato raste që i kemi dëgjuar disa herë dhe gjatë ditës së sotme nëse janë të njëjta të fokusohemi tek pjesa që ka të bëjë me Qarkun e Shkodrës ekskluzive. Ju e dini vetë pastaj se si, faleminderit.

Z. M. Logu, Përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Lako, konkluzionet tona përfundimtare janë në 7 faqe, kanë tre kopje për Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve. Me lejen tuaj në qoftë se mund të afrohem për ti vënë në dispozicion. Me lejen tuaj zoti kryesues i seancës në qoftë se mund të fillojmë. Atëherë Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim ka paraqitur në datën 09 maj 2021, një kërkesë ankimore në të cilën ka kërkuar kundërshtimin e vendimit nr.342, datë 04.05.2021, për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin në zonën zgjedhore Qarku

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Shkodër. Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve, të zhvilluara në datën 25 prill 2021, në zonën zgjedhore Qarku Shkodër për Kuvendin e Shqipërisë dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve në këtë zonë zgjedhore. Ne kemi pasur mundësi gjatë këtij procesi të vemë në dispozicion të këtij komisioni të gjitha shpjegimet tona në mënyrë të detajuar lidhur me ato shkelje të cilat ne i kemi vlerësuar mjaftueshmërisht të rënda për të përmbushur kushtet dhe kriteret ligjore që ka parashikuar neni 160 dhe 161, të Kodit Zgjedhor. Lidhur me pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Qarkun Shkodër. Ne po ashtu, kemi vënë në dispozicion të këtij komisioni të gjitha provat që kemi pasur në dispozicion në numrin 29 prova. Të cilat në vlerësimin tonë faktonin ose provonin ato që ne kemi ngritur e kemi pretenduar në këtë proces. Sigurisht e kemi thënë dhe i qëndrojmë po themi, faktit që ne në disa raste kemi pasur vetëm fillimet e provave dhe prandaj i kemi kërkuar nga ana e këtij komisioni që në përputhje me nenin 136 dhe 137 të Kodit Zgjedhor të merreshin prova të tjera të cilat jemi të bindur që në qoftë se kjo kërkesë plotësisht ligjore në vlerësimin tonë do të pranohej atëherë do kishim pasur mundësi të gjithë këtu të flitnim dhe të zbardhnim të plotë në atë që ne e kemi konsideruar masakrën zgjedhore të 25 Prillit. Sepse vlerësojmë se shkeljet kanë qënë shumë të rënda. Thatë me të drejtë zoti kryesues i seancës se tipologjitë e shkeljeve që ne kemi vërejtur dhe që kemi pasur mundësi ti parashtrojmë përpara këtij komisioni përpara të gjithë opinionit publik janë të ngjashme, sepse të tilla janë vërejtur qark pas qarku po sigurisht që aktorët shpesh herë ndryshojnë faktet dhe rrethanat ndryshojnë dhe sigurisht në këtë proces, ne kemi pasur mundësi kështu që do përpiqemi maksimalisht që të shmangim çdo lloj përsëritje ndoshta duke shkurtuar por duke thënë atë fakt që ne i vlerësojmë të rëndësishme për ti relatuar edhe në këtë proces. Ne kemi parashtruar në fakt përpara këtij komisioni duke besuar në drejtësinë e vendimarrjeve të tij se shtetasi Benet Beci kandidat për deputet i Partisë Socialiste dhe njëkohësisht Drejtor i Përgjithshëm

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

i Korporatës Elektroenergjitike Shqipëtare. Shtetasi Tom Doshi, kandidat për deputet dhe kryetar i Partise Social Demokrate. Shtetasi Mark Gjonaj kryetar i Bashkisë Pukë. Shtetasi Fran Tuci kryetar i Bashkisë Fushë-Arrëz. Shtetasi Mark Babani kryetar i Bashkisë Vau i Dejës dhe shtetasi Mark Frroku ish deputet i skeduar për rekorde të rënda kriminale në bashkëpunim me shtetas të tjerë drejtues lokal të institucioneve qendrore apo vendore përfaqësues të Partisë Socialiste apo individ me rekorde kriminale, kishin ngritur në Qarkun e Shkodrës përgjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 25 prillit, një strukturë kriminale të blerjes së votave nëpërmjet parave, ndihmave ushqimore, kuponave të Kartave të Identitetit dhe dhënies së përfitimeve por edhe nëpërmjet kërcënimeve, shantazheve dhe presioneve ndaj votuesve. Për këtë qëllim,

Partia Demokratike ka depozituar pranë Prokurorisë së Posaçme, kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar tre kallëzime penale të cilat ne kemi pasur mundësi ti relatojmë. Ne kërkuam nga ana e këtij komisioni që të merrej informacion në cilësinë e provës, informacion zyrtarë, se çfarë kishte ndodhur me këto kallëzime të cilat ishin rezultatet e tyre? çfarë provash kishin prodhuar deri më tani? Pasi vlerësojmë se marrja e këtij informacioni do ju kishte shërbyer edhe ju të gjithë ne në fakt por veçanërisht komisionit për një vendimarrje më të drejtë lidhur me kërkesën ankimore paraqitur nga partia Demokratike Aleanca për Ndryshim. Është fakt evident dhe besoj që të gjithë kemi pasur mundësi ta konstatojmë se fenomeni i shitblerjes së votës ka qënë kaq shumë prezent në Qarkun e Shkodrës, sa vetë misioni i OSBE ODIHR pavarësisht se deklaroi që në fillim që ka pasur një numër shumë të kufizuar vëzhguesish ka qënë vetë dëshmitare e rasteve të shpërndarjes së parave në qendra votimi. Kjo në fakt e thënë po në këtë mënyrë nga raporti paraprak që është prodhuar për zgjedhjet e 25 prillit. Ne po ashtu të nderuar kemi parashtruar përpara jush një sërë vendimesh të Këshillit të Ministrave por edhe të organeve lokale të cilat

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

në kundërshtim me nenin 91, të Kodit Zgjedhor synonin të sillnin përfitime për katëgoritë të caktuara me qëllim pastaj tjetërsimin ose manipulimin e vullnetit të zgjedhësve. Nga ana tjetër ne kemi vënë në dispozicion dhe kemi parashtruar përpara këtij komisioni faktin se si tenderat, konçesionet, PPP-të dhe prokurimet publike u përdorën me qëllim tjetërsimin dhe manipulimin e vullnetit të zgjedhësve. Kemi parashtruar raste se si shtetas me rekorde kriminale, të cilat vepronin në zona të caktuara kanë përfituar nëpërmjet kompanive të tyre të cilat nuk kanë asnjë lloj aktiviteti tjetër përveç tenderave dhe kontratave publike. Kanë përfituar kontrata publike dhe tendera në vlera shumë të larta siç është rasti i shtetasit Pëllumb Gjoka, në zonën e Velipojës, i cili vetëm nga Bashkia Tiranë, ka përfituar kontrata publike në vlerën 1.6 milion euro. Kemi parashtruar përpara këtij komisioni faktin se si punonjësit e administratës publike veçanërisht të Bashkisë Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë, Vau Dejës apo Fushë-Arrëz u kërcënuan, u intimiduan dhe u vendosën në presion të vazhdueshëm për të vota në mbështetje për Partinë Socialiste. Kemi parashtruar faktin se pati punësime masive qoftë në institucionet qendrore apo vendore si dhe në Bashkitë e Qarkut të Shkodrës dhe kërkua nga ana e këtij komisioni për të provuar se sa kishin qënë përmasat reale të këtij fenomeni të merreshin në cilësinë e provës të dhëna dhe informacione zyrtare nga institucione që ne i kishim spicifikuar në Qarkun e Shkodrës. Kemi parashtruar po ashtu se ndihma ekonomike ishte një tjetër mjet që u përdor nga partia në pushtet për të ndikuar drejtpërdrejt në vullnetin e zgjedhësve. Po ashtu kemi parashtruar përpara këtij komisioni faktin se si Lejet e Legalizimit dhe Lejet e Ndërtimit u përdorën masivisht nga Partia Socialiste për ti përkthyer në vota dhe mbështetje për të dhe për kandidatët e saj. Kemi parashtruar me fakte dhe prova, faktin se si kandidatët e Partisë Socialiste sillleshin në Qarkun e Shkodrës ashtu si dhe në qarqe të tjera sikur të ishin ata drejtuesit e zyrave vendore të Agjensive të Kadastrës në këto qarqe. Duke premtuar

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Leje Legalizimi duke shpërndarë Leje Legalizimi apo Certifikata Pronësie për pronat e qytetarëve. Kemi parashtruar përpara këtij komisioni shkelje të rënda siç janë ato që kanë të bëjnë me të dhënat personale siç është vendimi i komitetit teknik të ekspertëve për karantinimin 2 javor të emigrantëve, i cili ju hoqi të drejtën 500 mijë shtetasve shqiptarë. Kemi parashtruar faktin se një vendimarrje në vlerësimin tonë në kundërshtim me nenin 98, të Kodit Zgjedhor dhe pikat 27 dhe 49 të Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore të komisionit të Venecias prodhoi në Qarkun e Shkodrës 6114 fletë votimi ose 5.3% të totalit të fletëve. Kjo në fakt është veçanërisht e rëndësishme për Qarkun e Shkodrës, ku diferenca ndërmjet Partisë Demokratike dhe Partisë Socialdemokrate për mandatin e 6 dhe mandatin e dytë të kësaj force është rreth 2000 vota. Jemi të bindur se me një fletë votimi e cila do kishte qënë në përputhje me kriteret ligjore këto vota do kishin ndryshuar rezultatin zgjedhor në këtë zonë. Ne i nderuar, kemi parashtruar përpara jush faktin se edhe në Qarkun e Shkodrës patëm denoncime të shumta nga qytetarë të ndryshëm, se pati raste të votimit të shumëfishtë, votimit familjar dhe votimit për të tretët. Fatmirësisht teknologjia na ka mundësuar që të arrijmë deri në një masë të caktuar. Sigurisht që teknologjia ka përmirësime dhe avancime të vazhdueshme të kuptojmë se sa janë përmasat reale të këtij fenomeni dhe kemi parë se si shenjat e gishtërinjve nga të dhënat që janë dhënë nga pajisjet e identifikimit elektronik të 13 personave janë përdorur për identifikimin e 34 zgjedhësve. Potencialisht këta 13 persona kanë votuar 34 herë ose rreth tre herë secili. Sigurisht hetimet e mëtejshme që po kryhen qoftë hetime administrative nga ana e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve apo nga ana e Prokurorive qofshin ato prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm apo juridiksionit të posaçëm. Të zbardhin të plotë se çfarë ka ndodhur në këto qendra votimi ku kanë ardhur të dhënat nga pajisjet PEI. Ne vlerësojmë të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve se jemi përpara rasteve të shkeljeve flagrante të ligjit.

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Qofshin këto blerje vote, përdorimit të shtetit, përdorimit të paligjshëm të të dhënave personale, mohimi i të drejtës së emigrantëve për të votuar, pavlefshmërisë së votave të 83 mijë zgjedhësve në kutitë e votimit apo rasteve flagrante të votimit të dyfishtë. Për secilën nga këto pretendime ne shjeguam ju vendosëm në dispozicion shpjegimet tona në një material voluminoz prej 51 faqesh dhe 29 prava, foto video dhe dokumenta. Kërkuam nga ana juaj në mënyrë të përsëritur disa herë plot 19 herë në rastin e Qarkut Shkodër që të zbardhej e plotë masakra zgjedhore e 25 Prillit. Kjo kërkesë në fakt u refuzua në vlerësimin tonë duke refuzuar kështu të drejtën jo vetëm një subjekt zgjedhor siç ishte Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim për transparencë për plot 272 mijë zgjedhësve në Qarkun e Shkodrës, të cilët duan të dinë se çfarë ndodhi në zgjedhjet e 25 Prillit. Sigurisht ne si subjekt zgjedhor të cilët jemi votuar nga 730 mijë zgjedhës si opozitë e bashkuar në të gjithë Shqipërinë apo 57 mijë zgjedhës specifikisht në Qarkun e Shkodrës kemi detyrë të ezaurojmë çdo mjet si dhe çdo frangë që kemi në dispozicion për të zbardhur të plotë të gjithë krimet zgjedhore që kanë ndodhur në zgjedhjet e 25 Prillit. Sigurisht që thjeshtë dhe vetëm vullneti i një partie politike është i pa mjaftueshëm. Ai kërkon dhe vullnetin e institucioneve të këtij komisioni dhe të institucioneve hetimore siç është rasti i prokurive i juridiksionit të përgjithshëm apo juridiksionit të posacëm. Megjithatë, i nderuar pavarësisht vërejtjes miqësore të zotit Bele, e cila në fakt është e pranueshme lidhur me faktin për respektin maksimal që ne kemi për profesionin e nderuar të Noterit, nuk mund të rri pa e përsëritur edhe në këtë rast se ju këtu keni në dispozicion mjetet e nevojshme ligjore për të noterizuar një paligjshmëri, një masakër zgjedhore që ndodhi në Qarkun e Shkodrës apo për të prodhuar në fakt një akt të ligjshëm që ka të bëjë pikërisht me shpalljen e pavlefshmërisë së këtyre zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre në Qarkun e Shkodrës. Është shumë e qartë dhe kjo është një gjë që ne e kemi thënë nga fillimi e do vazhdojmë ta themi që kjo nuk është vetëm

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

një betejë që thjesht kryhet për ju atje apo me gjithë respektin dhe konsideratën apo për ne këtu si subjekte zgjedhore. Por sigurisht që kjo është një betejë që bëhet për qytetarët shqipëtar. Për ata qytetarë që me 25 Prill i besuan Partisë Demokratike dhe Aleancës për Ndryshim, ndryshimin e situatës në Shqipëri. Ne vlersojmë se pretendimet që kemi ngritur me aq prova sa ne kemi patur në dispozicion janë faktuar dhe vërtetuar. Nuk mund të rrimë pa e thënë që fakti që nga ana e këtij komisioni, u mohuan, u refuzuan kërkesat tona për marrjen e provave në instiucionet, në organet e administratës publike. E bënë hetimin të mangët, e bënë hetimin të pa plotë, e bënë hetimin të cunguar, por shpresoj të mos jetë i tillë edhe vendimi. Pra shpresojmë që si një rezultat i një hetimi të mangët, të cunguar dhe të pa plotë të mos kemi dhe një vendim të cunguar, të pa plotë dhe një vendim që nuk do të provojë drejtësi. Prandaj në përfundim i nderuar dhe këtu dua ta mbyll, bazuar në nenin 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor, kërkojmë nga ana e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, që të shpallë pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25 Prill 2021, në Qarkun e Shkodrës dhe të urdhëroj përsëritjen e zgjedhjeve në këtë qark për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë, faleminderit!

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Logu, zoti Kaziaj nëse keni diçka?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po, zoti relator, të nderuar anëtar, ne jemi në diskutimet përfundimtare të pretendimeve që kemi për Partinë Demokratike si subjekte ankues edhe ne si palë e interesuar nëpërmjet ndërhyrjes dytësore që kemi bërë në këtë qark. Ndajmë të njejtat shqetësime që ka pasur dhe Partia Demokratike se këto janë shqetësime reale të vërtetuara në kuadër të procesit zgjedhor, të themi pothuajse në të gjithë Shqipërinë dhe Qarku i Shkodrës është një qark shumë i nxehtë, ku kanë ndodhur të gjitha faktet dhe argumentat e dhëna nga zoti Logu, dhe

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

për të cilin unë nuk do dua të përsëritem. Për sa i përket pjesës së thelbit të kërkesës, mbështesim në totalin e saj argumentat dhe objektin për të cilën kjo kërkesë është ngritur përpara këtij organi kolegjal. Kërkojmë nga ana juaj që të veproni me integritet, duke duke pranuar kërkesën ankimore të subjektit zgjedhor Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim, faleminderit.

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Kaziaj! Atëherë KAS do të tërhiqet për vendim në Dhomë Këshillimi, kështu që do ta ndërpresim seancën për ta rifilluar në 19:45.

Rifillon mbledhja

Ora 19:50

Z. E. Lako: Atëherë, bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara, mbështetur në shkronjën d të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr. 3 datë 6.11.2020 të Komisionit Rregullator KAS vendosi:

Rrëzimin e kërkesës ankimore ndr.38 datë 9.5.2021 të paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim.

Lënien në fuqi të vendimit nr.342 datë 4.5.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit të zonës zgjedhore Qarku Shkodër për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë të zgjedhur për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e tij.

Faleminderit! Atëherë, seanca tjetër siç e thamë më parë fillon nesër në orën 10 me ankimin për Qarkun Durrës me numërimin e QV-ve të kërkuara, faleminderit!

Vendimi nr.89

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



25.05.2021
Ora 17:15

RENDI I DITËS

Projektvendim "Shqyrtimi i kërkesave ankimore nr. 37, datë 09.05.2021 të subjektit ankues koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim PD-AN dhe nr. 46, datë 09.05.2021 të subjektit ankues Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore Qarku Durrës.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PD-AN, LSI

Z. K. Bele: Riçelim seancën e shqyrtimit të ankesës lidhur me Qarkun Durrës. Seanca është pezulluar lidhur me marrjen e dy provave të kërkuar nga dy anëtarët e nderuar të KAS. Provat i kemi mbi tavolinë, në dijeninë time i kanë edhe palët, zoti Logu dhe zoti Kaziaj keni marrë kopje të provave të kërkuara nga ana juaj?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po i nderuar kemi një kopje të provave që kemi kërkuar nga pajisjet PEI dhe verifikimin e anëtarëve e votuesve nga një listë që kemi vënë në dispozicion në komision.

Z. K. Bele: Në rregull, faleminderit! Besoj në këtë moment procedural do të vazhdojmë me diskutimin lidhur me provat e marra sipas kërkesës së palëve. Fjala për ju zoti Logu, dhe pastaj për zotin Kaziaj!

Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit i nderuar! Sa i përket të dhënave që janë marrë nga kryqëzimi i pajisjeve të identifikimit elektronik PEI shohim që ka pasur 4 raste, ose 4 persona të cilët me të njëjtin mjet identifikimi kanë votuar në 8 QV të ndryshme nga ana tjetër shohim që shenjat e gishtërinjëve të 34 personave janë përdorur për identifikimin e 71 zgjedhësve. Çka potencialisht dhe mbetet për t'u verifikuar sigurisht. Krijon dyshimin e arsyeshëm se 34 persona mund të kenë votuar 71 herë. Megjithatë kjo është një provë të cilën ne kemi pasur mundësinë t'a diskutojmë edhe në qarqet po themi provë e ngjashme që kemi pasur mundësinë t'a diskutojmë edhe me qarqet e tjera. Sigurisht që rezultatet ose të dhëna që na kanë ardhur nga kjo provë do të përdoren nga ana e jonë për të konkluduar po themi mbi kërkesën tonë. Por ajo që ka rëndësi në fakt dhe që do të donim të ndaleshim pak më gjatë, është informacioni që na është vënë në dispozicion lidhur me një listë, që unë e vë në dispozicion të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve për të verifikuar në qoftë se këta shtetas kishin votuar apo jo. Në bazë të informacionit që na është vënë në dispozicion me shkresën me numër protokolli 5437/1 datë 25.05.2021 rezultojnë këto të dhëna që totali i votuesve në listën e paraqitur nga subjekti ankues është 146 qytetarë, persona që kanë votuar ditën e zgjedhjeve është 113 dhe persona që nuk kanë votuar ditën e zgjedhjeve është 33. Arsyeja pse ne e kërkuam këtë informacion të nderuar është sepse ne kishim prova dhe informacione të besueshme, me emra, mbiemra dhe të dhëna të identitetit të këtyre shtetasve si dhe shuma që ata kishin marrë për votat e tyre e po ashtu edhe personin përgjegjës apo patronazhistin e tyre. Ajo që vëmë re është që kjo shkresë është nënshkruar nga menaxheri i projektit të identifikimit elektronik zotit Dushallari. Pyetja ime për administratën do ishte, sepse shohim pra që ka 33 shtetas që nuk kanë votuar të paktën nga të dhënat që janë marrë nga pajisjet e identifikimit elektronik. Pyetja ime do ishte, a është kryer verifikimi në qoftë se në këto QV ku kanë votuar këta persona ka pasur ndërprerje përkohësisht

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

apo mungesë totale të funksionimit të pajisjeve PEI, çka mund të ketë përbërë arsye për të kaluar në identifikimin manual të zgjedhësve?

Z. K. Bele: Më fal, përpara se të përgjigjet administrata! Nga një verifikim i bërë, i cili mendoj se i vlen këtij procesi dhe pse nuk është kërkuar në kuadër të kësaj prove. Na rezulton që në Qarkun Durrës, ka pasur mosfunksionim të pajisjes PEI në 28 raste. Nuk e di nëse administrata e konfirmon ose jo këtë informacion por vlen për t'a prezantuar si informacion në kuadër të këtij debati. Pra, për t'u rikthyer tek argumenti juaj , zoti Kaziaj dhe pastaj e ka rradhën zoti Merkaj për t'u përgjigjur. Nga ana juaj u prezantua një listë e cila mendohej se kishte 300 emra. Realisht ishim 146 emra dhe informacioni final është që janë 113 të verifikuar sipas administratës, ne sigurisht e marrim të mirëqenë. Kanë votuar 113 nga 36 dhe 33 nuk kanë votuar. Ky është informacioni që ne mbi të cilin sot po analizojmë. Gjithësesi pyetja juaj për zotin Merkaj është e drejtë. Më fal zoti Merkaj nëse duhet kohë, merrni kohën tuaj se ne vazhdojmë diskutimin dhe debatin.

Z. Y. Merkaj: Po!

Z. K. Bele: Se po shoh që po flet në telefon dhe rëndësi ka që të mos marrim informacione kontradiktore që të na ngatërrojnë. Megjithatë zoti Logu, pa ndërprerë atë që ju doni të thoni, nëse mund të deduktoni ose të bëni edhe një konkluzion qoftë edhe paraprakë çfarë ju mendoni që kjo provë e marrë në atë formë që ka ardhur nga KQZ i shërben ankesës suaj ankimore.

Z. L. Braho: Doja të bëja edhe unë një sqarim. Zoti Logu mund t'i bëni pretendimet për këtë provë sikur të ishin të 146 votues, bëjini pretendimet kështu pastaj presim

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverball i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

përgjigjet nga menaxheri i projektit dhe vijojmë më tej. Por pretendimet në lidhje me këtë provë supozoni sikur të 146 personat kanë votuar.

Z. K. Bele: Po, faleminderit! Bie dakord me qëndrimin e zotit Braho.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Në qoftë se po themi marrim të mirëqenë atë që sapo thatë ju zoti Braho dhe zoti Bele. Ne nuk po themi në lidhje me këtë provë. Pastaj do të na duhet që në konkluzionet tona përfundimtare t'a përfshijmë atë çfarë ne kemi dashur po themi të vërtetojmë dhe të kërkojmë nga ana e këtij komisioni të vlerësohet. Ndërkohë duke qenë se hetimi administrativ nuk është mbyllur akoma. Do të donim që për nevoja të këtij hetimi, duke qenë se gjatë ditës së djeshme u tha që Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim nuk ka ezauruar kërkesën e nenit 136 pika 1 germa c sa i përket faktit të dërgimit të kërkesave nga ana e saj pranë institucioneve publike. Kërkojmë të depozitojmë në cilësinë e provës materiale 100 kërkesa për informacion drejtuar 100 institucioneve publike, të cilat Partia Demokratike i ka dërguar dhe bashkë me to janë edhe mandatet postare. Ne i kemi drejtuar... Zoti Rusmali do të kërkoja që kur flas për respekt...

Z. K. Bele: Zoti Logu ne me njëri tjetrin

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Parimi është që t'a dëgjojmë njëri tjetrin.

Z. K. Bele: Më dëgjo se i vlen seancës, për procedurë se jam edhe relator.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: T'i japim rëndësi gjësë së thelbit se nuk kemi ardhur këtu për njëri tjetrin.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverballi i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. K. Bele: Të lutem vetëm një sekondë. Desha vetëm të shpjegoj, meqenëse rregulloria nuk shpjegon gjithëçka, ne të pestë të mbledhur kemi lirinë që me njëri tjetrin të konsultohemi. Ndërsa jemi të mbledhur përveç rasteve kur ne dalim jashtë kësaj zyre dhe tërhiqemi për vendim apo për konsultim. Që do të thotë nëse ne diskutojmë diçka me njëri-tjetrin kjo nuk ka të bëjë me mungesën e respektit për asnjë nga palët prezente në seancë. Kështu që do të lutem vazhdo parashtrimin tënd po të dëgjojmë me vëmëndje dhe sigurisht me respektin që meriton cilado qoftë forcë politike këtu përballë. Konsultimi jonë nuk ka të bëjë me mungesën e vëmëndjes. Faleminderit, po të dëgjojmë!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Pra, ajo që po thoj zoti Bele sepse besoj që ajo që na ka sjellë këtu është më e rëndësishme se sa njëri ose tjetri. Ishte pikërisht fakti që ne kërkojmë të depozitojmë në cilësinë e provës materiale bazuar në nenin 136 pika 1. Njëqind kërkesat për informacion që i kemi drejtuar 100 institucioneve publike sëbashku me mandatet postare sigurisht që këto kërkesa për informacion vlejné edhe për qarqet e tjera ku ne kemi depozituar kërkesat ankimore për çdo qark duke qenë se lidhen dhe janë procese pavarësisht se shkelje, po tipologjitë mund të jenë të ngjashme secili qark është një ankim më vete, është një vendimmarrje më vetë, është një proces më vete. Kjo është besoj arsyeja për të cilën ne kërkojmë që të depozitojmë edhe këtë provë që provon që Partia Demokratike- Aleanca për Ndryshim e ka përmbushur kushtin ligjor që kërkon neni 136 pika 1 germa c. Në qoftë se më lejoni do të afrohem tek administrata zgjedhore për të depozituar këto prova dhe të vazhdojmë procedurën.

Z. K. Bele: Po patjetër unë besoj që, më fal ju më duket i keni depozituar njëherë apo është hera e parë që po i depozitoni?

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverballi i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ne i kemi depozituar për Qarkun Shkodër, i kemi depozituar për Qarkun Tiranë, ndërkohë që për Qarkun Durrës nuk i kemi depozituar.

Z. K. Bele: Unë mendoj që këto për ekonomi, duke qenë se ne jemi e njëjta trupë në procedime të ngjashme nuk e di nëse kolegët kanë ndonjë objeksion po nuk mendoj. Besoj që depozitimi që ju keni bërë për Shkodrën i vlen edhe këtij procesi dhe administrata na prodhon një kopje për ekonomi që mos të prodhojmë kopje të tepërta, duke qenë se është i njëjti informacion që vlen për 100 kërkimet që ju keni bërë. Ne e quajmë të depozituar provën dhe në shqyrtimin tonë të provave e administrojmë bashkë me provat e tjera.

Z. L. Braho: Mesa po kuptoj unë ne jemi shprehur për këtë kërkesa njëherë. Zoti Logu e ka bërë këtë kërkesë seancën e kaluar, është rrëzuar dhe Kërkesën për këto 19 provat se këto janë ato që shërbejnë për 19 provat apo jo? Për të sqaruar zotin Logu, qëllimi për të cilin ju i paraqisni është që KAS të shprehet sërish në lidhje me 19 kërkesat apo jo ky është qëllimi?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: E drejtë zoti Braho! Pra, një nga arësyet që ne dëgjuam nga ana e këtij komisioni të shprehet, se ishte e rrallë, se zakonisht nuk jepet arsyetimi, shprehet me vendim ishte dhe fakti që ne nuk kemi plotësuar ose përmbushur kushtin e nenit 136 pika 1 germa c, meqenëse jemi akoma në hetim administrativ. Fatmirësisht hetimi nuk është mbyllur, ne i depozitojmë provat e reja, dhe na lind e drejta që të kërkojmë edhe njëherë nga ana e këtij komisioni që të administrohen 19 kërkesat për prova që ne kemi bërë më përpara duke qenë se

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

tashmë jemi përpara një fakti të ri, përpara provave të reja. Është një kërkesë proceduriale, që mendojmë që qendron për tu bërë bazuar në nenin 136 dhe nenin 137 të Kodit Zgjedhor dhe sigurisht komisioni shprehet me vendim sipas asaj që e vlerëson, të bazuar.

Z. K. Bele: Kërkesa është korrekte, e risjell në vëmendjen tuaj që ai shpjegim u bë në vullnetin e mirë për të kuptuar se pse po rrëzoheshin këto kërkesa. Megjithatë ju jeni në të drejtën tuaj që të sillni këto argumenta, sigurisht një nga shkaqet për të cilat u citua refuzimi e theksoi i shumicës ishte edhe ky argument. Megjithatë ne në harmoni edhe me shkaqet e tjera dhe me dokumentat e tjera, pa e paragjykuar vendimmarrjen e KAS në momentin që ne do rishprehemi është dhe administrimi i kësaj prove për qëllime të këtij procesi. Apo shqyrtimi administrativ.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Zoti Bele vetëm një gjë shumë shkurt, sigurisht ne nuk e paragjykojmë vendimmarrjen e KAS megjithëse kemi pasur mundësi të shprehemi në raste të caktuara për vendimmarrjen. Por duhet të kemi parasysh se disa veprime proceduriale që ne kryejmë në këtë proces i vlejné edhe të drejtave tona si palë ankuese për ezaurimin e fazave të tjera apo instancave të tjera gjyqësore që Partia Demokratike ka në plan të ndjek për të gjetur të drejtën e saj. Kështu që këto veprime proceduriale i kryejné edhe për efekt të kësaj të drejtë që duhet t'i garantohet besoj çdo subjekti ankues, faleminderit.

Z. K. Bele: Prandaj e ritheksoj dhe të shënohet edhe në procesverbal për efekt të kësaj seance. Që KAS administron provën e re të paraqitur nga ankuesi, lidhur me 100 kërkesat, drejtuar institucioneve si dhe dokumentacionin provues dhe ky dokumentacion bëhet pjesë e fashikullit, pjesë e këtij shqyrtimi administrativ dhe do

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

të shqyrtohet në harmoni me provat dhe me pretendimet e ngritura nga kjo palë gjatë shqyrtimit.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit!

Z. K. Bele: Vazhdojmë me ankuesin, ose bashkëankuesin LSI, lidhur me pretendimet e tyre, për provat e administruara.

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i LSI-së: Jo, nuk jemi për pavlefshmëri. Jemi për kërkesën e rinumërimit.

Z. K. Bele: Është debat i hollë, por të dy çështjet gjykohen sëbashku, dhe në këtë kuptim, ju jeni nga palët ankuese në këtë proces. Pra, në kuadër të ankimit apo të vlerësimit që bën KAS për qarkun, sigurisht ne po flasim për pavlefshmërinë, ju jeni bashkuar ose keni mbështetur pretendimet e palës, që mund t'a konsiderojmë ankuesi kryesor. Gjithësesi pyetja kishte të bënte lidhur me qëndrimin tuaj, për dy provat e administruar së fundmi me kërkesën e ...

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i LSI-së: Po faleminderit zoti Bele. Ashrtu siç e thatë edhe ju, jemi në një çështje të ngjashme me atë që ka qenë çështja e Qarkut të Beratit. Ku dy kërkesa me objekt të themi të ndryshëm trajtohen në të njëjtën vendimmarrje nga ana juaj. Duke uruar që të mos kenë fatin e Qarkut të Beratit në sensin e vendimmarrjes së tre anëtarëve të shumicës, në atë sens. Vendimmarrja juaj e bëtë mirë, dhe unë ua dhashë përgjigjen zoti Rusmali. Vendimmarrja juaj që të dilni, të hapni precedent të karakterit administrativ duke përdorur domethënë një fjalë aq të madhe sa është ajo e re, se është e pjesës së gjësë së parimit...

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbalë i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. K. Bele: Edhe humori është i lejuar kur palët janë të mbyllura për një shqyrtim për ditë dhe javë të tëra, kështu që jemi qenie njerëzore, nuk e shkelim procedurën nëse lëshojmë ndonjë buzëqeshje.

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i LSI-së: Faleminderit për mirëkuptimin.

Z. K. Bele: Gjithësesi në vendimmarrje ne jemi brenda ligjit dhe vazhdojmë të gjykojmë provat.

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i LSI-së: Faleminderit për mirëkuptim, relatorit dhe anëtarit të KAS. Fakti është që si po relatoja, fakti i shprehjes tuaj me vendim për të atë që ishte kërkesa me objekt dhe pa vlefshmëri dhe rinumërim dhe rivlerësim të votave për Qarkun e Beratit, e trajtuat domethënë si mbas kërkimeve tona përfundimtare, duke përdorur parimin e gjësë gjykuar. Ndërkohë që parimi i gjësë së gjykuar përdoret vetëm në vendime të formës së prerë, vendimi juaj nuk është i formës së prerë. Dhe ju po hapni precedente, mos t'i quajmë të rrezikshme po deri diku të shumë diskutueshme.

Z. I. Rusmali: Pa mikrofon, nuk dëgjohet!

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i LSI-së: Nuk është e vërtetë zoti Rusmali, dhe parimi latin i gjësë së gjykuar nuk është ai që keni dhënë qendrim. Shpresojmë që kësaj radhe fjala juaj të shkojë atje ku duhet të shkojë. Përsa i përket pjesës së provave, jam dakord me pjesën e qendrimit të zotit Logu, dhe ne kishim paqartësi dhe kërkonim ato që ai kërkoi, por nuk dua të bëhem i përsëritshëm, se i dhatë pjesë shpjeguese edhe ju anëtarët e komisionit. Një detaj të vogël që Sekretari i Përgjithshëm që na ka

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

vënë në dispozicion me shkresë përcjellëse për herën e parë dhe e përgëzoj që ka ndryshuar qendrim domethënë tamam qendrim zyrtar me shkresë përcjellëse hera e parë që na vihet në dispozicion një dokument i tillë. Kjo edhe falë sugjerimit të zotit Bele, të zotit relator. Na vë në disponim të dhëna personale të personave, të shtetasve të qarkut...

Z. K. Bele: Ndjesë, kisha vetëm një koment. E di që jeni, po nuk jam duke iu ndërprerë fjalën, por në kuptueshmërinë time, dhe besoj edhe të kolegëve por ata mund të më korrigjojnë. Ne kemi një dakordësi, që duke pasur parasysh sensitivitetin e këtij problemi. Ne nuk do nxjerrim në publik kush ka votuar ose jo, por ne do diskutojmë vetëm mbi konkluzionin. Pra, kanë qenë 146 shtetas nga të cilët kanë votuar 133, nuk ka rëndësi nëse shtetasi X apo Y ka votuar apo jo, për interes të këtij shqyrtimi administrativ, ne gjukojmë vetëm mbi numrat, pa hyrë në identitet e personave, besoj kjo është edhe qasja juaj.

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i LSI-së: Në kuadër dhe në mbështetje të asaj që thatë unë jam plotësisht dakord me atë që sapo thatë. Ashtu siç jam dakord me atë që unë thashë ditën e djeshme kur Sekretari i Përgjithshëm thashë ka njohuri të pakta për ligjin e Mbrotjes së të Dhënave Personale, se një ditë thotë që i mbron ligji të dhënat, ditën tjetër na i sjell ato të dhëna.

Z. Y. Merkaç: Sa për dijeni i kam më të mira se ty.

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i LSI-së: Në rregull zoti sekretar, pse na i solle sot të dhënat? Para dy ditësh thatë që nuk na i lejon ligji.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverball i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. Y. Merkaç: Është urdhërimi i KAS-it. Unë jap vetëm sipas zbatoj vetëm urdhërat e KAS-it.

Z. L. Braho: Zoti Kaziaj e sqaruam paradite këtë çështje. Nuk ka asnjë shkelës këtu, po e sqaruam paradite këtë debatin në lidhje me kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm në seancën e KAS-it.

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i LSI-së: I nderuar zoti Braho, ju paradite më dhatë vetëm 10 minuta fjalën sa mos të kishin rënë këmbanat e..... Të lutem se çfarë sqaruat ju paradite nuk e di por fakti është që jemi në sqarim të një qarku tjetër. Tani, edhe nuk jeni relator edhe më ndërprisni fjalën siç duket nga paraditë në pasdite ju e paskeni me mua, se nuk kam çfarë të them. E dimë që Sekretari i Përgjithshëm mund të përgjigjet edhe vet siç u përgjigj. Kështu që, përsa i përket pjesës së provueshmërisë mund të them që ky dokument vlen, në cilësinë e provës do të drejtohet nga ana jonë, të themi në titullin e konkluzioneve përfundimtare përsa i përket atyre që do jenë parashtrimet në lidhje me kërkimet tona përfundimtare. Siç e thashë mbështesim të gjithë atë iniciativë të ndërmarrë nga kolegu Logu dhe PD-AN. Përsa i përket pjesës së provave për sa i përket pjesës së një qendrimi nga ana juaj, kur i keni kërkuar që të shteronte pjesën e informacionit të kërkuar këtyre institucioneve për të cilën ai ka sjellë sot në cilësinë e provës 100 shkresa zyrtare, të themi, të vërtetuara nëpërmjet lajmërimit të marrjes së shërbimit postar. Për këtë jemi shumë dakord dhe kanë të gjithë mbështetjen tonë për pjesën e provave që kanë depozituar. Faleminderit!

Z. K. Bele: Nuk e di nëse kolegët kanë ndonjë pyetje? Sepse në vlerësimin tim, jemi në fazën që është përmbyllur shqyrtimi administrativ mbi gjetjet dhe pretendimet e palëve. Dhe në këtë fazë jemi në, nëse ka ndonjë kërkesë tjetër.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Proceduralisht i nderuar ne bëmë një kërkesë të re, për marrjen e 19 provave ose bëmë 19 kërkesa për marrje provash pranë institucioneve publike, bazuar ...Pra nuk jemi përpara gjesë së gjykuar, siç tha edhe zoti Rusmali, sepse ne depozituam prova të reja. Pra, ka një element të ri, dhe duhet të ketë një vendimmarrje të re dhe më pas jemi gati për pretendimet tona ose konkluzionet përfundimtare.

Z. K. Bele: E saktë! Faleminderit zoti Logu. Të konsultohemi me njëri tjetrin. Atëherë, KAS i konsultuar në vend, duke në dritën e vendimmarrjes së mëparshme dhe diskutimeve që ne kemi bërë, lidhur me këtë çështje, duke qenë se edhe në një rast të ngjashëm kemi pasur në konsideratë të njëjtën situatë. Me shumicë vendos të konfirmojë të njëjtin qëndrim që KAS nuk pranon që t'i drejtohet institucioneve për 19 kërkesa për prova të kërkuara nga ana e ankuesit PD- AN. Ky është gjithashtu një vendim i ndërmjetëm i cili duhet të arsyetohet sëbashku me vendimin përfundimtarë. Në këto kushte, duke qenë se shqyrtimi administrativ i ka ezauruar fazat e tij lidhur me kërkesën për pavlefshmëri. KAS do të tërhiqet për vendim lidhur me finalizimin e kësaj kërkesë me një vendim gjithashtu të ndërmjetëm.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ne kemi konkluzionet përfundimtare.

Z. K. Bele: Ndjesë i nderuar, se patëm një konfuzion, ju jeni në fazën e prezantimit të konkluzioneve tuaja për këtë qark, për Qarkun e Durrësit. Do ju ftonim për sa jeni të mundur në mënyrë koncize të paraqesni qëndrimin tuaj dhe pastaj KAS do të gjykoj.

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. K. Bele: Do ju ftonim që për sa jeni të mundur në mënyrë koncize të paraqisni mendimin tuaj pastaj KAS do të gjykojë.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti drejtues i seancës konkluzionet tona janë me shkrim kemi në 7 faqe, janë 3 kopje për trupën e KAS-it nqs mund të afrohem t'ju vë në dispozicion 3 kopjet.

Z. K. Bele: Faleminderit, zoti Logu.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Vetëm ti keni parasysh që ti lexoni gjatë kohës që i relatoj. Fillimisht vetëm një shpjegim i shkurtër. Pra e marrët të mirëqenë përsa i përket informacionit të ardhur apo provave të ardhur nga administrata zgjedhore lidhur me numrin e shtetasve qe kanë votuar nga lista që ne ju vumë në dispozicion do ta marrim të mirëqenë deri në momentin që do na konfirmohet nga administrata zgjedhore që kanë qenë 146 votues, pra gjithë shtetasit që ne kemi vënë ne dispozicion listën.

Z. K. Bele: Edhe ju e kishit marrë të mirëqenë përderisa e kishit konkluzionin dhe me shkrim.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ne i nderuar kemi kërkuar ashtu siç është bërë e qartë edhe gjatë parashtrimeve tona kemi kundërshtuar vendimin 340 datë 4.05.2021 për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e zonës zgjedhore Qarku Durrës për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputet duke kërkuar pavlefshmërinë në zgjedhjet e zhvilluara në datën 25 prill në zonën zgjedhore Qarku Durrës dhe urdhërimin e përsëritjeve të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë zonën zgjedhore të Qarkut Durrës. PD si përfaqëse e PD-AN ka përgatitur një material ankues prej 58 faqesh të mbështetur në 42 prova duke shpjeguar në mënyrë të detajuar të gjitha shkeljet zona zgjedhore Qarku Durrës të cilat në

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

vlerësimin tonë përmbushin kriteret ligjore të kërkuara nga neni 160, për shpalljen e pavlefshmërisë në këtë qark dhe përsëritjen e këtyre zgjedhjeve. Konkretisht ne kemi parashtruar se shtetasit Ardjan Cela drejtues politik i PS-së, administrator i OSHEE sha, zoti Vangjush Dako anëtar i kryesisë së PS dhe ish kryetar i Bashkisë Durrës, shtetasi Lefter Koka deputet i PS, shtetasi Jurgys Curbja, Ilir Ndraqi, Rahman Raja dhe Artur Bushi me detyra përkatësisht deputet dhe ky i fundit kryetar i Bashkis Krujë me bashkëpunim me shtetas të tjerë drejtues lokal të institucioneve vendore apo qendrore me përfaqësues të partisë socialiste individë të skeduar me rekorde kriminale kishin ngritur një strukturë kriminale të blerjes të votave, ndihmave ushqimore, kuponave të ID, dhënies së përfituimeve të tjera por edhe nëpërmjet kërcënimeve e presioneve ndaj këtyre shtetasve PD-ja ka depozituar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar 2 kallxime penale në datat 2 prill 2021 dhe 16 prill 2021 për veprat penale korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje përdorimin e funksionit publik për veprimtari politik ose zgjedhore, shpërdorimin e detyrës marrjen ose përdorimin e paligjshëm të dokumentit të identifikimit dhe kanosjen e zgjedhësve. Për sa i përket fenomenit të blerjes së votave në Qarkun e Durrësit nga ana e PD-së u vu në dispozicion një listë e cila ishte bërë publike e cila pasi u verifikua rezultoi se ishin 146 shtetas shqipatër që jetojnë në Qarkun e Durrësit nga të cilët siç po themi informacioni që na është vënë paraprakisht në dispozicion nga të dhënat e pajisjeve PEI 113 prej këtyre shtetasve kanë votuar ndërkohë që për 33 duhet të presim informacionin nga aadmonistrata zgjedhore megjithatë ajo që ë kërkonim të provonim përpara këtij komisioni është fakti që për këta shtetas të cilët janë të identifikuar më emër mbiemër atësoi qendër votimi nr telefoni numër identiteti ju ishin dhënë në këmbim të votës së tyre, shuma që shkonin nga 100 -300 euro, krahas emrit të këtyre personave kishin në fakt dhe emrin e patronazhistit apo personi që ju ka shpërndarë

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

këo shuma parash në këmbim të votave të tyre. Ne të nderuar për verifikimin e tyre kërkuam që të administrohej nga ana juaj dhe informacioni nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar e cila në vlerësimin tonë do të vlerësonte katërciprisht faktin se këta shtetas u paguan 100-300 euro për votën e tyre dhe siç provohet dhe nga informacioni i marrë nga administrata zgjedhore votuan në zgjedhjet e 25 prillit për subjektin PS. Ne parashtriam gjithashtu se me qëllim manipulimin e vullnetit të zgjedhësve janë shpërndarë 125 milion euro nga fondi i ndërtimit nga bashkitë socialiste ndërkohë që në bashkinë Durrës e cila meriton vëmendje për shkak të shyrtimit të ankimit për zonën zgjedhore durrës u shpërndanë 6 milion euro në javën e fundit të fushatës zgjedhore ose 89 hërë më shumë sesa ishin shpërndarë në 15 muajt e fundit. Pra fondet e rindërtimit po përdoren masivisht për manipulimin e vullnetit të zgjedhësve në Qarkun e Durrësit, krahas 42 provave që ne ju vumë në dispozicione ju treguam provat e tjera që ju duhet të merrnit për të vërtetuar ato që ne ngritëm përpara këtij komisioni konkretisht pranë Prokuroria e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, prokurorisë së Përgjithshme, drejtorisë së Plicisë së Shtetit Bashkive, Drejtorisë së Rezervave Materiale të Shtetit dhe Inspektoriatit Qendror dhe Inspektoriateve të tjera. Por nga ana juaj ky informacion u refuzua, marrja e këtyre provave u refuzuar në mënyrë të përsëritur 2 herë plot 38 kërkesa për bërjen transparente të plotë mbi bërjen e votës dhe tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve në Qarkun e Durrësit, ne i parashtriam përpara këtij komisioni duke besuar në drjtesin e vendimeve të tij se shteti vendosi në dispozicion të partisë tendera koncesione PBP dhe çdo lloj investimi publik. Kjo shkelje flagrante e nenit 91 të Kodit Zgjedhor, dhe nenit 3 të Vendimit nr.9/2020 të Komisionit Rregullator u përsërit në raste të shumta në të gjithë vendin dhe veçanërisht në Qarkun Durrës në të paktën 20 raste që kemi pasur mundësi të identifikohen nga ana jonë konkretisht nga depuertet e PS-së shtetasja

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Milva Ikonimi, shtetasi Roland Xhelilaj, Rahman Raja u shfaqën duke promovuar investimet publike me qëllime të pastra elektorale. Ne parashtruam se në 76 raste Kryeministri, minister, depuletët dhe kryebashkiakët e PS-së përdorën procesin e rindërtimit për qëllime të pastra elektorale. Ne parashtruam se në vitin zgjedhor 2020 u prokuruan 878 kontrata publike me vlerë 505 milion euro ose 500% më shumësemesatarja e 5 viteve të fundit. Ne ju treguam se shtetas me rekorde kriminale si rasti i shtetasit Anton Gjinaj, përfituan nëpërmjet kompanive të tyre tendera dhe kontrata publike nga institucionet me vlere 9.7 milion euro ndërkohë që nëse do verifikohesh dokumentacioni i realizimit të procedurave të prokurimit do vëreheshin shkelje të rënda të legjislacionit për prokurimin publik. Krahas 42 provave tona ne ju treguam provat e tjera që ju duhet të merrni për të vërtetuar këto pretendime pranë agjensisë së prokurimeve publike për numrin e tenderave koncesioneve PBP apo për të cilat u shpallën fituesit në periudhën dhjetor 2020 - maj 2021 por edhe kjo provë u refuzua 2 herë nga ana e këtij komisioni. U refuzua në fakt e drejta për transparencë jo vetëm një subjekti zgjedhor siç është PD-AN por e drejta e qytetarëve të Qarkut Durrës e qytetarëve shqiptarë për të bërë trasparencë se si paratë e tyre u vendosën në funksion të PS në Qarkun Durrës. Ne parashtruam se si punonjësit e administratës shtetërore në Bashkinë Durrës, Krujë dhe Shijak u kërcënuan u intimiduan dhe u vendosën në presion të vazhdueshëm për të ofruar mbështetje për PS nëpërmjet një sërë mënyrash që kemi pasur mundësi ti parashtrojmë gjërësisht gjatë diskutimeve tona, veçanërisht ne sollëm përpara këtij komisioni prova sesi drejtori juridik i Bashkisë Durrës, Arben Isaku i dërgonte punonjësve mesazhe duke i thënë që nga ky moment duhet të braktisti vendet e punës dhe të punoni vetëm për fitoren e PS-së. E njëjta gjë ndodhi edhe në agjensinë shtetërore e Kadastrës Durrës apo dhe në shumë agjensi dhe institucione shtetërore. Ne parashtruam se si administrata shtetërore u rrit me 13



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

mijë punonjës ndërkohë që nga buxheti i shtetit u paguan 63 milion euro paga më shumë. U rrit me 6 milion euro ndihma ekonomike për periudhën janar - prill 2021 apo u pagua rreth 1.9 milion euro. Krahas 42 provave tona ne kërkuam nga ana e këtij komisioni të merrte provat konkrete pranë departamentit të administratës publike, bashkive të vendit, 244 shoqërive aksionare në pronësi të shtetit, agjensitë e varësisë së ministrive dhe bashkive për numrin e të punësuarve me kontratë të përhershme apo përkohëshme dhe si ka ndryshuar ky numër përgjatë periudhës janar 2020- maj 2021. Po ashtu ne kërkuam që ju të merrni prova pranë institucioneve irelevante lidhur me numrin e familjeve që kanë përfutuar ndihmë ekonomike dhe si ndryshoj kjo masë e ndihmës gjatë periudhës janar 2020-maj 2021. Por edhe këto prova u refuzuan në mënyrë të përsëritur 2 herë duke bërë kështu u refuzua e drejta e qytetarëve të Durrësit e drejta e qytetarëve Shqiptarë. E drejta që kanë palët ankuese në këtë proces për të bërë transparencë të plotë se si administrata shtetërore, vendet e punës ndihma ekonomike dhe pagesat e tjera sociale u vunë në dispozicion të një partie politike në Qarkun e Durrësit konkretisht të PS-së. Ne parashtruam në fakt dhe kemi shpjeguar gjerësisht faktin sesi lejet e legalizimit dhe lejet e ndërtimit u vendosën në Qarkun e Durrësit në dispozicion të PS-së. Kemi denoncuar fakte të shumta sesi deputete apo kandidatë për deputet të PS-së premtorin e më pas shpërndanin leje legalizimi. Ne në këtë proces të nderuar paraqitëm 42 provat tona që kemi pasur mundësi të kemi në dispozicion por kërkuam nga ana juaj të merrnit provat pranë Këshillit Kombëtar të Territorit, 61 këshilla bashkiak për të gjitha lejet e ndërtimit që janë dhënë në periudhën janar-prill 2021 e po ashtu për të gjitha lejet e legalizimit që janë dhënë në të njëjtën periudhë, po ashtu ju parashtruam përpara këtij komisioni se vetëm në periudhën janar - mars 2021 nga informacionet tona janë shpërndarë rreth 10 003 leje legalizimi. Pyetjes sesa prej tyre janë shpërndarë në Qarkun e Durrësit ne nuk mund ti jepnim përgjigje tjetër përveçse të kërkonim nga

Zbardhi materialin audio

Silvi SINO



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

ana e këtij komisioni që të administrojë prova përkatëse pranë agjensisë shtetërore të kadastrës së Qarkut Durrës. Edhe këto prova siç ju e dini u refuzuan në mënyrë të përsëritur 2 herë dukë refuzuar kështu të drejtën tone, të drejtën e qytetarëve të Durrësit, të drejtën e qytetarëve Shqiptarë për transparencë të plotë mbi lejet e ndërtimit dhe lejet e legalizimit të cilat u shpërndanë masivisht në këmbim të votës për PS-në. Ne në fakt të nderuar kemi parashtruar përpara këtij komisioni se si të dhënat personale të qytetarëve u vodhën e më pas u përdorën në fushatë elektorale, sesi kryetari i PS-së, shetasi Edi Rama sekretari i përgjithshëm i PS-së, shetasi Taulant Balla apo shetasi Ardjan Çela falenderonin patronazhistët për rezultatin e 25 prillit. Ne parashtruam se si rezultatit teknik i ekspertëve ndikoj në fakt për të mohuar të drejtën që kanë rreth 500 mijë shtetas shqiptarë që jetojnë në Maqedoninë e Veriut dhe Greqi për të votuar në zgjedhjet e 25 prillit. Për të provuar të gjitha këto pretendime dhe parashtrime nga ana jonë ne kërkuam që të merrnit prova pranë institucioneve dhe organeve kompetente, pra në kundërshtim me nenin 137 të Kodit Zgjedhor këto kërkesa u ezauruan në mënyrë të përsëritur 2 herë edhe pse ne ezauruam kërkesën procedurale të nenit 136, pika 1, germa "c", përse i përket ezaurimit të rrugës së kërkimit të informacionit nga vetë subjekti ankuese. Ne parashtruam edhe përpara këtij komisioni edhe faktin shumë të rëndësishëm që vetëm në Qarkun e Durrësit pati plot 7800 fletë votimi të pavlefshme ose 4.85%. Pa pasur parasysh faktin këtu që diferenca për mandatin e parë ndërmjet partive LSI dhe PS ishte vetëm 136 vota. Jemi të bindur se në një fletë votimi e cila do ishte në përputhje me kriteret ligjore të nenit 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikën 27 dhe 49 të kodit, të praktikës së mirë të çështjeve zgjedhore Komisionit Venecias, sot mund të kishim një rezultat të ndryshëm. Ju falenderojë që më ndiqni edhe këtu live edhe online. Ne në fakt parashtruam të nderuar sesi strukturat e PS-së sollën denoncime të shumta për rastet e votimit të shumëfishtë, votimit familjar, votimit për të tretët



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

apo falsifikimit të mjeteve të identifikimit Qarku Durrës. Fatmirësisht ne sot disponojmë të dhënat e marra nga pajisjet PEI të cilat flasin konkretisht se shenjat e gishtërinjve të 34 personave janë përdorur për identifikimin e 71 zgjedhësve. Ç'ka potencialisht siç u tha dhe më përpara do të thotë që 34 persona kanë votuar 71 herë apo së paku nga 2 herë secili ndërsa fakti i provuar nga të dhënat që kemi marrë nga pajisjet PEI është se 4 shtetas kanë votuar me të njëjta mjete identifikimi në 7 qendra votimi të ndryshme. Të nderuar anëtar të KAS-it ne vlerësojmë që edhe në Qarkun e Durrësit jemi përpara rasteve flagrante të blerjes së votës nga drejtues të PS-së nga individë me rekorde të tmerrshme kriminale, të shkrirjes së shtetit dhe partisë në një të vetëm, të vjedhjes dhe përdorimit të paligjshëm të të dhënave personale, të mohimit të së drejtës të votimit të 500 mijë shtetasve shqiptarë për të votuar, të pavlefshmërisë së vullnetit të 83 mijë zgjedhësve, kutitë e votimit apo rasteve flagrante të votimit të dyfishtë. Për të provuar secilën prej këtyre krimeve të tmerrshme që kanë ndodhur në periudhën para dhe gjatë zgjedhore ne vumë në dispozicion shpjegimet tona me 58 faqe dhe 48 prova foto video dhe dokumente dhe kërkuam nga ana juaj jo njëherë por plot 19 herë që të zbardhej në plotni masakra zgjedhore e 25 prillit. U refuzua 4 herë kërkesa jonë, fillimisht duke kërkuar që të plotësohej kriteri ose kushti procedural i nenit 137, pika 1, gërma "c" për dërgimin në mënyrë individuale të kërkesave për informacion por megjithatë u refuzua sërish e drejta për transparencë për 251 mijë zgjedhës Qarku Durrës. Ne sigurisht kaq kishim detyrë të bënim, kjo është detyra jonë përpara 730 mijë zgjedhësve që në datën 25 prill kanë votuar opozitën e bashkuar në gjithë shqipërinë apo 50 mijë zgjedhësve që kanë votuar opozitën në Qarkun e Durrësit. Detyra jonë sigurisht ka qenë është dhe do vazhdojë të mbetet zbardhja e plotë e masakrës zgjedhore të 25 prillit në Qarkun e Durrësit. Për ne është e rëndësishme të tregojmë me fakte dhe prova që 25 prilli nuk ishte një ditë zgjedhjesh të lira të ndershme dhe



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

të barabarta por dita kur blerja e votës kapja e shtetit në çdo qelizë, vjedhja e të dhënave personale, mohimi të drejtës së emigrantëve për të votuar paligjshmëria me fletët e votimit dhe votimi i shumëfishtë i një personi të vetëm fituan mbi vullnetin e qytetarëve. Sot sigurisht vendimmarrja, sot, dje dhe në ditët në vazhdim vendimmarrja për Qarkun e Durrësit do i përkas këtij komisioni por ajo zgjedhje që duhet të bëj ky komision dhe duhet ta ndajë është nqs do vazhdojë të sillën si monoter të masakrës zgjedhore të 25 prillit edhe në Qarkun e Durrësit apo do sillen si komisioner me integritet profesional dhe moral që nuk mund të lejojnë që vullneti i 259 mijë zgjedhësve të qarkut Durrës të diktohet nga krimi dhe pa ligjshmëria. E kemi thënë dhe ndihem i detyruar në fakt ta themi që atyre 730 mijë votuesve që i besuan opozitës në 25 prill se kjo betejë vazhdon dhe kështu do jetë gjithmonë, as për KAS-in as për përfaqësuesit e subjekteve politike por sigurisht është një betejë për qytetarët shqiptarë që ne mendojmë janë viktimat e vërteta të 25 prillit prandaj në këtë kuptim të nderuar anëtarë të komisionit dhe këtu dua ta permbyll kërkoj përfundimisht nga ana juaj që në përputhje më nenin 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor të shpallni pa vlefshmërinë e zgjedhjeve të 25 prillit 2021 Qarku Durrës dhe të urdhëroni përsëritjen e tyre në kushtet e ligjshme, në kushtet e zgjedhjeve të ligjshme të lira, të ndershme dhe barabarta, faleminderit.

Z. K. Bele: Faleminderit zoti Logu nëse mundeni në kërkesat e tjera të shpreheni noter se noteri është profesion shumë i nderuar dhe garantor i marrëdhënieve juridiko civile nuk e meriton që të barazohet me terma të tillë si “noter i masakrës zgjedhore”. Nuk besoj që ka në republikë që respekton ligjin që do do binte dakort të bënte këto gjëra. Pastaj ne shprehemi në vendim gjithësesi jeni në të drejtën tuaj që të flisni.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Zoti Bele zakonisht pas pretendimeve përfundimtare të palëve s'ka....

Z. K. Bele: Ishte vërejte dashamirëse dhe nuk i heq asnjë pikë, pretendimet tuaja janë të admintruara shkresërisht dhe verbalisht dhe si të tilla ngelen.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Se më vutë diçka që unë nuk e kam. Respekt për gjithë noterët dhe profesionistët e ligjit por është e vërtetë që ka noterë që noterizojnë aktet e ligjshme ashtu siç ka që bëjnë aktë të paligjshme. Ne sigurisht kërkojmë që të dënohen noterët e paligjshmërisë dhe respekt maksimal për noterët e ligjshmërisë.

Z. K. Bele: Kjo ishte për noterët e paligjshëm.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Kjo është për noterët e masakrës zgjedhore i nderuar.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Unë shkurtimisht zoti relator, nuk i heq asnjë presje përveç pjesës së noterëve nga relatimi që bëri nga pjesa e mbështetjes të themi të karakterit provues nëpërmjet dokumentacionit të depozituar pranë jush. Qarku Durrësit ka pasur një masakër zgjedhore edhe sipas nesh. Fakti është që argumentat që tha zoti Logu ndahen të gjitha dhe nga subjekti që unë përfaqësoj. Ato argument janë provues të fakteve të paligjshmë të ndodhura në këtë qark ndërthurura midis strukturave publike të administratës shtetërore me individ me rekorde të thella kriminale të ndodhura në atë qark. Kjo paligjshmëri ka sjellë atë rezultat që ka sjell. Drejtpërsë drejti LSI ka qenë e përfshirë në pjesën e pasojave të ardhura nga kjo paligjshmëri për këtë shkak ju e dini fare mirë që LSI ka pasur deri në zgjedhjet e

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

shkuara 2 mandate në këtë qark dhe për shkak të këtyre paligjshmërive të ndodhura nuk ka mundur të përfitojë asnjë mandate. Për sa i përket pjesës së kërkesave të zotit Logu, ne i qendrojmë atyre, kërkojmë dhe ne pranimin e kërkesës së PD-AN sipas objektit të saj që keni para jush. Ne do donim zoti Bele në mos gaboj ky është qarku i 5 që kërkojmë nga ana juaj, ju lutem brenda mundësive tuaja e dimë që jeni shumë i ngarkuar dhe kemi një zbardhje vendimesh në kohë sapo të shkurter që të jetë e mundur nga ana juaj në mënyrë që ne të ezaurojmë pjesën e padive të ngritura drejtuar drejt Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, faleminderit.

Z. K. Bele: Patjetër zoti Kaziaj, materialet, sikundër dhe e keni ndjekur janë voluminoze shumë shpejt është dhe çëshja e Vlorës dhe në vijim brenda afateve ligjore në mënyrë që t'ju mundësojmë dhe ju një ankim me mjetet efektive proceduriale që garanton barazinë e armëve në një proces, do disponojmë brenda kohës të parashikuar nga ligji besoj dhe me vullnet të kolegëve në zbardhjen e vendimeve në mënyrë që në ato raste që ju eventualisht ju apo palët e tjera në proces të bëjnë ankime, të keni të drejtën që të njiheni dhe me argumentat për të bërë një mbrojtje efektive ligjore. Mirë, faleminderti. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të provave të administruara KAS tërhiqet për vendim dhe për 15 minuta do të vijmë me një vendimmarrje për ta shpallur, faleminderit!

Rifillon Mbledhja

Ora 18:30

Z. K. Bele: KAS në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimit kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.340, datë 04.05.2021, “Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në Zonën Zgjedhore Qarku Durrës, për subjektin zgjedhor nga kandidatët për deputet për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të datës 21 Prill 2021” dhe “Shpalljen e pavlefshme në zgjedhje në Zonën Zgjedhore Qarku Durrës”, mbështetur në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 30 të vendimit nr.3 në datën 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, pikën 3 të nenit 21 të Kodit Zgjedhor dhe germën “d”, të pikës 1, të nenit 143, të Kodit Zgjedhor me shumicë votash vendosi: Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr.37, datë 09.05.2021, subjekti zgjedhor Koalicioni PD-AN. Ky vendim është një vendim i ndërmjetëm dhe do të jetë pjesë e vendimit përfundimtar që do të marrë KAS. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë së bashku me vendimin përfundimtar, faleminderit.

Vazhdojmë me pjesën tjetër me shqyrtimin e kërkesës ankimore të subjektit zgjedhor LSI për të njëjtin qark. Po zoti Kaziaj.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po zoti relator jemi gati dhe me shqyrtimin ose me relatimin në qoftë se ju do të na autorizoni për të proceduar në këtë moment, besoj se nuk ndihmon askënd të themi vonesa e tepërt në proces. Me lejen tuaj po relatoj ju sapo shprehët për një kërkesë të ngjashëm me të njëjtin qark, objekti ishte pak i ndryshëm por duhet disponuar rrëzimin e saj ne kemi berë kërkesë duke e vënë në lëvizje këtë komision për Qarkun e Durrësit, duke kërkuar në objektin e saj ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve vendim nr.340,



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

datë 04.05.2021, "Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në Zonën Zgjedhore Qarku Durrës". Kërkojmë ashtu si dhe një kërkesë analoge që kemi pasur për Qarkun e Beratit dhe që ju e keni marrë të themi në konsideratë duke vlerësuar ato që ishin provat tona. Kërkojmë rinumërimin dhe rivlerësimin e votave për të gjitha ZAZ-të e Qarkut Durrës dhe miratimin e tabelës përmbledhëse për zonën e Qarkut Durrës duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i këtyre votave. Ju e keni të disponueshme pranë jush këtë kërkesë ankimore përbëhet në total prej 8 fletësh, në brendësi të saj keni argumente të mjaftueshme besoj për të arritur një vendimmarrje objektive, kjo dhe në shikim të një vendimmarrje që thashë të mëparshme nga ana juaj. Struktura e kësaj kërkesë ankimore është pothuajse e njëjtë me atë të Qarkut të Beratit. Është strukturuar një tabelë përmbledhëse në bazë të gjetjeve që subjekti Lëvizja Socialiste për Integrim nëpërmjet monitorimit të kqyrjes filmike të kamerave të numërimit nëpër VNV-të e ZAZ-ve të Qarkut Durrës që përkatësisht janë rreth 300 qendra votimi, kaq kemi pasur të themi kohë për të kqyrur nga materiali përfundimtar nga kqyrja e këtyre pamjeve të fletëve të votimit gjë të cilat unë ua kam vënë dhe në cilësinë e provës materiale seancën e shkuar keni përpara jush fletë votimi haptazi të pavlefshme, të cilat janë konsideruar dhe janë vënë tek zarfi i fletëve të votimit të subjektit politik, i cili është në qeveri për momentin. Në brendësi të tabelës që po relatoja, janë të shënuara në kolona të ndryshme tavolina e numërimit ku është parë të themi pamja filmike e fletës së votimit ndërmjet të cilit kemi vërejtur faktin e tjetërsimit të vullnetit të qytetarit është ZAZ-ja përkatëse, është bashkia përkatëse, janë komentet dhe janë subjektet politike më vonë. Totali i këtyre qendrave votimit është 108 kuti votimi të kqyrura nga pamjet filmike, në rreth 300 kuti që kemi mundur të marrim apo të shohim deri diku të themi për aq sa na lejohej nga pamjet



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

filmike për shkak se shpeshherë dhe numëruesit vet me qëllim apo jo vinin dorën e vet përpara atij që ka qenë vullneti i qytetarit të një nga subjektet. Po ashtu numëruesit në tavolinën e numërimit shpesh herë nuk e mbanin dhe ky është numëruesi i parë që e ka këtë detyrë specifikuar në aktet rregulluese të Komisionit Rregullator dhe të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është numëruesi i parë dhe numëruesi i parë është nga Partia Socialiste, të cilët nuk e mbanin fletën e votimit ashtu siç parashikohet në vendimmarrjen e Komisionit Rregullator, e cila parashikon në pjesën e pasme të saj 3 sekonda të filmimit të mbajtjes pranë vëzhgimit të kamerës themi dhe 4 sekonda atje ku është shprehur vullneti i qytetarit. Në asnjë rast nuk është mbajtur në mënyrë të tillë fleta e votimit duke mos zbatuar një akt rregullues të këtij komisioni. Nga kjo tabelë të nderuar anëtarë të komisionit, i nderuar zoti relator më konkretisht subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë, ka një numër përreth 204 votash më tepër se rezultati i pasqyruar në tabelën përmbledhëse të Qarkut Durrës, marrë me vendimmarrje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ndërsa subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim të paktën nga këto që janë ato pamjet e kqyrura nga ana jonë dhe që japin indicie dhe prova të mjaftueshme për të bërë që KAS në krijimin e asaj që është bindja e brendshme e tij të konkludojë me një vendimmarrje pozitive për pranimin e kësaj kërkesë fillestare. Nisur nga rezultati i shpallur nga KQZ-ja për ndarjen e mandateve e Qarkut Durrës, LSI ka një disavantazh shumë të vogël prej rreth 136 votave që në fund të fundit janë shumë pak të themi një qark kaq të madh sa është Qarku i Durrësit. Ky është një element shtesë që ne e përdorim përpara këtij komisioni për të krijuar atë që mund të jetë besueshmëria e kërkesës sonë ankimore në kuadrin kjo dhe të një transparence të një procesi zgjedhor, i cili do të duhet nga të gjithë ne të quhet i tillë në qoftë se pranohet kjo kërkesë. Fakti është që për të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

mos u zgjatur më tej mendoj që një afat kohor shumë të shkurtër ashtu siç dhe morrëm iniciativën për ta relatuar sot këtë kërkesë ankimore dhe për faktin që askujt siç e thashë dhe në fillim nuk i vlen fakti një vonese të tepërt ose të kotë deri diku të procesit. Në faqen 7, unë kam kërkuar që ky organ kolegjal përveç provave të sjella nga ana jonë dhe do ju lutesha në këtë moment të kisha një element të pamjeve filmike që do e depozitoj në cilësinë e provës materiale përveç faktit të provave të sjella nga ana jonë dhe libri i protokollit të mbledhjeve të marrë parasysh dhe procesverbalet e konstatimit të KZAZ-së objekt ankimit, tabelat dhe rezultateve të grupeve të numërimit në QV, pamjet filmike të VNV-ve që janë shumë të rëndësishme si dhe çdo dokument tjetër që do i shërbejë një hetimi të thelluar administrativ. Për më tej të nderuar anëtarë, përsa u përket këtyre shkeljeve që thamë dhe që i kemi relatuar në këtë kërkesë i provojmë nëpërmjet pamjeve filmike dhe fotografike. Kjo do të sillte të themi transparencë procesi në qoftë se ju do procedoni dhe do vendosni për miratimin e kërkesës sonë, për hapjen dhe numërimin e rivlerësimin e votave për këto 108 kuti. Kështu që kërkojmë nga ana juaj një vendimmarrje objektive për këtë pjesë duke ju falenderuar se për pjesën e dispozitivit themi se çfarë kërkojmë përfundimisht do të jetë një hap procedural i mëvonshëm.

Z.K.Bele: Faleminderit nëse ju kuptova drejt në këtë fazë kërkohet hapja dhe vlerësimi për këto 108 kuti të dizenuara ose të identifikuara nga ana juaj?

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po zoti relator ajo bashkëlidhur dhe faktit që qartazi është i pasqyruar në objektin tonë që vete në parantezë asaj që është dhe pjesa explicite e tabelës përmbledhëse të QV-ve, për të cilat ne kërkojmë të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

rihapen këto kuti. Do të sillja në vëmendje të tuajin që kemi hasur dhe një problematikë të natyrës të procedurës të themi për sa i përket pjesës së numërimit për Qarkun e Beratit më falni që po dal nga tema po meqenëse janë çështje të ngjashme, administrata në atë qark të paktën në përfundim kur ne kemi marrë në disponim të gjitha tabelat përmbledhëse të dala nga rinumërimi. Kemi parë që administrata ka sjellë disa nga kutitë e votimit që ne nuk i kishim kërkuar dhe ndërkohë nuk ka sjellë disa nga ato kuti që ne i kishim kërkuar dhe nuk e di a është gabim njerëzor qëllimshmërie apo kjo do shihet, gjithsesi kjo është pjesë e ankimit tonë në Kolegj Zgjedhor. Do ju lutesha të ishit më të kujdesshëm në këtë rast administratës dhe një kërkesë tjetër duke parë që çështja është e ngjashme me atë të Beratit, fakti është që gjatë numërimit në këtë sallë kjo sallë është shumë sallë e vogël ne e dijmë të gjithë. Të gjithë subjektet politike që do të kenë një vëzhgues në tavolinën e numërimit të mos sjellë persona të tjerë, të cilët e kthyen këtë sallë në një shesh pushimi për të pushuar persona të paidentifikuar që nuk kishin lidhje fare me procesin, hynin këtu në administratë në këtë sallë, ndërkohë që nuk kishte hapësirë as për të gjithë ne.

Z.K.Belev: Ne i dëgjuam vërejtjet tuaja nuk di të them për pjesën e personave të tjerë, por një vendim eventual për të vazhduar numërimin në këtë sallë patjetër do të bëhet kujdes i nevojshëm që kutitë të jenë ato të identifikuar nga ju pasi e vlejme procesin dhe do të kërkojmë nga administrata, do të merren të gjitha masat që personat që do të hyjnë të jenë të identifikueshëm kundrejt rregullave që funksionojnë në këtë institucion për akreditimin dhe lejimin e personave që të hyjnë dhe të marrin pjesë aktive në këtë proces. Megjithatë duhet edhe të mirëkuptojmë natyrën e procesit, ka shumë persona, ka vëzhgues, ka numërues, ka anëtarë të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

medias, ka administratë dhe mendoj që dhe për shkak të ngjashmërisë që ka me KZAZ krijohen konfuzione por që e rëndësishme është që këto të mos ndikojnë në cilësinë e procesit dhe verifikimin e thelbit të tij pra që ka të bëjë me vlerësimin e numërimin e votave.

Z. Y. Merkaj: Mesa mbaj mend unë në kohën kur u rinumëruan kutitë e Beratit, unë e shpjegova mënyrën e marrjes së kutive, ishte sipas kërkesës ankimore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, mbaj mend se janë dy qendra votimi një që i përkiste Qarkut Fier e cila nuk ishte e Qarkut Beratit dhe me mirëkuptimin e përfaqësuesve ose e zëvendësuam me numrin që ata na dhanë dhe ishte një qendër tjetër që nuk ekzistonte fare, 35 përshembull 132 dhe ne i vumë 33 132, me idenë që ishte më e përafërta me atë qendër. Këto të dyja janë për rastet që mbaj mend unë.

Z.K.Bele: Kjo është çështje nëse unë nuk gaboj është bërë një ankim në Kolegjin Zgjedhor dhe të dyja palët në këtë rast do të jetë ankuesi dhe institucioni, KQZ-ja do të bëjë prapësime dhe sqarime të nevojshme dhe nuk i vlen themeli këtij procesi por marrim vërejtjet dhe çfarë ne kemi mësuar nga ai proces për ta përmirësuar aq sa është e mundur. Po zoti Logu.

Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti kryesues i seancës në fakt PD-AN, ka depozituar një kërkesë ankimore e cila kishte të bënte me pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve në Qarkun e Durrësit, sigurisht që është në të drejtën tuaj për të marrë vendim lidhur me këtë kërkesë dhe hapi tjetër procedural është shqyrtimi tjetër i kërkesës ankimore Lëvizja Socialiste për Integrim për rinumërim



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*


dhe rivlerësim të votave në Qarkun e Durrësit, përkatësisht 108 qendra votimi. Ne si subjekt zgjedhor si PD-AN, vlerësojmë se është e drejta e çdo subjekti zgjedhor e cila ngre pretendime dhe dyshime se votat e saj nuk janë numëruar dhe vlerësuar siç ka qenë vullneti i zgjedhësve në ditën e votimit dhe në këtë kuptim e mbështesim plotësisht këtë kërkesë madje ftojmë dhe anëtarët e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, por dhe përfaqësuesin e subjektit tjetër të interesuar Partia Socialiste si një subjekt politik e cila në vitin 2009 d h epas këtij viti inicioi me forcë procesin e hapjes numërimit rivlerësimit të çdo vote kështu që në këtë kuptim besoj se dhe në përputhje me nenin 138, të Kodit Zgjedhor është një kërkesë plotësisht e ligjshme, e drejtë dhe sigurisht është dhe një detyrim i çdo subjekti politik përpara qytetarëve të saj që e kanë besuar në ditën e votimit. Do të doja i nderuar, të bashkohesha po ashtu vërejtjeve që u bënë sidomos për sa i përket administrimit të procesit të rinumërimit pra në qoftë se do të këtë një vendim eventual të komisionit apo një kërkesë të dy anëtarëve për të rinumëruar dhe rivlerësuar votat që gjatë procesit të rinumërimit dhe rivlerësimit të ketë rend, të ketë rregull. Ne në fakt në këtë sallë kemi denoncuar faktin sesi një vëzhgues i Partisë Demokratike u kërcënua nga ana e një vëzhguesi të Partisë Socialiste fakt për të cilën ne jemi duke ndjekur edhe veprimet e tjera ligjore dhe mbasi nuk është nevoja të ndalemi, por është fakt dhe plotësisht e vërtetë që në sallë kishte persona të pidentifikuar, kishte persona që ushtronin presion dhe ndikim qoftë ndaj numëruesve, qoftë ndaj vëzhguesve kështu që do të kërkoja nga ana juaj dhe sigurisht së pari nga Administrata Zgjedhore që të kihet parasysh të ketë rend, qetësi dhe të jetë një proces që kryhet plotësisht në përputhje me ligjin në mënyrën që gjithkush po themi të jetë i qetë. Po ashtu zoti kryesues i seancës nga ana jonë dhe për të cilën janë kryer dhe denoncimet përkatëse, kemi vërejtur se vëzhguesi



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

që solli subjekti zgjedhor Partia Socialiste ishin të gjithë punonjës të Administratës së Bashkisë Berat. Kjo vlerësojmë se është një shkelje e ligjit dhe sigurisht do të kërkonim që ky komision Administrata Zgjedhore të mos lejonte më që shkeljet e tjera të përsëriteshin në këtë sallë pra le ta kthejmë këtë proces në binaret e ligjshmërisë. I ngriti dhe kolegu i LSI-së dhe sigurisht i bashkohemi plotësisht dhe do të kërkonim që këto po themi të ishin rregulla qartësisht të përcaktuara të respektuara nga të gjitha palët. Kështu që në konkluzion kërkojmë nga ana e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve që të pranohet kërkesa e Lëvizjes Socialiste për Integrim për rinumërim dhe rivlerësim të votave në 108 qendra votimi famtmirësisht ka një numër të kufizuar pra nuk do të ketë nevojë që të rinumërohet dhe rivlerësohet i gjithë qarku. Kështu që besoj që është një kërkesë e arsyeshme e logjikshme dhe në përputhje me kriteret ligjore të vendosura nga neni 138, i Kodit Zgjedhor, faleminderit.

Z.K.Beles: Faleminderit zoti Logu, bashkohem me ju për domosdoshmërinë që procesi të jetë i mirë menaxhuar dhe brenda kufijve të ligjit. Nuk ndaj të njëjtin mendim lidhur me prokurshmërinë e faktit, do ta provojë ndjekja penale e mirëpresim hapin tuaj në këtë rast dhe në çdo rast tjetër gjithsesi nuk dua të debatoj lidhur me këtë jeni në të drejtën tuaj ta bëni. Gjithsesi lidhur me vëzhguesit e subjekteve zgjedhore sqaroj se KAS nuk ka tanger dhe nuk na takon të vlerësojmë se cilët janë vëzhguesit. Vëzhguesit besoj janë ata që subjekti sjell nëse dikush shkel ligjin është besoj në përgjegjësinë e atij që e shkel ligjin që t'i përgjigjet para shkeljes eventuale nëse ka një të tillë. Për ne e rëndësishme është që në rradhë të parë besoj integriteti i procesit garantohet nga pjesmarrja e administratës së KQZ-së. Sigurisht dhe kryerja e procesit në sytë tanë të përbashkët i jep, i shton



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

integritetin pa folur për elementet e tjera të sigurisë që kanë të bëjnë me identifikimin edhe me akreditimin e personelit që do të hyjë në këtë sallë. Edhe një herë administrata kam bindjen që do të bëjë maksimumin për ta organizuar procesin dhe moderuar në mënyrën më të mirë të mundshme pasi të gjitha palët në këtë proces, sigurisht administrata po e po kanë interesin që procesi të jetë në shinat dhe binarët e ligjit dhe të japë një produkt të jetë sa më pak i kontestueshëm për sa i përket besueshmërisë së tij, pastaj produkti varet çfarë do të sjellë procesi i numërimit, po zoti Salianji.

Z.E.Salianji, përfaqësues i PS-së: Për sa i përket kërkesës ankimore të subjektit ankues nga ana formale kërkesa është ligjiore, po për sa i përket thelbit neni 138, i Kodit Zgjedhor kërkon që kërkesa thotë KAS-i në këtë rast në kërkesë të palës interesuar kur çmon se për dhënien e vendimit është e nevojshme rinumërim ose rivlerësim i votave të caktuara kryen në prani të palëve rinumërim ose rivlerësim të votave të caktuara. Unë prisja që pas 15 ditësh subjekti ankues të paktën të kishte sjellë një tabelë të grupit të numërimit me kontestimet e numërusve dhe kjo do ta bënte votën të caktuar dhe të kontestuar atë çka kërkon neni 138, që e lidh me nenin 116 dhe me nenin 118 që është procesi i numërimit është shumë e qartë në Kodin Zgjedhor sesi kryhet procesi i rinumërimit dhe cila është vota e caktuar. Por, ankuesi në objekt të ankimit në parashtrim të lexoi që tha dhe për ky proces i shërben dhe transparencës dhe këtu ne jemi dakord me këtë pjesë të ankimit ku jemi të bindur që mandati 8 i fituar nga Partia Socialiste është një mandat legjitim, një mandat i votuar nga zgjedhësit e Qarkut të Durrësit. Ne kemi bindjen që janë 0 shanset për të ndryshuar mandatin në atë qark, po për shkak se dhe ankuesi e kërkon që transparenca i shërben procesit, ne jemi dakord me këtë pjesë dhe



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimeve dhe Saksioneve
Dt.25.05.2021*

besojmë që dhe ju ta pranoni këtë kërkesë të subjektit ankues për rinumërim dhe rivlersim për arsye se për ne është e rëndësishme që siç e kemi thënë dhe në rastin e Beratit. E rëndësishme është procesi zgjedhor ditën e votimit, shumë e rëndësishme për Qarkun e Durrësit dhe aty u provua që ka qenë një votim shumë i rregullt. Numërimi ka qenë shumë transparent votat janë numëruar në pallat të sportit me qindra jo sa do sjellim ne këtu 10 vëzhgues për secilën palë ka qenë media atje dhe asnjë votë nuk është kontestuar në momentin e numërimit por që mandati i 8 të mos ngelet një mandat i dyshuar dhe ne të rivërtetojmë që ai mandat është mandat legjitim dhe ne jemi dakord që këto kuti të hapen dhe votat të rinumërohen pavarësisht se rezultati nuk do të ndryshojë, faleminderit.

Z.K.Bele: Faleminderit nisur nga analogjia e këtij rasti në rastin e Beratit si dhe nga dakortësia e palëve në këtë proces të cilët kanë të njëjtën kërkesë dhe interes të vazhdimësisë së procesit, KAS i konsultuar në vend vendos: Të pranojë kërkesën e subjektit LSI duke vendosur procesin e rivlerësimit, rinumërimit të 108 kutive të cialt janë të identifikuara sipas tabelës bashkëlidhur pjesë e ankimit dhe prezantuar dhe në këtë seancë. I kërkojmë administratës që të marrë masa në kohën e arsyeshme sa më të shpejtë për të ndërtuar infrastrukturën e nevojshme si dhe tërheqjen e këtyre kutive për të filluar procesin. Mendoj se duke sugjeruar si orar orën 10:00 ditën e nesërme është e mundur?

Z.Y.Merkaj: Janë gati.

Z.K.Bele: Palët janë dakord?

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Dakord në mënyrën që dhe ne të marrim masa për caktimin e personelit të mjaftueshëm. Sa tavolina numërimi do jenë?

Z.Y.Merkaj: 8 tavolina.

Z.K.Belev: Do lutem që nisur nga eksperiencia e mëparshme mbasi është proces që ka shumë njerëz, do lutesha që vëzhguesit të jenë në një kohë të arsyeshme përpara gjysëm ore ose dhe ndoshta dhe pak më përpara me qëllim që të pajisen me pejxhet përkatëse dhe me dokumentacionin përkatës, të bëhet dhe chekin dhe verifikim i çdo personi. Pra unë do të sugjeroja që përfaqësuesit pa vënë kushte të vini një orë para pasi ky është një proces i mirëkuptueshëm pra nesër në orën 09:00 vëzhguesit e subjekteve të paraqiten dhe sipas mënyrës më të mirë të mundshme të gjejmë një modus operandi që kjo punë të kryhet sigurisht në transparencë dhe në mënyrë më të mirë të mundshme.

Z. L. Braho: Kisha një sugjerim për përfaqësuesin e LSI-së, meqënëse u hodhën pretendime për Qarkun e Beratit që janë hapur disa kuti gabimisht dhe subjekti i interesuar në këtë proces jeni ju kështu që pavarësisht gabimeve njerëzore që mund të bëjë Administrata e KQZ-së prisja për hapjen e kutive gabim kryesisht është mbi ju, sepse i keni marrë dhe kopjet çdo procesverbali, dini çfarë kërkonte të hapni. Kështu që në rastin që konstatooni se një kuti është gabimisht dhe nuk është kuti tjetër duhet të jeni ju i pari që t'i bëni thirrje Administratës së KQZ-së dhe KAS-it për këtë problematikë.

Z. A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit për sugjerimin zoti Braho.

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. I. Rusmali: Ndoshta ne duhet t'i bëjmë thirrje procesverbalit të asaj mbledhje, sepse dua t'i jap mbështetje Yllit për atë që tha: Një qendër votimi e cila nuk i përkiste zonës zgjedhore në prezencën tonë është kërkuar nga ana juaj të zevëndësohej me një qendër votimi tjetër, kjo është e vërtetë në qoftë se ju e llogarisni kutitë gabim këtu nuk ka gabim për shkak se qendra e votimit e paraqitur në kërkesën tuaj ankimore i përkiste një zone tjetër, ju keni kërkuar të zevëndësohej me një kuti në një qendër votimi që i përkiste kësaj zone dhe ne e kemi miratuar këtë.

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Dhe këtë ne nuk është se e mohojmë zoti Rusmali. Nuk ishte kjo gabimi ishte gabimi në fund të fundit nga ana jonë jo nga ana e Administratës së KQZ-së, janë dy çështje krejt ndryshe për këtë unë ju jap të drejtë dhe miratimin që keni bërë normalisht në bazë të një gabimit tonë që e keni pranuar. Fakti është për t'i kthyer përgjigje zotit Braho procesi ishte shumë intensiv zoti Braho, ju vetë ishit këtu për orë të stërgjatura bashkë me ne të gjithë. Procesi ishte i pakontrollueshëm për shkak të ndërhyrjeve të shumë personave që nuk kishin lidhje me procesin dhe nuk ishin as numërues të KQZ-së dhe as vëzhgues tanët.

Z. L. Braho: Zoti Kaziaj unë isha, anëtarët e KAS-it ishin, por ne nuk ishim vëzhgues që t'i kontrollonim. Unë nuk jam vëzhgues.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jo ju ishit anëtarë KZAZ-je dhe duhet të mbanit rendin brenda kësaj salle apo jo.



*Procesverball i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. L. Braho: Është detyrë e juaja duke qenë se jeni dhe kërkuesi, nuk ia bëj këtë thirrje zotit Logu apo zotit Salianji, por ua bëj këtë thirrje ju se ju keni interesin më të madh në këtë proces. Për mua është e patolerueshme që të hapen kutitë gabim dhe të konstatohet vetëm pas vendimit.

Z. K. Bele: Për t'i shërbyer diskutimit e kisha dhe në formë pyetje dhe sygjërim, pyetje për administratën dhe sygjërim për ju nëse është e mundur ne sigurisht mësojmë nga ato që mund të jenë edhe gabime se procese që nuk janë procese tipike që zhvillohen këtu një herë në katër vjet mund të ndodhë që të hapen disa kuti apo një herë në dy vjet. Ka dhe një veçori ju keni të drejtë që ky komision si dhe ti KZAZ, por e vërteta është që në rastin e Beratit ishin 6 KZAZ, në rastin e Durrësit janë akoma më shumë pra nuk janë kutitë në rendin numerik të një KZAZ-je por janë kutitë të selektuara nga disa KZAZ dhe në këtë masë numrash mund të ketë gabim si nga ju edhe nga ne. Do ju ftonim por do kërkoja dhe konfirmimin e administratës ju mund të dizenjoni apo të identifikoni një person të tuajin i cili të bëjë një double chek ose një chek paraprak. Pra kur të vijne kutitë do të ketë një listë dhe ju mund të bëni një chek të përbashkët që ato që keni kërkuar ju vlejné ju, ne i vlen procesit patjetër dhe administrata është në të njëjtin hap me KAS-in dhe ne bëjmë një kontroll të dyfishtë apo trefishtë po që nevoja që e para të shkojmë te prova e kërkuar dhe e dyta të mos hapim në mënyrë të panevojshme kutitë të cilat nuk i vlejné procesit. Kështu që duke e vlerësuar shumë pozitivisht merakun tuaj duke adresuar dhe atë që tha zoti Braho mendoj që nuk kemi asnjë problem që këto gjëra t'i menaxhojmë në mënyrë më të mirë të mundshme ditën e nesërme.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. K. Bele: Po zoti Çefa.

Z. E. Çefa: Faleminderit zoti drejtues tani për të mos u përsëritur ne nga eksperiencat e marrë më përparshme do të kisha sygjerruar që meqënëse po artikullohet shumë një diçka që në fakt unë po çuditem. Prezenca e personave të pa dëshiruar nga palët ndërkohë që ju e dini shumë mirë transparenca dhe disponibiliteti i KAS-it gjatë procesit të rinumërimit të Beratit ka qenë 100%, asnjë nga palët nuk ka ardhur në kohën e duhur me parashtrime apo me pretendime ndaj prezence të një personi të pa dëshiruar apo të ndonjë incidenti të mundshëm. Unë kam qenë drejtues i seancës dhe nuk jam vënë aspak në dijeni të këtyre situatave dhe në fund pastaj na u desh na erdhi surprizë të gjithëve morrëm vesh për një rast që në fakt ishte shuëm shqetësues dhe aspak serjoz. Tani në mënyrë që ne t'i evitojmë apo t'i parandalojmë këto unë do t'ju kisha kërkuar me shumë mirësjellje që në momentin ku ju konstatooni një problem apo një person që mendoni që është i tepërt në këtë sallë, ju të vini tek drejtuesi i seancës t'i kërkonti zyrtarisht largimin e atij personi ose sqarimin e një situate të caktuar në mënyrë që të parandalojmë që këto probleme të agravohen në fund të seancës dhe t'i zgjidhim aty për aty. Unë besoj mirëkuptimi nga të gjithë ne është, interesi është që të mbarojmë të gjithë sa më shpejt dhe sa më paqësisht këtë problem, kështu që besoj se është krejtësisht e riparueshme, faleminderit.

Z.K.Beles: Po zoti Logu.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Domethënë si rast i Beratit duke qenë po themi se problemi që u përmend është ngritur nga ana jonë dhe mendoj që na takon po



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

themi vetëm si qëndroi si situatë dhe pse ishte shumë shqetësuese, informacioni që unë i vura në dispozicion këtij komisioni më erdhi nga ana e vëzhguesit tonë në përfundim të procesit. Kështu që kjo ishte arsyeja që në momentin e parë që ne morrëm vesh këtë problematikë e ngritëm përpara këtij komisioni e thashë dhe një herë ai është një proces që do ta ndjekim ligjërisht në instanca tjera. Mendoj që ishte me rëndësi për ta vënë në dijeni edhe këtij komisioni por dhe te opinioni publik por ajo që ka rëndësi se po themi gabimet..

Z. K. Bele: Më erdhi një sugjerim për Yllin nuk të ndërpres më ndoshta një shirit ekstra i cili do të bënte një ndarje të kësaj pjese së sallës ku numërohet do të na ndihmonte. Mund të marrim dy kollona dhe shirita.

Z.Y.Merkaj: Gabimi është që vëzhguesit duhet të orjentoohen mos të abuzojnë me të drejtën e tyre për të kontestuar dhe për të bërë..

Z. K. Bele: Në një sallë kur ka 100 veta ne nuk e përjashtojmë që një njeri të sillet jo etikisht apo qoftë dhe në kapërcim të ligjit, por ne do të marrim masat që të ndihmojmë procesin të zhvillohet mirë.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ky është interesi zoti Bele se nuk dua të zgjatem më shumë në këtë pikë, pra administrata të marrë të gjitha masat që të garantohet thjesht rendi, qetësia në sallë, të numërohet dhe rivlerësohen qetësisht çdo votë, palët të kenë mundësi të njihen. Këto seanca sigurisht janë të hapura edhe për publikun por në qoftë se ka mundësi të jetë pjesa ku do të numërohen dhe



*Procesverball i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sankcioneve
Dt.25.05.2021*

rivlerësohen votat të jenë të rrethuar në mënyrë të tillë që të mos ketë asnjë lloj shqetësimi dhe ndërhyrje.

Z.K.Beles: Do kërkojmë dhe mirëkuptimin e medias që të rrijë në pjesën e jashtme ku zhvillohet ky lloj aktiviteti.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ky është interesi ynë kryesor gjërat e tjera ngelen jashtë këtij procesi.

Z.K.Beles: Ne do të jemi të gjithë bashkë nesër dhe do i marrim vendimet së bashku në mënyrën më të mirë të mundshme. Me kaq kjo seancë deklarohet e mbyllur, faleminderit.

*Zbardhi materialin qndro
Valbona DUSHI*



RENDI I DITËS

Projektvendim "Për Shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 39, datë 09.05.2021 të subjektit ankues koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim PD-AN dhe nr. 51, datë 10.05.2021 të subjektit ankues Boiken Abazi, kandidat i mbështetur nga zgjedhësit, për zonën zgjedhore Qarku Tiranë".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PS, PD, LSI

Z. L. Braho: Mirëmengjes! Çelim seancën për shqyrtimin administrativ të dy kërkesave ankimore që kanë të bëjnë me tabelat e rezultateve përmbledhëse për zgjedhjet e përgjithshme, për Kuvendin të datës 25 prill 2021, për Qarkun Tiranë. Më konkretisht janë kërkesat ankimore nr.39 të depozituara, më datë 09.05.2021, të subjektit zgjedhor koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim dhe kërkesa ankimore nr.51 e regjistruar datë 10.05.2021 në KQZ nga subjekti zgjedhor kandidati i propozuar nga një numër zgjedhësish zoti Bojken Abazi. Të pranishëm në sallë janë, përfaqësuesi i Koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim, përfaqësuesit e subjektit zgjedhor Lëvizja Socialiste për Integrim, përfaqësuesi vetë zoti Bojken Abazi, që është kandidat i propozuar nga zgjedhësit dhe përfaqësuesi i Partisë Socialiste. Zoti Sekretar i Përgjithshëm kemi kërkesa në këtë shqyrtim administrativ për pjesëmarrjen si subjekt i interesuar?

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. Y. Merkaç: Pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve janë paraqitur dy kërkesa. Kërkesa e subjektit zgjedhor Partia Socialiste, e cila përfaqësohet me zotin Eridian Salianji, e cila kërkon të futet në procesin e seancës administrative, në cilësinë e palës së interesuar si dhe kërkesa e subjektit zgjedhor partia Lëvizja Socialiste për Integrim me përfaqësues zotin Altin Kaziaj.

Z. L. Braho: Faleminderit! Atëherë, KAS në vendimmarrjet paraprahe ka vendosur që t'i kalojë për shqyrtim administrative, të dy kërkesat ankimore që cituam më parë. Po ashtu KAS në zbatim të nenit 132, të Kodit Zgjedhor ka vendosur gjykimin, shqyrtimin administrativ bashkërisht të këtyre dy kërkesave ankimore. Të dy kërkesat ankimore kanë të bëjnë me pavlefshmërinë e zgjedhjeve, pra kërkohet pavlefshmëria e zgjedhjeve për zonën zgjedhore Qarku Tiranë. Ka ndonjë kërkesë paraprahe në lidhje me konfliktin e interesit të anëtarëve të KAS apo ndonjë kërkesë paraprahe të ndonjë natyre tjetër nga palët si palët ankimese ashtu dhe subjektet e interesuara? Faleminderit! Zoti Sekretar i Përgjithshëm një përmbledhje të shkurtër të dy kërkesave ankimore.

Z. Y. Merkaç: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim 343, datë 04.05.2021 ka miratuar tabelën përmbledhëse të rezultatit për zonën zgjedhore Qarku Tiranë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021. Duke mos qenë dakort me këtë vendim të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, dy subjektet zgjedhore kanë paraqitur ankim pranë KAS duke kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve të datës 25 prill, si dhe urdhërimin e përsëritjes të zgjedhjeve për Kuvend, në të gjithë Qarkun e Tiranës. Gjithashtu dhe subjekti zgjedhor kandidati i propozuar nga zgjedhësit zoti Bojken

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Abazi, ka paraqitur kërkesën ankimore nr.51, i cili kërkon shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve, në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, si dhe kundërshtimin e vendimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.343, datë 04.05.2021. Çështja ka ardhur për shqyrtim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe për më tepër shpjegime mund t'u japin palët.

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Merkaç. Atëherë në zbatim të nenit 134 e vijues të Kodit Zgjedhor ftojme palët që sipas radhës së kërkesave ankimore, duke filluar nga përfaqësuesi i subjektit zgjedhor koalicioni Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim, e më tej me kandidatin e propozuar nga zgjedhësit zotin Bojken Abazi, të vijojnë me parashtrimet në lidhje me kërkesat ankimore që kanë depozituar. Ju lutem përmbledhtasi, patjetër pa i cenur ato pretendime që ju keni por në mënyrë të përmbledhur. Mund të vijoni zoti Logu!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti kryesues i seancës, zoti Braho! Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim ka paraqitur në datën 09 Maj 2021, një kërkesë ankimore pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, ku kundërshton vendimin nr.343, datë 04.05.2021 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, për miratimin e rezultateve zgjedhore në Qarkun Tiranë për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021. Ka kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në datë 25 prill 2021, në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në këtë zonë zgjedhore. Ashtu siç të gjithë jeni në dijeni, në datën 25 prill 2021, në Qarkun e Tiranës u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Në zgjedhje morën pjesë 484777 votues ose 53.24%. Numri i fletëve të votimit të vlefshme ishte 466066 fletë, ndërkohë që numri i fletëve të pavlefshme ishte 18422 ose 3.80% e totalit të

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

fletëve të votave të vlefshme. Mandatet në këtë zonë zgjedhore janë ndarë, Partia Socialiste 18 mandate, Partia Demokratike 15, LSI 2 dhe Partia Socialdemokrate 1 mandat. Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim, duke vlerësuar që periodha para, gjatë dhe pas zgjedhore u shoqërua me shkelje shumë të rënda të ligjit, të cilat në vlerësimin tonë përmbushin kushtet e nenit 160, të Kodit Zgjedhor. Për të konkluduar mbi pavlefshmërinë dhe përsëritjen e zgjedhjeve, ka depozituar këtë kërkesë ankimore duke parashtruar të gjitha shkeljet e pretenduara në pesë shtylla kryesore. Së pari, ashtu siç kemi patur mundësi të shpjegojmë dhe të relatojmë edhe në seancat e mëparshme shtylla e parë, ka të bëjë pikërisht me fenomenin e shpërndarë masivisht dhe veçanërisht në Qarkun e Tiranës, lidhur me blerjen e votës nëpërmjet bashkëpunimit të drejtuesve të lartë politikë, të partisë Socialiste, me individ me rekorde të tmerrshme kriminale. Kemi patur mundësin të parashtrojmë përpara këtij komisioni që Partia Demokratike, lidhur me rastet e shit-blerjes së votës ka depozituar rreth 50 kallëzime në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Në fakt 7 prej tyre, janë vetëm në Qarkun e Tiranës përkatësisht në datat 04 Prill 2021, 06 Prill, 07 Prill, 12 Prill, 15 dhe 18 Prill, çka dëshmon në fakt se problematikat e konstatuara ose shkeljet e rënda të Kodit Zgjedhor dhe Kodit Penal të konstatuara nga ana e Partisë Demokratike në këtë qark, kanë qenë të konsiderueshme. Në mënyrë të përmbledhur i nderuar, sepse vlerësojmë që edhe citimi i këtyre kallëzimeve, shpjegimi pse janë bërë dhe cilat kanë qënë personat e përfshirë, janë të rëndësishme për të kuptuar jo vetëm ne që jemi këtu, por sigurisht edhe publiku që ndjek këto seanca me vëmendje të shtuar se për çfarë bëhet fjalë konkretisht dhe cilat janë po themi pretendimet që ngrejnë palët. Në datën 04 prill 2021, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme, kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për fenomenet e korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje.

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Kanosjes apo dhunimit të pjesëmarrësit në zgjedhje, marrjes ose përdorimit të paligjshëm të dokumentit të identifikimit shtetasit Aleksandër Lipivjani, Emiljano Dusha, Ardjan Davidhi, Rexhep Spahiu dhe Marlin Shkreli, të cilët nga faktet dhe provat që ne kemi patur në dispozicion rezultonin se përdornin i çdo lloj mjeti të paligjshëm për të kërcënuar, intimiduar, zgjedhësit qoftë nëpërmjet dhënies së të hollave apo të mirave material, por edhe dhunës me qëllim tjetërsimin e vullnetit të tyre. Konkretisht Partia Demokratike ka kallzuar faktet se në rrugën Qemal Stafa në njësinë administrative nr.8 në Tiranë, në atë që njihet si lokali i Melit është krijuar një strukturë e mirfilltë blerje votash shantazhesh dhe kërcënimi si dhe mbledhja e kartave të ID nga persona të lidhur drejt për së drejti me Partinë Socialiste. Kjo skenë kriminale e blerjes së votës është organizuar dhe funksion nga shtetasit Aleksandër Lipivjani, Emijano Dusha Ardjan Davidhi, Rexhep Spahiu dhe Marlin Shkreli dhe një shtetas i quajtur Klodi të cilët në ambjentet e lokalit të sipër përmendur, jo vetëm shpërndanin para cash për qytetarët, në shkëmbim të votës por edhe përdornin kërcënime të ndryshme për t'i detyruar këta shtetas që të votonin për Partinë Socialiste. Duhet thënë në fakt se këta shtetas nuk janë të panjohur, qoftë për administratën publike apo për institucionet përsa i përket lidhjes së kontratave publike, pasi shtetasi Aleksandër Lipivjani, është një shtetas i cili është i punësuar në administratën publike. Ndërsa shtetasi Emiljano Dusha nëpërmjet kompanisë Military Sistem Suply Company Sh.P.K. Vetëm në peridhën zgjedhore, për të cilën flasim, ka zhvilluar 5 procedura prokurimi me vlerë rreth 3 milion euro. Pra, pretendimi dhe ajo që ne kemi ngritur në fakt, përpara këtij Komisioni, është fakti se paratë e fituara nga këta persona që ishin të përfshirë në skema të drejtpërdrejta të blerjes së votës, që i fitonin nëpërmjet kontratave publike apo buxhetit të shtetit. Një pjesë e tyre më pas përdorëshin në skemat e blerjes së votës. Nga ana tjetër edhe shtetasi tjetër i përfshirë në skemën e

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

blerjes së votave në këtë grup, i cili është denoncuar nga Partia Demokratike Ardjan Davidhi nëpërmjet një shoqërie të zotëruar nga ana e tij, KOANS Sh.P.K. ka përfituar 12 kontrata publike me vlerën 5.7 milion euro. Krahas kësaj në datën 6 prill 2021, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurori, kryerjen e posaçme kundër krimit të organizuar shtetasit Tom Doshi deputet i Kuvendit të Shqipërisë, kryetari i Partisë Socialdemokrate dhe kandidat për deputet në Qarkun e Tiranës. Si dhe personat me rekorde të tmershme kriminale përkatësisht shtetasit Filip Xheloshi dhe Pal Xheloshi, të cilët me veprimet konkrete në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë kryer veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje, kanosje apo dhunimit ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje. Marrjes ose pëdorimit të paligjshëm të dokumentave të identifikimit. Nga ana tjetër në ankimin që ne kemi paraqitur, i nderuar kemi parashtruar dhe duke qenë se janë të cituara në faqen 5, mendojmë të mos të ndalemi kryesisht. Të gjitha veprat penale, në të cilat kanë qenë të përfshirë shtetasi Filip Xheloshi dhe Pal Xheloshi, të cilët në këto zgjedhje ishin të angazhuar në blerje votash, për kandidatin për deputet të Partisë Socialdemokrate dhe kryetarin e kësaj partie, shtetasin Tom Doshi. Nga ana tjetër kallëzimi i tretë që Partia Demokratike ka depozituar në SPAK, në datën 07 prill 2021, ka pasur të bëjë me shtetasit Arben Ahmetaj, Ministër Shteti për Rindërtimin dhe kandidat për deputet. Ervin Bushati drejtues politik i Partisë Socialiste në Qarkun e Tiranës, Sadri Abazi deputet, Arli Naska Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Tatim Taksave Vendore në Bashkinë Tiranë. Mariglen Qato drejtor i Inspektoriatit Ndërtimor në Bashkinë Tiranë, Artan Ligori drejtor i zyrës së Tatim Takasave në Bashkinë Tiranë. Arlind Hoxha, specialist pranë zyrës së Medias dhe Publikut në Bashki, Eljon Selmanaj drejtor i Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, Entel Agolli drejtor në Postën Shqiptare, Erjon Xhebraj Specialist pranë ndërmarrjes së Pastrim Gjelbërimit, Leonard Kuqi drejtor i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore.

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Roven Zeka, punonjës i policies, pranë Komisarariatit nr.4, Tiranë dhe shtetasi Dilaver Velo, punonjës i policies, pranë Komisarariatit nr.4 Tiranë. Të gjithë këta shtetas janë denoncuar dhe kallëzuar nga ana e Partisë Demokratike për veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje, kanosjes apo dhunimit të pjesëmarrësve në zgjedhje, marrjen apo përdorimin e paligjshëm të dokumentave të identifikimit. Këta shtetas, të cilët u cituan, kanë shkelur në fakt dispozitat e Kodit Penal, për të cilat kompetent është Prokuroria, por veçanërisht këtu duhet të ndalemi tek neni 78, i Kodit Zgjedhor, nëpërmjet intimidimit të administratës të punonjësve shtetëror dhe sigurisht edhe anëtarëve në fakt të Partisë Demokratike për të ndaluar zhvillimin e aktiviteteve, në njësitë administrative 4 dhe 8, duke i kërcënuar këta të fundit me sanksione të ndryshme administrative penale që kishin të bënin qoftë me largimin e tyre nga puna apo me vendosjen e gjobave ndaj bizneseve të tyre. Po ashtu, këta shtetas kanë shpërndarë në mënyrë masive kupon për paisjen me karta identiteti dhe pasaporta biometrike, certifikata pronësie, vërtetime pronësie, leje legalizimi, të gjitha këto në favor të Partisë Socialiste. Faktet e denoncuar nga ana jonë, për të cilat ne kemi paraqitur dhe provat konkrete që kemi paraqitur pranë jush tregojnë rastet konkrete të shumta se këta shtetas kanë shpërndarë edhe para cash në disa zona të varfra të Tiranës ku sigurisht pamundësitë ekonomike të qytetarëve i kanë bërë më funksional ndaj këtyre fenomeneve. Nga ana tjetër i nderuar në të njëjtë datë, në datën 07 prill 2021, Partia Demokratike ka kallzuar në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar shtetasen Meri Musa, me detyrë drejtoreshë e shkollës Ibrahim Brakja, në Sauk, e cila me veprat konkrete konsumonte veprat penale të korrupsionit aktiv në zgjedhjet e korrupsionit pasiv si dhe një seri veprash dhe rastesh të tjera penale për të cilat ne i kemi paraqitur në SPAK. Kjo shtetase Meri Musa, me detyrë drejtoreshë, ka qenë organizatore e një skeme të

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

blerjes së votës në favor të Partisë Socialiste në Sauk. Me burime të paligjshme dhe të pidentifikuara të ardhurash kjo shtetsae ka premtuar dhe dhënë para cash në këmbim të votës për Partinë Socialiste. Nga ana tjetër pavarshisht detyrës si drejtoreshë shkolle, ajo ka punuar aktivisht gjatë orarit zyrtar në fushatë për Partinë Socialiste në zonën e Saukut. Në datën 12 prill 2021, Partia Demokratike ka kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar shetasen Belinda Balluku, Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe kandidate për deputete në zonën e Kombinatit. Shtetasen Laureta Omeri, Këshilltare e Ministrit të Infrastukturës dhe Energjisë si dhe drejtuese politike e fushatës së Balinda Ballukut, Elira Gogo Drejtore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Jug, dhe shtetasit Johana Bushi, Erga Ibrahim, Ceno Klosi, Gazmend Zelaj, Juljana Melyshi, Ilir Belma, Elfred Brati si dhe disa persona të tjerë që ka qenë e pamundur identifikimi për kryerjen e veprave penale për shpërdorimin e detyrës të korrupsionit aktiv të përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore. E gjitha kjo veprimtari në vlerësimin tonë e kryer në formën e grupit të instrukturuara kriminal. Shtetësja Belinda Balluku, në cilësinë e kandidates për deputete në Qarkun Tiranë, zona e Kombinatit, nëpërmjet një grupi të strukturuar kriminal, ju siguronte qytetarëve të Kombinatit leje legalizimi, certifikata pronësie etj, në këmbim të votave për Partinë Socialiste dhe veten. Laureta Meri, e cila është drejtuese e shtabit të Belinda Ballukut në Kombinat dhe njëkohësisht këshilltare dhe anëtare e disa bordeve, kishte një rol kyç në fakt për sa i përket identifikimit të zgjedhësve që kishin nevojë për leje legalizimi, certifikata pronësie dhe më pas vendosjen e tyre në dispozicion. Ky është në fakt i nderuar një nga rastet më flagrante që është denoncuar nga Partia Demokratike. Po e shpjegoj shkurtimisht se me çfarë kishte të bënte fjalë. Ne kemi pasur mundësinë të sigurojmë një paisje telefonike në të cilën është vërtetuar që ishte krijuar një grup në *whatsapp* që ishte

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

drejtuar nga shtetësja Laoreta Omeri ku përbëhëj nga një grup njerëzish që ishin pjesë e administratës publike, veçanërisht punonjës të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, të cilët pasi merrnin njoftime nga koordinatorët e Partisë Socialiste, lidhur me qytetarët të zonës së Kombinatit që kishin nevojë për certifikata dhe leje legalizimi me urdhër politik të Laoreta Omerit, i dërgoheshin grupit të matjes që kryenin matjet në terren dhe më pas siguronin lejet e legalizimit. Të gjitha këto biseda të gjithë dokumentacionin dhe gjithçka tjetër ne kemi pasur mundësinë t'ja vemë në dispozicion Prokurorisë së Posaçme, kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar se si në fakt ishte ngritur në fakt një skemë e mirfilltë kriminale një Leje Legalizimi për vota në zonën e Kombinatit. Ne i kemi denoncuar me emra dhe mbiemra prsonat e përfshirë, detyrat publike që ata kanë pasur si dhe të paktën 150 raste që ne kemi identifikuar të shpërndarjes të lejeve të legalizimit në zonën e Kombinatit në këmbim të votës. Më tutje të nderuar ne në datën 15.04.2021, kemi kallëzuar në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar shtetasit Arben Ahmetaj, Ministër Shteti për Ndërtimin. Rakip Suli, kryetari i Bashkisë Kamëz. Ylli Shehu kryetari i Njësisë Administrative Bathore në Kamëz. Ardian Markola Komision i Posaçëm i Rindërtimit. Erlind Babadheku, Komisioni i Posaçëm i Rindërtimit. Teuata Çami, Mirela Ndreu dhe Ernest Sinani të gjithë kishin anëtarët e Komisionit të Posaçëm të Rindërtimit të ngritur në zonën e Bashkisë Kamëz. Në datën 24 Mars 2021, në emisionin investigativ STOP u trajtua në fakt një çështje se si po abuzoheshin fondet e tërmetit në Bashknë Tiranë. Me qëllim favorizimin e personave në mbështetje të Partisë Socialiste. Rasti është gjerësisht i shpjeguar në faqet 9, 10 dhe 11 të kërkesës tonë ankimore, por, ajo që ka vlerë për tu thënë është fakti se fondet e rindërtimit të cilat duhet të shpërndaheshin për ato familje që ishin prekur nga tërmeti, në fakt u përdorën vetëm për ato familje që ishin prekur nga tërmeti, në fakt u përdorën vetëm për ato

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

familje, të cilat premtorin votat e tyre në favor të Partisë Socialiste në zonën e Kamzës. Ne kemi denoncuar dhe kemi konstatuar raste si si thjeshtë dhe vetëm për të rritur masën e shpërblimit pra për të rritur një masë të caktuar shpërblimi nga një vlerë e caktuar në një vlerë më të lartë ndryshojë kategoria e dëmit nga DS3 në DS4 ndërkohë që nuk kishte asnjë matje dhe asnjë ekspertizë teknike. Po ashtu kemi konstatuar raste se si personat të cilët nuk ndodheshin fare në zonën e Bashkisë Kamëz, kanë përfituar fonde nga rindërtimi e po ashtu edhe shtetas në fakt në kohën kur kanë përfituar këto fonde nuk ndodheshin në Republikën e Shqipërisë. Denoncimi i këtij rasti dhe investigimi është bërë publik nga një emodin investigativ nga një televizion kombëtar, por nga ana jonë është depozituar siç e thashë një kallëzim penal, në datën 15.04.2021. Për të kryer hetime dhe investigime të mëtejshme. Jemi të bindur se në qoftë se nga ana e këtij komisioni të pranohen kërkesat për marrjen e provave pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të gjithë ne këtu por dhe publiku që ndjek me vëmendje këto seanca do ketë mundësinë të kuptojnë përmasat reale që ka pasur ky fenomen në Bashkinë Kamëz por jo vetëm sepse informacioni është kërkuar dhe për të gjitha bashkitë e tjera të prekura nga fenomeni i tërmetit. Pra, vetëm në të paktën 2 raste që u shpjeguan gjërësisht në zonën e Kombinatit janë shpërndarë leje legalizimi në këmbim të votës. Në zonën e Bashkisë Kamëz janë përdorur fonde të rindërtimit për të tjetërsuar dhe manipuluar vullnetin e qytetarëve. Nga ana tjetër në datë 15 prill 2021, po në një media investigative është publikur në fakt një rast ku ishin shpërndarë disa familjeve të varfra në zonën pranë teleferikut në Tiranë. Të cilat kishin mbishkrimin "miqësisht Erjon Veliaj", Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe brenda tyre gjendeshin shuma me 5 mijë lekë të reja. Sigurisht, këto shuma të shpërndara në prag të zgjedhjeve me 25 prill 2021, nuk ka arsye tjetër për çfarë të jenë përveç se për shkak të manipulimit, tjetërsimit

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

të vullnetit të zgjedhësve. Në datën 18 prill 2021, Partia Demokratike ka kallëzuar në Pokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar shtetasit Bujar Mema, Kryetar i Bashkisë Kavajë. Sabi Dervishi, Drejtor i shkollës 9-vjeçare Karpen. Bujar Dervishi Specialist në Komisariatin e Policisë Kavajë dhe Arben Mema specialist në Komisariatin e Policisë po Kavajë, të cilët kanë konsumuar në vlerësimin tonë vepra penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje në përdorim të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore, si dhe shpërdorim të detyrës. Gjatë periudhës zgjedhore në Bashkinë Kavajë këta shtetas të ndryshëm janë lejuar në fakt të ndërtojnë pa leje kundrejt votave në favor të Partisë Socialiste. Besoj se të gjithë e keni parë këto ditë deklarata e bujshme dhe me ton të Ministrit të Punëve të Brendshme apo të Kryeministrit se të gjithë ata që do të ndërtonë pa leje do dënohen me 10 deri 15 vjet burg. Në fakt në Bashkinë Kavajë dhe jo vetëm dhe kjo është arsyeja pse ne kemi kërkuar nga ana juaj që të merrët informacion i plotë për të gjitha lejet e ndërtimit por edhe lejet që janë konstatuar pa leje gjatë periudhës zgjedhore u lejuan masivisht që të kryheshin ndërtime pa leje, në mënyrë që më pas këtyre personave që u lejoheshin ti përkthenin në mbështetje dhe vota për Partinë Socialiste. Rasti i Bashkisë Kavajë është vetëm një nga rastet që i ilustron më mirë këtë fenomen ku persona të ndryshëm në sy të të gjithë funksionarëve publik lejoheshin që të ndërtonin. Ne kemi denoncuar rast konkret në fakt, se si një ndërtim i shtetasit Ervin Duda për të cilët ne ju kemi vënë në dispozicion edhe materialet filmike është lejuar që të ndërtojë pa leje në zonën e Kavajës kundrejt 20 votave në favor të Partisë Socialiste. Rastet e tjera, janë të ilustruara gjerësisht edhe në materialin ankimor që ne ju kemi vënë në dispozicion se si lejet e legalizimit, lejet e ndërtimit, fondet e rindërtimit në rastin konkret sigurisht që do vazhdojmë dhe me denoncime të tjera u përdorën masivisht nga Partia Socialiste për tu përkthyer si mbështetje për të dhe

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

nga kandidatët e saj për zgjedhjet e 25 Prillit. Të gjitha këto të nderuar, ne i vlerësojmë se janë qartsisht në shkelje të nënit 78, 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor të cilat ndalojnë rreptësisht dhenie e parave cash dhënien ndaj përfitimeve të tjera apo të mirave materiale në këmbim të votës por sigurisht edhe përdorimin e aseteve publike për qëllime elektorale dhe politike. Nga ana tjetër blerja e votës siç kemi pasur mundësinë të relatojmë edhe më herët nuk u bë thjesht dhe vetëm nëpërmjet dhënies së parave por edhe nëpërmjet dhënies së ndihmave ushqimore, bonuseve dhe përfitimeve të tjera. Sipas të dhënave të publikuara në fakt tashmë në media dhe nga Organizata e Shoqërisë Civile vetëm në bashkitë Durrës, Tiranë, Kavajë, Lezhë, Rrogozhinë, Vorë, Krujë, Laç dhe Mirditë, po këtu sigurisht duke qenë se po shqyrtohet kërkesa jonë ankimore për Qarkun e Tiranës kanë vlerë bashkitë Tiranë, Lezhë, Rrogozhinë, Vorë dhe Kamëz, u shpërndanë rreth 125 milion euro në periudhën, janar- prill 2021, të cilat ishin rreth 89 herë më shumë se sa ishin shpërndarë në të njëjtë periudhë të vitit të mëparshëm. Kjo në fakt provon qartësisht atë që ne e kemi denoncuar në mënyrë të përsëritur se fondet e rindërtimit u kthyen në një skemë kriminale të manipulimit dhe tjetërsimit të vullnetit të zgjedhësve. Nga ana tjetër ne kemi pasur mundësinë që të depozitojmë në fakt pamje filmike të të paktën të 42 rasteve, të ministrave të Partisë Socialiste deputetëve dhe kandidatëve për deputet duke shpërndarë ndihma ushqimore për familjet në nevojë. Veçanërisht në disa zona të cilat sigurisht për shkak të problemeve ekonomike janë më të ndjeshme në shpërndarjen e këtyre ndihmave që më pas përdorëshin për tu kërkuar mbështetjen dhe votat e tyre për Partinë Socialiste. Rastet e identifikuar nga Partia Demokratike janë si vijon, Elona Gjebreja, me detyrë deputete e Kuvendit të Shqipërisë në tre raste, Vasilika Hysi, me detyrë Zëvendës Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë në 1 rast, Ervin Bushati me detyrë Deputet dhe Kryetar i Partisë Socialiste në Tiranë me 17 raste. Ogerta

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sankcioneve
Dt.25.05.2021*

Manastirliu me detyrë Ministre e Shëndetësisë në 5 raste, Fatmir Xhafaj me detyrë Deputet, Rakip Suli me detyrë Kryetar i Bashkisë Kamëz, Xhemal Qefalia, Ulsi Manja, Sadi Vorpsi, Sadri Abazi, Mimi Kodheli, Erjon Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë dhe drejtues politik në Tiranë. Pra edhe varfëria e qytetarëve edhe nevojat e tyre më jetike për tu ushqyer u përdorën në fakt nga drejtues të lartë të Partisë Socialiste për të manipuluar dhe tjetërsuar vullnetin e zgjedhësve e gjitha kjo e bërë në sytë e mediave dhe publikut shqipëtar. Pasi këto aktivitete nuk ishin aktivitete që kryheshin diku në errësirë por shpesh herë publikoheshin edhe në rrjetet zyrtare të këtyre përfaqësuesve politik të Partise Socialiste. Nga ana tjetër Partia Demokratike, ka vendosur në dispozicion të këtij komisioni por edhe organeve të tjera ligjzbatuese fakte të pakundërshtueshme sesi u shpërndanë dhe u dhanë ndihma ushqimore komunitetit rom në zonën e Kombinatit. Në fakt ne kemi pasur mundësi të vendosim në dispozicion edhe të këtij komisioni por edhe të organeve të tjera ligjzbatuese sesi ishte organizuar kjo skemë. Dëshiroj këtu ndoshta për hirë të interesimit që ka kjo çështje të citoj shkurtimisht një mesazh që u dërgoheshin strukturave të Partisë Socialiste gjatë shpërndarjes së ushqimeve, ndihmave ushqimore, për komunitetin Rom në zonën e kombinatit, citoj, përshëndetje uroj të jeni mirë. Sot, në organizatën 1873 u shpërndanë ndihma për 30 familje në nevojë ku secila familje mori nga 2 pako me ushqime bazë që i nevojitet një familje. Për organizimin e kësaj ndihme falenderojmë deputeten Belinda Balluku si dhe të deleguarën tonë Eda Bega për mbështetjen dhe organizimin për shpërndarjen e këtyre ndihmave. Gjithashtu falenderojmë dhe anëtarët e organizatës së Partisë Socialiste që u treguan të gatshëm për shpërndarjen. Bashkë do ia dalim! Pra ky në vlerësimin tonë të nderuar anëtarë të komisionit është një tregues i qartë sesi ndihmat ushqimore në zonën e kombinatit duke shfrytëzuar varfërinë e qytetarëve atje u përdorën masivisht për tu përkthyer

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

në vota dhe mbështetje për Partinë Socialiste dhe Belinda Ballukun e deleguar politike e asaj zone për partinë Socialiste. Ne kemi pasur mundësi të denoncojmë edhe raste të tjera sa i përket faktit që OSHE një kompani 100% me pronësi shtetërore ju ka paguar të paktën 13000 punonjësve të saj një rrogë plus gjatë fushatës elektorale të Partisë Socialiste. Kujtojmë këtu që drejtuesi politik i qarkut Durrës Ardian Cela është njëkohësisht dhe drejtor i përgjithshëm OSHE- së. Nga ana tjetër ne kemi denoncuar një rast sesi nëpërmjet numrit të telefonit dhe kemi vendosur dhe në dispozicion numrin e telefonit, i cili lehtësisht mund të verifikojë emigrantë shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në shtetin Italian, konkretisht në Milano, janë kontaktuar nga persona që pretendonin se ishin punonjës administrate të cilëve ju është premtuar se në qoftë se vijnë në Shqipëri për të votuar Partinë Socialiste rrugën dhe të gjitha shpenzimet e tjera do ti kenë të paguara. Nga ana tjetër vlerësoj duke qënë se ju kemi vendosur në dispozicion vendimet e Këshillit të ministrave që garantonin përfitime për shtresa të caktuara shoqërore nuk do ndalemi më tej por vlejnë të citojmë shkurtimisht disa vendime të cilat në vlerësimin tonë përbëjnë shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor që ndalon në fakt nxjerrjen e vendimeve në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve, që synojnë të garantojnë ose të ofrojnë përfitime për kategori të caktuara shoqërore. Kam parasysh këtu vendimin nr.101, datë 15.12.2020, autorizim vendimesh shtetërore për fuqizimin e të rinjve dhe të rejave nëpërmjet të cilit autorizohej Bashkia Tiranë të mbështeste me grante të rinjtë e prekur nga pasojat e tërmetit si dhe pandemia në formën e granteve në vlera në vlerë deri në 16 milion lekë ose 131000 euro. Nga ana tjetër ne të nderuar kemi pasur mundësi..

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverball i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.05.2021*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: ... nga ana tjetër ne, të nderuar, kemi pasur mundësinë të denoncojmë edhe në SPAK, në datën 16.04.2021, se si shtetasit Erion Velia, Ogerta Manastiliu dhe Sokol Dardha, secili prej tyre në funksione në bashki dhe në qeveri, përkatësisht, Erion Velia, kryetar bashkie dhe Ogerta Manastirliu, ministre shëndetësie që ishin angazhuar në një skemë të ndarjes së ndihmave ushqimore pranë bibliotekës Petro Zheji, e cila është në njësinë administrative nr. 9. Po ashtu ne kemi pasur mundësinë që të relatojmë përpara këtij komisioni, që në dispozicion e në shërbim të partisë Socialiste, u vendos në fakt çdo lloj burimi shtetëror, përfshirë këtu tenderë, burime publike edhe për individë me rekorde kriminale në këmbim të mbështetjes politike në zgjedhjet e 25 prillit. Ndoshta nuk është e nevojshme që të citojmë edhe një herë ato që u thanë me lart, sa i përket shtetasve Aleksandër Lipiviani, Emiliano Dusha, Ardian Davidhi, etj., por vlen këtu për të thënë faktin që vetëm në vitin parazgjedhor 2020, kontratat publike në numër dhe në vlerë u rriten në 500% të tyre. Kjo është një shifër, është një e dhënë e cila, n.q.s. nga ana e këtij komisioni do të pranohet të merret prova jonë nga agjencia e prokurimeve publike, mund të vërtetohet dhe të faktohet lehtësisht; kjo dëshmon qartazi se nga ana e partisë Socialiste, me qëllim manipulimin dhe tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve, u përdorën në masë fondet e buxhetit të shtetit, paratë e taksapaguesve shqiptare. Kemi pasur mundësi këtu që të rehatojmë në fakt dhe të parashtrojmë përpara jush, raste të shumta se si investimet publike por edhe procesi i rindërtimit, u përdorën në masë në funksion të partisë Socialiste për zgjedhjet e 25 Prillit, një shkelje kjo e përsëritur rreth 120 herë, aq sa ne kemi arritur ta konstatojmë. Ne kemi pasur mundësinë të denoncojmë në fakt, se si në bashkinë Rrogozhinë, shtetas të caktuar si Hamdi Peka dhe Muharrem Troka, por edhe të shtetas të tjerë që për hir të të dhënave të tyre personale e private nuk do të donim ti përmendnim, por që janë të cituar në materialin tonë ankimor, dhe pavarësisht se shtëpitë e tyre,

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.05.2021*

nuk kishin asnjë lloj dëmtimi, ata u përfshinë në skemën e rindërtimit nga tërmeti. Kemi pasur mundësi gjithashtu të denoncojmë raste se si në njësi të ndryshme administrative të bashkisë Tiranë, janë shtruar rrugë pa kryer asnjë procedurë prokurimi dhe pa asnjë procedurë tenderimi. Konkretisht, në rrugët Haxhi Alia, rrugën Hamide Dalipi, rruga Hajredin Fratari, Haki Glina si dhe rrugë të tjera, të cilat thjesht dhe vetëm për të përfituar mbështetjen e banorëve që jetojnë në këto zona, shtroheshin pa bërë asnjë lloj transparence mbi mënyrën se si ishte përzgjedhur kompania fituese, sa ishte fondi, procedura e prokurimit, etj. Po ashtu, përveç një numri shumë të madh rrugësh të shtruara, kemi denoncuar në prokurorinë e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, siç ka qenë kallëzimi i bërë në datën 15 prill 2021, i shtetasve Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë dhe drejtues politik i qarkut Tiranë, Florian Pullazi në cilësinë e kryetarit të njësisë administrative nr. 2 në Tiranë, për veprat penale korrupsionit aktiv në zgjedhje, korrupsionit pasiv, të cilat në vlerësimin tonë janë kryer thjesht dhe vetëm në funksion të maksimizimit të votave të partisë Socialiste. Shtetasi Erion Veliaj, në bashkëpunim me shtetasin Florian Pullazi në cilësinë e kryetarit të njësisë administrative nr. 2 në Tiranë, kanë kryer një sërë investimesh publike që janë denoncuar dhe janë faktuar me pamje filmike nga ana e strukturave të partisë Demokratike, në njësinë administrative nr. 2. Pa asnjë lloj transparence, me punime që kryheshin natën, me burime financiare të dyshimta, në mungesë të një prokurimi apo të një tenderi publik, si dhe në mungesë të çdo tabele informuese të afishuar ku të tregohet autoriteti kontraktues, vlerën e fondit limit, vlerën e kontratës, operatorin zbatues si dhe kohëzgjatjen e kryerjes së këtyre punimeve. Ne kemi pasur gjithashtu mundësi të denoncojmë me fakte dhe prova se si në bashkinë e Rrogozhinës, fondet për rindërtimin, ashtu si edhe në bashkinë e Kamzës, u përdorën në masë për të tjetërsuar vullnetin e zgjedhësve, veçanërisht, në disa zona të cilat janë të varfra dhe me probleme të theksuara sociale, siç është zona

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.05.2021*

e Lekajt, Sinaballajt dhe Cikalleshit. Konkretisht, në datën 12 prill 2021, në një mbledhje me dyer të mbyllura dhe pa asnjë transparencë, këshilli bashkiak Rrogozhinë, vendosi të përfshijë përveç 1700 familjeve të para edhe 871 familje shtesë si përfituese nga fondet e rindërtimit. Ky vendim përcaktonte listën me specifikime sipas metrave katrore të ndërtesës, numrin e subjekteve përfituese dhe vlerën totale për secilën kategori, të cilat sigurisht janë renditur edhe në materialin tonë ankimor të vendosur nga ana jonë në dispozicion. Për fondet e vendosura në dispozicion për këto familje, të akorduara dhe të shpërndara gjatë periudhës zgjedhore, arrijnë vlerën e 3.6 miliard lekë të vjetra, çka dëshmon për një përdorim masiv të fondeve të buxhetit të shtetit për të ndikuar apo për të tjetërsuar vullnetin e zgjedhësve. Po ashtu, ne kemi relatuar në materialin tonë ankimor, dhe kemi parashtruar faktin se si drejtues apo zyrtarë të lartë të partisë Socialiste, në bashkinë Rrogozhinë apo në bashkinë Kavajë, pavarësisht se shtëpitë e tyre nuk ishin të prekura nga tërmeti, apo pavarësisht se ata i kishin shtëpi të dyta në qytete të tjera, përfituan në fakt fonde të shumta sa i përket rindërtimit. Edhe në këtë rast, kjo tregon se fondet e rindërtimit, u përdorën në masë thjesht dhe vetëm për të përfituar mbështetje për partinë Socialiste dhe simpatizantët e saj. Në seanca që janë kryer deri më sot, ne gjithashtu kemi denoncuar faktin se si administrata shtetërore, u përdor dhe u vu nën presion në mënyrë të paligjshme për të mbështetur partinë Socialiste. Konkretisht në faqen 24 ne kemi parashtruar rastin se si drejtoresha e ISH, e cila thërriste në zyrën e saj punonjës të këtij shërbimi, dhe i kërcënonte se n.q.s. ata nuk do të siguronin vota dhe mbështetje për partinë Socialiste, do të largoheshin nga puna. E njëjta gjë ka ndodhur në fakt edhe në OSHEE, apo në rastin e gjendjes civile, dhe në një sërë institucionesh të tjera, siç janë institucionet në varësi të ministrisë së shëndetësisë. Pra, raste të shumta duke qenë se janë të cituara, në mënyrë të detajuar në materialin tonë ankimor, nuk do të doja të ndalesha,

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.05.2021*

tregojnë faktin se si kandidatët për deputetë të partisë socialiste, veçanërisht ata kandidatë me poste ministrore, kam parasysh këtu zonjën Belinda Balluku, ministre e infrastrukturës, zonjën Ogerta Manastirliu, ministre e shëndetësisë, zotin Erion Veliaj, pavarësisht se nuk ishte kandidat, ishte kryetar i bashkisë Tiranë dhe drejtues politik i fushatës, të gjithë këta kishin vendosur në dispozicion të partisë Socialiste dhe të fushatës së saj zgjedhore, të gjithë administratën dhe në një trysni të vazhdueshme që n.q.s. nuk siguronin mbështetje me vota për partinë Socialiste, kjo do të sillte pastaj largimin nga detyra. Rastet janë të shumta dhe që kanë të bëjnë në fakt me përdorimin e institucioneve të drejtorive dhe zyrave arsimore; ne kemi denoncuar një nga rastet në datën 23 maj, ku kandidatja për deputete, Dallëndyshe Bici ka mbledhur në zonën e Paskuqanit të bashkisë Kamzë, të gjithë drejtorët dhe mësuesit e kësaj zone duke iu kërkuar që të mbledhin sa më shumë vota për PS-në, po ashtu kemi denoncuar, rastet se si drejtuesit e ndërmarrjeve shtetërore siç është rasti i Fatmir Cibakut, drejtor i ndërmarrjes shtetërore të transportit, Misto Mame, është angazhuar në shpërndarjen e ndihmave ushqimore dhe mbledhjen e kartave të identitetit, për PS-në. Kemi denoncuar rastin e Rozafat Sopajt, drejtor i banesave sociale pranë bashkisë Tiranë, i cili publikonte vazhdimisht edhe në rrjetet e tij sociale, aktivitete të ndryshme politike në mbështetje të partisë socialiste; Rastin e Irfan Shkëmbit, përgjegjës sektori në drejtorinë e njësisë administrative të bashkisë Tiranë, i cili në orarin zyrtar të punës, ishte në fushatë për partinë Socialiste; raste të tjera siç janë rastet e zonjës Lorena Ava dhe Adelajda Sorra, punonjëse të burimeve njerëzore të drejtorisë rajonale të OSHEE, Tiranë, të cilat i thërrisnin punonjësit e kësaj drejtorie në zyrat e tyre dhe i kërcënonin që n.q.s. nuk mblidhnin vota për PS-në do të largoheshin nga puna dhe nga detyra e tyre. Po ashtu, në kemi pasur mundësi të denoncojmë, në fakt, raste të shumta se si asetet shtetërore dhe burimet publike, dhe administrata shtetërore u përdorën në masë në funksion të partisë Socialiste,


*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.05.2021*

qofshin këto ambiente, zyra makina apo përdorimi dhe angazhimi i punonjësve të bashkisë Tiranë, Kavajë e Rrogozhinë, të cilat janë relatuar e shpjeguar gjerësisht në kërkesën tonë ankimore. Pra në konkluzion të kësaj pjese është e qartë në fakt, që jo vetëm burimet dhe asetet publike u përdorën në mbështetje të PS-së, por edhe gjithë punonjësit e administratës publike u thirrën në zyra, u kërcënuan, që jo vetëm ata vetë të votonin për partinë socialiste, por edhe familjarët e tyre, miqtë dhe të njohurit, duhej të votonin për këtë parti në të kundërt do të kishin pasoja të rënda. Raste të shumta ne kemi pasur mundësi ti denoncojmë, me emra, me fakte, me vende konkrete, me persona, me detyrat e tyre përkatëse, kështu që besoj se informacioni për këtë pjesë është i plotë dhe i bollshëm. Në kemi pasur mundësi edhe në seancat e mëparshme, që të relatojmë përpara këtij komisioni faktin se si administrata publike në vetëm 4 muaj u rrit me 13000 punonjës, por ndoshta është rasti edhe për tu ndalur dhe për ta ilustruar me disa shembuj konkrete, se si p.sh. Në bashkinë Kamzë, vetëm në periudhën Janar-Prill 2021, administrata e kësaj bashkie u shtua me 1003 punonjës. Pra në kundërshtim të plotë me nenin 91 që ndalon punësimet në administratën publike në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve, përveçse, kur e diktojnë nevoja të ngutshme, bashkia Kamzë ka punësuar 1003 punonjës. Unë nuk di edhe nga verifikimet që kemi pasur por edhe nga ajo që kemi parë në media të paktën, nuk di që bashkia Kamzë të ketë pasur nevoja të tilla të ngutshme, sa të shtojë stafin e saj me 1003 të punësuar të rinj. Ky është një rast flagrant se si punësimi apo marrja e personave në punë me kontratë të përkohshme apo të përhershme, u përdor në masë për të tjetërsuar vullnetin e zgjedhësve. Po ashtu në drejtorinë e përgjithshme të arkivave ne kemi denoncuar një rast se si pati ndërhyrje të drejtpërdrejta nga drejtues politike të PS-së, për punësimin e rreth 150 punonjësve; në rastin konkret ndërhyrja ishte kryer nga zonja Belinda balluku, kandidate për deputete në zonën e kombinatit dhe njëkohësisht ministre e infrastrukturës dhe

*Zbardhi materialin audio
Aleksandër PRENGA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.05.2021*

energjisë. Nga ana tjetër, të nderuar, ne kemi denoncuar edhe një email personal të dërguar nga ana e kandidatës për deputete, Ogerta Manastirliu, e cila kërkonte nga strukturat e partisë Socialiste, që të sillnin propozime për vendet vakante në institucionet publike. Pra punësimi në administratën publike nuk kryhej siç duhet bërë në buletinin e prokurimeve publike por kryhej në fakt nëpërmjet email-eve që u dërgoheshin strukturave të PS-së, për pozicione që nuk kanë të bëjnë me funksione politike por që janë pozicione të pavarura dhe të shkëputura nga politika. Ne po ashtu kemi pasur mundësi të denoncojmë faktin se në listë-pagesën e vitit 2021 bashkia Rrogozhinë kishte 90 të punësuar, ndërkohë që në muajin shkurt 2021, sipas listë pagesës zyrtare, llogariteshin rreth 317 të punësuar, pra vetëm bashkia Rrogozhinë në një periudhë 2 mujore, ka punësuar mbi 220 punonjës të rinj. Edhe në këtë rast nga ana jonë me aq sa është verifikuar nuk ka asnjë nevojë të ngutshme, që ka diktuar në fakt punësimin e punonjësve të rinj, kështu që ne kemi depozituar pranë SPAK-ut edhe një kallëzim penal për shtetasin Edison Memolla, kryetar i bashkisë Rrogozhinë, këshilltarin e tij Helidon Bega, Lulzim Haliti, punonjës i bashkisë Rrogozhinë, Romina Bega dhe Eraldo abazi, të cilët në dijeninë tonë, janë përfshirë në veprimtari të paligjshme me qëllim krijimin e favoreve për partinë Socialiste dhe kandidatët e saj. Ne, nga ana tjetër, i nderuar, kemi denoncuar raste se si punonjës drejtues të shumtë të bashkisë Tiranë, kërkonin nga ana e strukturave të PS-së apo shtabeve të PS-së, që të sillnin kandidatura për vende pune që ishin krijuar rishtazi. E gjitha kjo, sigurisht, që nuk kishte qëllim tjetër veçse një vend pune në funksion të skemës kriminale të marrjes së një vote. Ky fakt publik dhe i njohur, që ne kemi pasur mundësi ta artikulojmë në mënyrë të përsëritur, është fakti se nga të dhënat zyrtare të ministrisë së financave, pagat për punonjësit e administratës publike u rriten me rreth 63 milion Euro, në vetëm 4 muaj para datës zgjedhore, pra në periudhën janar-prill 2021. Ne kemi pasur gjithashtu mundësi të denoncojmë si një

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.05.2021*

shkelje shumë të rëndë të ligjit, si dhënien e lejeve të legalizimit apo të lejeve të ndërtimit gjatë fushatës zgjedhore. Është fakt publik, se si drejtues politike dhe deputetë të PS-së, siç është rasti i zotit Fatmir Xhafaj, ish-ministër i PB, deputet dhe kandidat për deputet i PS-së, shfaqeshin krahu mbështetësve dhe simpatizantëve të partisë Socialiste duke shpërndarë leje legalizimi. Kemi pasur mundësi të denoncojmë faktin se si në datën 27 shkurt 2021, ministrja e drejtësisë Etilda Gjonaj dhe persona pranë saj, u përfshinë në dhënien dhe shpërndarjen e lejeve të legalizimit dhe vetëm në njësinë 7, ku ne kemi pasur mundësi të kryejmë verifikime, u shpërndanë 12 leje legalizimi pikërisht në datën 27 shkurt. Po ashtu, ne kemi pasur mundësinë të denoncojmë faktin se si shtetasi Dritan Stroka, punonjës i ASHK-së, ishte përfshirë në premtimin dhe shpërndarjen e lejeve të legalizimit në këmbim të votës në favor të partisë Socialiste. Ne kemi denoncuar edhe në Prokurorinë e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në datën 8 prill 2021, raste të shumta se si shtetasit Erion Veliaj, Ogerta Manastirliu, Ulsi Manja, Artan Lame, Artan Tusha, Bledar Doracaj, Arlind Gjokutaj, ishin përfshirë në fakt në shpërndarje të lejeve të legalizimit dhe certifikatave të pronësisë në këmbim të votave për partinë Socialiste. Ju lexova disa emra dhe është shumë e thjeshtë të verifikohet që këta persona nuk kanë asnjë lloj lidhje funksionale apo me kompetencat e tyre si drejtues institucionesh, pra, nuk kanë të bëjnë për asnjë moment as me shpërndarjen e lejeve të legalizimit e as me shpërndarjen e certifikatave të pronësisë, apo të kryejnë ndonjë procedurë tjetër. Se çfarë lidhje mund të ketë p.sh. drejtori i përgjithshëm i gjendjes civile me shpërndarjen e lejeve të legalizimit apo ministrja e shëndetësisë, apo dhe drejtues të tjerë lokalë, kjo mbetet për tu verifikuar, por është e qartë se ky aktivitet masiv që u krye nga drejtues të lartë të PS-së, kishte thjeshtë dhe vetëm të bënte me tjetërsimin e vullnetit të qytetarëve. Ne kemi relatuar dhe shpjeguar gjerësisht se si në njësinë administrative nr. 9 dhe 11, drejtues dhe anëtarë të strukturave të Partisë



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.05.2021*

Socialiste, dhe këtu kemi cituar edhe listën e tyre në fakt, u përfshinë në vendosjen në dispozicion të Partisë Socialiste dhe mbështetësve të saj, fonde, leje dhe licenca që mund të jepeshin vetëm nga organet e administratës publike. Po ashtu në këto njësi, ashtu siç kemi relatuar dhe përshkruar dhe për njësi të tjera, u shtruan në masë edhe rrugë pa pasur asnjë procedurë prokurimi, pa asnjë lloj transparence, pa identifikuar autoritet kontraktuese, cili ishte fondi, cila ishte procedura e kryer. Mund të citoj këtu rrugën Andrea Themeli, Allaman Dervishi, rruga e shinave në njësinë 11, rruga Demir Progni, Hysenbelliu, Jezerca, Bektash Kozeli, Nuri Kevo etj., të gjitha këto rrugë të shtruara në prag të fushatës zgjedhore, pa kryer asnjë procedurë tenderimi apo prokurimi publik. Po ashtu një nga rastet, po themi, të rënda dhe të cilat ne kemi pasur mundësinë ti denoncojmë, duke qenë se është thënë dhe përsëritur përpara këtij komisioni, është fakt publik audio përgjimi i publikuar i drejtorit të përgjithshëm të Kadastrës, i cili iu kërkonte mbështetësve të tij që të mbanin të pezulluar rreth 100 mijë kërkesa për leje legalizimi, në mënyrë që refuzimi i tyre të mos sillte vota në favor të kundërshtarëve politike, ndërkohë që kërkohet në të njëjtin audio përgjim që të përshpejtohet procedura për rreth 60 mijë leje legalizimi. Ne kemi denoncuar raste të shumta se si votuesit u kërcënuan për mbylljen e bizneseve nëpërmjet inspektimeve të paligjshme, siç është rasti i zotit Arben Sinani, i cili është drejtues i shkollës private "Dituria", në kërcënimin e të cilit u përfshi vetë shtetasi Fatmir Basha, vëllai i zonjës Linda Basha, bashkëshorte e kryeministrit Rama. Ky shtetas i ka kërkuar zotit Sinani të hiqte dorë nga çdo aktivitet në mbështetje të partisë Demokratike, në të kundërt shkolla e tij do të mbyllet dhe si paralajmërim, pa asnjë lloj justifikimi në fakt u shfaqen, në datën 4 shkurt 2021, 3 inspektorë të DRA Tiranë, për të kryer një inspektim pranë kësaj shkolle, dhe deri më sot nuk i janë komunikuar rezultatet e këtij inspektimi. Pra, është e qartë, që ishte një skemë për ta mbajtur nën një presion të vazhdueshëm. Ne

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.05.2021*

i kemi denoncuar edhe rastet e dhunës ndaj simpatizantëve dhe mbështetësve të PD-së siç ishte rasti i datës 21 shkurt 2021, ku shtetasi Dorian Protoduari, një aktivist i PD-së në zonën e Unazës së Re, u dhunua nga persona me lidhje të ngushta me kandidatin për deputet, dhe ministrin e shtetit për rindërtimin Arben Ahmetaj. Nga ana tjetër i nderuar, një nga skemat kriminale, po themi, të përdorura në këto zgjedhje, e cila sigurisht meriton vëmendje të posaçme nga ana juaj, është fakti se në datën 23 prill 2021, partia Demokratike ka denoncuar në prokurorinë e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, se si zyrat e partisë Socialiste në zonën e Yzberishit, ishin kthyer në zyra të gjendjes civile. Është fakt publik se vetëm në 4 muaj, popullata e kësaj zone u rrit nga 8000 në 22000 banorë. Pra si rezultat i kësaj skeme vetëm në këtë zonë, u transferuan 14 000 banorë në katër muaj. Unë nuk di një zonë tjetër në Republikën e Shqipërisë, apo kudo tjetër që të ketë pasur një rritje të tillë, prej 14 000 banorësh në vetëm 4 muaj. Aq më tepër që transferimi i gjendjes civile nuk kryhej pranë zyrave të gjendjes civile, siç e kërkon procedura, por kryhej pranë zyrave dhe shtabeve të partisë Socialiste, fakt publik për të cilin ka pasur edhe një investigim të publikuar nga një emision investigimi në një televizion kombëtar. Po ashtu është rasti se Tirana është ilustrimi më i mirë, i kësaj shkelje të rëndë në fakt të Kushtetutës, Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe ligjit, se si të dhënat e 910 mijë qytetarëve të Tiranës, u vodhën nga serverët shtetërorë dhe më pas u përdorën për qëllime zgjedhore, në zgjedhjet e 25 prillit, duke bërë publike të dhënat personale si numrin e identifikimit, vendin e banimit, nr. e telefonit dhe bindjen politike. Është fakt, gjithashtu publik, se edhe në raportin paraprak të OSBE-ODIHR, u konstatua fakti se nxjerrja e të dhënave personale të qytetarëve, i bëri më të cenueshëm ata përpara drejtuesve politikë në zgjedhjet e 25 prillit. Partia Demokratike lidhur me këtë skandal të përmasave të jashtëzakonshme, ka denoncuar në datën 14 prill 2021, me një kallëzim penal në prokurorinë e posaçme kundër



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.05.2021*

korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe lidhur me rezultatet e këtij denoncimi, ne, kemi kërkuar informacion me datën 15 maj 2021, dhe deri më tani nuk kemi asnjë përgjigje por kërkojmë nga Komisioni që të merret një provë zyrtare se cilat janë rezultatet e këtij hetimi dhe investigimi të kryer nga prokuroria e posaçme për tu njohur më pas me efektin që ka pasur ky krim i jashtëzakonshëm në procesin e zgjedhjeve të 25 prillit. Ashtu siç kemi bërë edhe në denoncimet tona të mëparshme, fakti që komiteti teknik i ekspertëve vetëm një javë para datës së zgjedhjeve iu hoqi të drejtën për të votuar 500 mijë shtetasve shqiptarë. Po ashtu ne kemi pasur mundësi për të relatuar faktin se si në qarkun e Tiranës, një fletë votimi e paraqitur vetëm me numra, pra pa emra të kandidatëve, solli si pasojë që vetëm në qarkun e Tiranës, 18422 fletë votimi ishin të pavlefshme, ose e shprehur në përqindje 3.18 pikë përqindje. Është e kuptueshme po themi që, numri i votave të pavlefshme në qarkun e Tiranës 18422 vota ose 3.18 pikë përqindje, dëshmon faktin që një mandat në qarkun e Tiranës, është diktuar nga fletët e pavlefshme. Pra vullneti i 18422 qytetarëve u bë i pavlefshëm për shkak të konfuzionit që u krijua nga fleta e votimit, fakt ky i njohur dhe i konstatuar edhe nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në deklaratën e datës 28 prill 2021, por edhe nga raporti paraprak i publikuar nga ana e OSBE-ODIHR-i. Kemi pasur mundësinë të rehatojmë edhe raste të tjera shkeljesh të renda, siç është edhe fakti i denoncuar në mënyrë të përsëritur nga ana jonë, i votimit të shumëfishtë, votimit për të tretët apo i votimit familjar, për të cilin do kishim dëshirë që të ndaleshim më gjerësisht në momentin që të administrojmë të dhënat e pajisjeve të identifikimit elektronik, PEI. E thatë me të drejtë zoti Braho se relatimi dhe parashtrimi për qarkun e Tiranës ishte pak më i gjatë se për qarqet e tjera, ashtu siç në fakt është edhe materiali ynë ankimor, prej 89 faqesh, ashtu siç në fakt, janë edhe provat e vëna në dispozicion të këtij komisioni, plot 88 prova, të cilat dëshmojnë që zgjedhjet në qarkun e Tiranës, ku sigurisht vëmendja është më e



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.05.2021*


madhe, qoftë e medias e publikut, e organizatave të shoqërisë civile; nuk ishte një ditë zgjedhjesh të lira, të ndershme dhe të barabarta, por ishte një ditë ku vullneti i qytetarëve të Tiranës, vullneti i qytetarëve të Kamzës, Vorës, Rrogozhinës dhe të Kavajës, u diktua gjerësisht dhe në masë nga krimi dhe paligjshmëria. Unë do të kërkoja nga ana e këtij komisioni që secila prej këtyre shkeljeve, të cilat, për ekonomi kohe, nuk u cituan gjerësisht, të verifikoheshin, shqyrtoheshin dhe vlerësoheshin me kujdes maksimal dhe nga ana tjetër të pranoheshin kërkesat tona për marrjen e provave, në mënyrë që, të kuptoheshin përmasat reale që kanë pasur këto shkelje në rezultatet e zgjedhjeve të 25 prillit në qarkun e Tiranës. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Logu për këtë panoramë të detajuar! Vazhdojmë subjektin tjetër ankimues që është kandidati i propozuar nga zgjedhësit, zoti Bojken Abazi! Fjala për ju!

Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Faleminderit! Në fakt unë do të doja t'ia nisja nga një fakt që është i njohur botërisht dhe i bërë publik dje në media; është një video që evidenton një konsumim të veprës penale, në qytetin e Gjirokastrës, e di që nuk jemi duke diskutuar sot qarkun e Gjirokastrës, megjithatë, në atë video, ku vërehet qartë konsumimi i kësaj vepre penale, për ta shpjeguar më qartë për ata që nuk kanë pasur mundësinë ta shikojnë videon në media, një nga numëruesit në tavolinën nr. 3 të KZAZ-së nr. 80, në 26 prill ditën pas votimit, në orën 5:09 e mëngjesit, në prani të tre numëruesve të tjerë, pra ekziston dyshimi i bazuar që aty ka qenë përfaqësuesit numërues të të gjitha partive politike, që japin miratimin e tyre në heshtje për konsumimin e kësaj vepre penale, duke bashkëpunuar në këtë krim, personi që vërehet në video është duke vendosur sipas dëshirës, X-a në fletët e votimit. Prandaj edhe unë nuk e kuptoj insistimin për të thënë se

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 25.05.2021*

pavlefshmëria e fletëve të votimit është ndikuar vetëm nga paqartësia e fletëve të votimit. Ne kemi nxjerrë video, kjo është vetëm njëra prej tyre, që e vërteton këtë gjë që, gjatë procesit të numërimit janë bërë plot fletë të pavlefshme. Ekziston dyshimi i bazuar në argumente dhe në fakte. Arsyeja pse e ngre këtë është jo vetëm fakti që këta persona kanë bashkëpunuar, siç vërehet qartë në këtë video ku njeri prej tyre është duke vendosur X-at, por se në video vërehet edhe fakti se personi, menjëherë pasi përfundon së vendosuri X-a sipas qejfit në fletëvotim, duke deformuar vullnetin e qytetarëve, duket se komunikon me ministrin Blendi Çuçi, që ishte edhe kandidat në Qarkun e Gjirokastrës.



Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Kthehet nga pamjet filmike zyrtare të KQZ-së, besoj është lehtësisht e verifikueshme. Mirëpo unë e ngre këtë çështje që një të merret parasysh si provë nga KAS-i, bazuar dhe mbi Kodin Zgjedhor edhe pse nuk e kemi dorëzuar kur kemi dorëzuar ankesën tone, kjo provë është e evidentuar gjatë kësaj fundjave dhe është bërë publike dje, për të pasur parasysh se kemi të bëjmë me personin që ka pasur përgjegjësi për të drejtuar forcat e Policisë së Shtetit. Pra ky rast nëse verifikohet që personi ka pasur lidhje, ka qenë në dijeni nuk ka marrë masa sot e kësaj dite nuk është distancuar nga ky rast, na flet për integritetin e këtyre zgjedhjeve në të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe jo vetëm në Qarkun e Gjirokastrës. Do të doja me lejen tuaj të vazhdoja me disa nga argumentet që ne kemi dorëzuar, sigurisht dhe provat që ne pajtohemi me faktin që këto zgjedhje janë deformuar para, gjatë dhe pas fushatës zgjedhore, por një pjesë e ankesës sonë lidhet ngushtë dhe me procesin e numërimit nga ku kanë nisur dhe argumentimet dhe provat tona, të cilat do të doja t'i paraqisja. Ne kemi dorëzuar pranë KAS-it shumë dëshmi të vëzhguesve të akredituar që kemi pasur në këto zgjedhje, të cilat vërtetojnë shkeljet që lidhen me procesin e pengimit të drejtpërdrejt të vëzhguesve nëse mund t'ju lexoj disa pjesë nga ankesa: Gjatë gjithë momentit të pranimit dorëzimit të kutive nëpër 18 qendrat e numërimit në Qarkun e Tiranës, nuk janë lejuar vëzhguesit e akredituar, të paktën tanët të kandidatit të pavarur të marrin pjesë gjatë këtij procesi. E njëjta gjë është evidentuar edhe nga Organizata KRIK që ka vëzhguar zyrtarisht këto zgjedhje me vëzhgues të akredituar duke rënë ndesh me nenin 7, të Kodit Zgjedhor. Pasi kryetarët kanë pranuar kutitë e votimit edhe këtë e kemi të dëshmuar edhe unë vet si kandidat i pavarur kam qenë i penguar por edhe shumë vëzhgues tanë që kanë depozituar me shkrim dëshmitë pranë jush në ankesën tonë. Pasi janë dorëzuar kutitë është bërë pranimit dorëzimi i kutive, nuk janë lejuar vëzhguesit të hyjnë brenda në mënyrë të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

drejta të barabartë, në mënyrë arbitrare janë përzgjedhur ata vëzhgues që ka vendosur të lejojë të hyjnë brenda Kryetari i KZAZ-së sërish në shkelje të Kodit Zgjedhor duke ngritur edhe një herë dyshimin e bazuar që një pjesë e fletëve të votimit janë manipuluar dhe deformuar edhe gjatë këtij orari siç do dëshmojnë pak më vonë edhe me argumente të tjera. Pozicionimi i vëzhguesve në shumicën e rasteve vëzhguesve tanë ka pamundësuar vëzhgimin e drejtë duke e mbajtur larg fizikisht për këtë sërish e kemi dorëzuar disa dëshmi me shkrim kjo evidentohet në raportin e OSBE/ODIHR-it dhe gjendet paraprake duke rënë sërish ndesh me Kodin Zgjedhor, neni 6, neni 3 e kështu me rradhë. Policia e Shtetit ka zbatuar urdhra të paligjshëm duke mos na lejuar të futemi brenda, por nëse lidhet pra edhe një herë me faktin që përmendëm në fillim, atëherë kemi të bëjmë me një proces të cënuar drejtpërdrejt nga drejtuesit më të lartë të shtetit, sepse qartazi nuk kanë pasur të drejtë të pengojnë hyrjen përshembull time si kandidat i pavarur brenda qendrave të votimit dhe për këtë ekzistojnë fotografi, ekzistojnë video, ekzistojnë raportime mediatike duke marrë vetëm një rast është rasti i Shkollës Bajram Curri këtu në Tiranë në lagjen Allias. Të gjitha këto iu janë dorëzuar me prova dhe publikime mediatike. Ka pasur sigurisht brenda vendnumërimeve persona të pautorizuar, familjarë, dyndje, kjo dëshmohet së pari nga vëzhguesit tanë që kanë depozituar me shkrim dëshmitë e tyre. Së dyti lehtësisht nga pamjet filmike tek të cilat secili prej jush besoj ka qasje dhe mund ta verifikojë lehtësisht, vërtetohet nga raporti si ai i Organizatës së KRIK-ut, i OSBE/ODIHR-it, por besoj që ju e keni parë sesi kjo dyndje i personave të pacertifikuar të paakredituar ka degraduar në dhunë edhe në Shkollën 1 Maji, edhe në Rrogozhinë. Pra edhe në KZAZ-në 30 dhe në KZAZ-në 43, gjithë kjo situatë dhune për bindjen tonë ka ndikuar drejtpërdrejt dhe te rritja e tensionit dhe presionit ndaj grupeve numëruese në Qarkun Tiranë. Ka disa shkelje që lidhen edhe me votat e pavlefshme që përmendëm në fillim siç u



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

tha janë 18 mijë e 422 shkelje. Së pari vendimi për ta shpallur që thotë “të pavlefshme” ka pasur standart të dyfishta, në të njëjtën tavolinë janë përdorur një standart që ndryshon nga tavolina tjetër në të njëjtin vendnumërim. Këto shkelje sërish konstatohen nga dëshmitë e vëzhguesve tanë, secila KZAZ duket që ka vepruar në mënyrë atonome në shkelje të Kodit Zgjedhor duke shtuar edhe një herë argumentet pro mundësisë dhe dëshmime që tregojnë se fletët e votimit janë deformuar edhe gjatë procesit të numërimit. Vëzhguesit e akredituar në rastin tim kanë konstatuar fletë votimi të pavlefshme që janë shpallur të pavlefshme pa asnjë arsytim dhe konstastimet tona të aty për atyshme nuk janë marrë parasysh. Madje vëzhguesit tanë janë kërcënuar që do të largohen nga vendi i numërimit kur kanë ngritur këto shqetësime, kërcënimin e kanë marrë nga anëtarët e KZAZ-së, drejtuesit e KZAZ-së sërish për këtë ne kemi dhënë dëshmi me shkrim që janë depozituar në ankesën tonë dhe ju i keni të paraqitura. Vëzhguesit tanë kanë parë raste dhe kanë evidentuar raste kur një fletë votimi është shpallur e pavlefshme ose e vlefshme ku ishte dhe një X pra për kandidatin e pavarur në rastin konkret për mua, të cilat më pas kanë kaluar në dëngun e fletëve të votimit të subjekteve tjera politike. Sërish ne kemi dëshmuar me dëshmi me shkrim nga disa prej vëzhguesve tanë që ne e kemi dorëzuar pranë jush dhe nuk ka nevojë t’iu tregoj sesi kjo bie ndesh dhe me rregulla dhe udhëzimet vet të Kodit Zgjedhor me udhëzimet e nxjerra nga KQZ-ja kështu me rradhë. Ne kemi marrë pamjet filmike të dhëna nga KQZ-ja, kemi arritur të analizojmë rreth 300 orë për Qarkun Tiranë janë 4589 orë, nga këto pamje ne kemi nxjerrë 164 fotografi ku ka një X në rastin konkret për kandidatin e pavarur mua, dhe X-a të tjera për subjekte të tjera politike. Nga këto 164 fletë votimi që ju i keni në formë elektronike, por edhe të printuara 129 raste lidhen me Partinë Socialiste, 28 raste lidhen me Partinë Demokratike dhe raste të tjera me parti më të vogla por janë të papërfillshme si numra. Ne kemi listuar të




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

gjitha qendrat e votimit ku janë evidentuar këto raste pra që janë me dy X-a, tre X-a, katër X-a apo më shumë. Për më tepër në Aneksin 3 të ankesës sonë kemi vendosur dhe 3 fotografi të tjera fletësh votimi nga Gjirokastra dhe nga Lezha, në të treja fotografitë e këtyre dy qarqeve vërehet se ka një X të dytë të vendosur shtesë përveç shenjës X të vendosur në subjektin zgjedhor me numër 13 kandidat i pavarur. Evidentimi në masë i fletëve të votimit me një X të subjektit zgjedhor kandidat i pavarur dhe një X të një tjetri subjekt zgjedhor nuk mund të jetë thjesht një pasojë rastësore e procesit e as thjesht gabim njerëzor. Së pari fletët e votimit me nga një X për dy ose më shumë subjekte zgjedhore janë fenomen i përhapur në të gjithë Qarkun e Tiranës siç dëshmojnë edhe fotografitë e fletëve të votimit në Aneksin 2 që e kemi dorëzuar bashkë me ankesën tonë. Së dyti në shumë prej këtyre fotografive vërehet se ngjyra e bojës së stilolapsit të përdorur për vendosjen e X-it të dytë ose të tretë në fletën e votimit ndryshon në tonalitet nga ngjyra e përdorur për X-in e vendosur për subjektin zgjedhor me numrin 13, si dhe bashkë me ngjyrën ndryshon dhe forma e X-it të dytë ose të tretë të vendosur në fletën e votimit. Së treti, ka një argument të qëndrueshëm që përforcon bindjen se fletët e votimit që kanë nga një X për subjektin zgjedhor kandidat i pavarur si dhe një tjetër X për një tjetër subjekt zgjedhor janë deformuar me qëllim. Ky argument lidhet me faktin se X-i i dytë është vendosur thujtë në të gjitha rastet te një nga dy subjektet kryesore parlamentare, kryesisht te Partia Socialiste por edhe te Partia Demokratike, pra te ato subjekte politike që kishin komisionerë dhe anëtarë në grupet numëruese në vendet e votimit. Vota me një X të dytë për subjektet zgjedhore të reja apo të vogla që nuk kishin komisionerë apo anëtarë në grupet e numërimit janë thujtë inekzistente. Pra nuk ka ngatërresë ku është një X të kandidatit të pavarur numri 13 dhe ta zemë se di Partia e Murrizit le të themi apo një subjekt tjetër zgjedhor. Së fundmi fakti që e njëjta problematikë me dy ose më



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sauksioneve
Dt.25.05.2021*

shumë shenja X shfaqet edhe në Qarkun e Gjirokastrës edhe në Qarkun e Lezhës, dëshmon se keni të bëjmë me një fenomen sistemik të planifikuar dhe jo sporadik i përhapur në të gjithë territorin e vendit por me pasoja më të mëdha në Qarkun e Tiranës aty ku numri i fletës së votimit të shpallura të pavlefshme është 18 mijë e 422. Kujtojmë se në Qarkun e Gjirokastrës secili subjekt zgjedhor kishte ose 6 kandidatë në listë prapë ose në Qarkun e Lezhës vetëm 9 kandidatë në listë. Kështu që nuk ka mundësi që qytetari ta ngatërrojë edhe aty të shtojë numrin 13 duke menduar që po ia jep votën një kandidati të Partisë Socialiste apo të Partisë Demokratike le të themi. Këtë për më tepër ne e kemi dëshmuar një dëshmi me shkrim nga vëzhguesit tanë shumë prej tyre e kanë evidentuar këtë çështje dhe dorëzuar dëshmitë e tyre bashkë me ankesën tonë në KAS. Unë do të kërkoja nga KAS-i edhe mundësinë për të bërë ekspertizë shtesë në lidhje me ndonjë analizë kaligrafike që mundet të përdoret në këtë rast për të vërtetuar pretendimet tona nga çkemi dëgjuar nga përfaqësues të KQZ-së dhe ashtu siç shprehet dhe Kodi Zgjedhor, kjo gjë është e mundshme. Në lidhje me të njëjtën problematikë janë konstatuar raste të shumta të përdorimit të stilolapsit nga ana e grupeve të numërimit, për këtë ka dhe video janë fakte të njohura botërisht por janë dhe prova që ne e kemi dëshmuar në ankesën tonë që ju e keni. Për më tepër sërish vëzhguesit e akredituar tanët kanë depozituar dëshmi me shkrim për këtë lloj shkelje. Shkelje të tilla me stilolapsin në dorë duke vendosur X-a gjatë procesit të numërimit e minojnë gjithë procesin zgjedhor dhe jo thjesht momentin e numërimit të votave. Shkelje të kategorisë së tretë që lidhen me problematikat gjatë procesit të numërimit, në lidhje me rastin kur numëruesit kanë kaluar vota të vlefshme për kandidatin e pavarur në rastin konkret për mua në drejtim të subjekteve të tjera politike. Kjo shkelje vërtetohet me anë të dëshmimeve që ne kemi depozituar nga vëzhguesit tanë të akredituar, por vërtetohet edhe nga pamjet filmike të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

monitoruara prej nesh janë pamje filmike zyrtare të KQZ-së që ne i kemi marrë, i kemi analizuar dhe kemi nxjerrë përshembull te Qendra e Votimit 1607 2 vota janë qartazi të shënuara për numrin 13, nuk janë në tabelën e rezultateve dalin 2 vota më pak. Qendra e Votimit përshembull 1902/2 janë 5 vota që nuk kanë asnjë problem kanë një X shumë të qartë të vendosur tek numri 13 dhe nuk janë marrë parasysh në tabelën përfundimtare të rezultateve. Janë së paku 10-11 qendra votimi që ne ua kemi dhënë si shembull për mënyrën sesi votat që janë dhënë për kandidatin e pavarur me numër 13 thjesht nuk janë llogaritur në fund. Së treti, sigurisht që ka pasur procedura të nxituara gjatë momentit të numërimit, nuk janë treguar kodet e sigurisë, nuk janë treguar fletët për një kohë të gjatë në mënyrë që vëzhguesit të evidentonin se për kë shkonte vota. Shpesh herë nuk janë thënë me zë për të gjitha sërish këto ne kemi dorëzuar dëshmi me shkrim nga vëzhguesit tanë. Një tjetër fenomen i përdorur dhe përhapur masivisht gjatë zgjedhjeve gjatë procesit të numërimit ka qenë se fleta e votimit nga ana e anëtarëve të grupeve numëruese mbahen në mënyrë të tillë ku gishti i madh i dorës mbulonte katrorin e numrit 13. Pra, gjatë videove që secili prej jush mund t'i shikojë një pjesë të këtyre ne i kemi bërë publike përmes fotografive, numërohet fleta duke e mbajtur me dorë pikërisht hapësirën ku duhet të ishte, ku mund të ishte X-i shenja e vendosur nga zgjedhësi në favor të subjektit zgjedhor me numër 13 në rastin konkret kandidati i pavarur unë. Për këtë ne i'u kemi dorëzuar sërish jo vetëm dëshmi nga vëzhguesit tanë, por edhe fotografi të paktën 19 fotografi por mund t'iu sjellim nëse ju kërkoni edhe 90 fotografi të tjera ne i'ua kemi sjellë apo shumë më shumë ne i'ua kemi sjellë thjesht për ilustrim për ta kuptuar sesi gjatë procesit të numërimit mbulohej në mënyrë sistematike katrori numër 13 me gisht që mos shikohej dhe kur ngrihej ankesa nga vëzhguesit tanë të akredituar vëzhguesit tanë kërcënoheshin me largim nga vendi i numërimit. Për më tepër gjatë procesit të numërimit proceverbalet e



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

nënshkuara të rezultateve të numërimit të qendrave të votimit nuk janë dhënë vëzhguesve tanë në shumicën e rasteve nuk janë vendosur në hapësirën e përcaktuar nga KZAZ-ja përkatëse në shkelje të dispozitës të përcaktuar në Kodin Zgjedhor, sërish për këtë ne kemi dorëzuar dëshmi me shkrim nga vëzhguesit tanë të akredituar. Shkelje të tilla ngre dyshimin e bazuar që përmes mungesës së transparencës nga KZAZ-të dhe grupet e numërimit që rezultatet janë shtrembëruar gjatë procesit të numërimit nëpër vendnumërimet dhe se akte të tilla kanë qenë të qëllimshme dhe të paramenduara. Për ta mbështetur dhe më shumë këtë argument ne kemi dhënë një rast nga KZA-ja 38 në Tiranë, ku mungon krejtësisht subjekti 13 në tabelën e votave pra aty ku duhet të vendoset sesa vota kandidati i pavarur numër 13 ka marrë në atë KZAZ në procesverbal në atë tabelë përmbledhëse hapsira për subjekt zgjedhor numër 13 mungon krejtësisht pra jo që janë vendosur votat nuk ka pasur as ku ta vendosi votën anëtari i KZAZ-së, sepse në atë tabelë sipas tyre e prodhonte sistemi nuk duhet të figuronin kandidatët e pavarur dhe unë nuk po flas për momentin kur po numëroheshin votat për secilin kandidat të secilës subjekt zgjedhor, jemi duke folur për datën 26 prill, një ditë pas votimit ku ende po numëroheshin votat për subjektet zgjedhore dhe jo për kandidatët. Ju kemi dhënë përmes ankesës sonë edhe një intervistë që tregon momentin kur kjo ka ndodhur, por edhe kemi depozituar pranë jush një nga anekset e ankesës sonë një nga rastet konkrete, dy procesverbale nga e njëjta KZAZ ku natën e datës 25 prill, numri 13 figuronte në procesverbal, të nesërmen në 26 prill nuk figuronte më. Nuk kemi si e nga ta vërtetojmë nëse votat e dhëna për subjektin numër 13 janë pasqyruar apo jo në tabelën përmbledhëse. Siç iu thashë në fillim të procesit të numërimit në Qarkun Tiranë nuk janë treguar në kamera shumë prej elementeve që do të bënin transparencë për këtë proces, përshembull nuk janë treguar pjesa e pasme e fletëve të votimit ku ndodhet vula në shkelje të rregullave për këtë ekzistojnë dëshmitë,



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

ekzistojnë pamjet filmike duke bërë të pamundur evidentimin e ndjekjes së rregullave gjatë procesit të numërimit. Është një rast ku doja të ndalesha në ankesën tonë, pika 4 e ankesës sonë të cilën unë e kam ngritur si shqetësim edhe në datën 04 Maj 2021, kur në këtë sallë janë shpallur rezultatet paraprake të tabelës përmbledhëse nga Kryekomisioneri. Atë ditë unë kam treguar që në KZAZ-në nr.39 në Tiranë që është Muzeu Historik Kombëtar pra në qendër të Tiranës, për këtë vend numërimi nuk ekzistojnë fare pamjet filmike 360 gradë. Tani pasi e ringrita shqetësimin në datën 04 Maj, mora nga KQZ-ja disa pamje filmike të tjera por që nuk kanë lidhje me pamjet filmike të kamerës 360 gradë me Muzeun Historik Kombëtar kështu që unë ripërsëris pyetjen e shtruar në datën 04 Maj, ju lutem të më ndihmonit të kuptoj ku janë këto pamje. A e ka evidentuar KQZ-ja faktin që mungojnë krejtësisht pamjet 360 gradë? Nëse ndërkohë KQZ-ja i ka marrë këto pamje 360 gradë nga Muzeu Historik Kombëtar ku ka pasur ndalesa të shumta të procesit të numërimit nëse ju kujtohet, na kujtohet se dhe Ambasadorja Amerikane ka vajtur aty në mënyrë që të nxitohet procesi i numërimit në datën 27 prill në mos gaboj për këtë qendër numërimi vendnumërimi në qendër të Tiranës, nuk dimë çfarë ka ndodhur me pamjet 360 gradë. Nuk është e vetmja mungojnë pamjet 360 gradë për KZAZ-në 31, prej datës 26 prill prej orës 17:00, deri në përfundim të procesit. Mungojnë pamjet filmike të kamerës 360 gradë të KZAZ-së nr.33 nga data 26 prill prej orës 02:00 të mëngjesit deri në përfundim të procesit. Është shumë e rëndësishme të kuptojmë çfarë ka ndodhur me këto pamje filmike, sepse unë kujtoj që ato video që ne kemi bërë publike dhe kemi dorëzuar pranë KAS-it, ku evidentohen vendosja e X-ve të dytë, të tretë, të katërt, apo ku di unë sa nga grupet numëruese në fletët e votimit ne i kemi evidentuar pikërisht duke përdorur kamerat 360 gradë. Në mungesë të këtyre kamerave vjen pikëpytja jo vetëm rregullsia e procesit në këto 3 KZAZ, por edhe rezultatet më gjerë në të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankinimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

gjithë Qarkun e Tiranës. Në pikën 5 të ankesës sonë, ne kemi dorëzuar një fotografi, kjo fotografi është fotografia e një flete votimi që mban numrin 13. Kjo fletë votimi është gjetur si duket nga një maturante në Shkollën Arben Broci në qendër të Tiranës pranë Rrugës Myslym Shyri dhe si fotografi ka qarkulluar nëpër rrjete sociale, ne e kemi marrë e kemi bërë pjesë të ankesës sonë. Fotografia tregon fletën e votimit ku është X-i te numri 13 dhe korridorin e Shkollës Arben Broci, maturantja duket se e ka gjetur në mëngjesin e datës 26 prill pra një ditë pas votimit që na jep dyshimin e bazuar që jo vetëm që tashmë është faktuar me prova edhe filmike dëmtimi pra konsumimi i veprës penale, dëmtimi i fletës së votimit gjatë procesit të numërimit. Pra jo vetëm kaq por kemi dyshimin e bazuar përmes kësaj indicie që kutitë e votimit mund të jenë hapur para se të shkojnë në vendet e numërimit, sepse nuk kemi asnjë shpjegim sesi ndodhet kjo fletë votimi në korridorin e Shkollës Arben Broci lehtësisht e verifikueshme nga numri në këtë fletë votimi. Për këtë provë që kemi dorëzuar do të kërkoja mundësinë që të hapen të verifikohen kamerat e qendrës përkatëse të votimit, por pse jo edhe kamerat e Shkollës Arben Broci të korridoreve të shkollës besoj se shkolla duhet të jetë e pajisur me kamera për të kuptuar çfarë ka ndodhur në Shkollën Arben Broci, si është e mundur që gjenden fletë votimi në korridorin e shkollës. Sigurisht nëse vërtetohet nga materialet shtesë është një tjetër argument që minon procesin zgjedhor të jetë e votimit. Për më tepër është përmendur dhe në raste të tjera në pikën 6, të ankesës sonë ngremë shqetësimin mbi faktin se mbi 17 mijë qytetarë të Qarkut të Tiranës, u është mohuar e drejta për të votuar për shkak se ishin të infektuar me Covid-19, organet e shtetit të KQZ-ja nuk ndërrmorën masa për ta mundësuar votimin qoftë në spitale qoftë në vendet ku ishin të karantinuara, 17 mijë qytetarë përshembull për të fituar mandatin kandidati i pavarur ka pasur nevojë për 15 mijë e 500 vota ta zemë. Mendoj që është e rëndësishme në tërësinë e



*Procesverbalet i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

problematikave të evidentuara të ketë parasysh edhe ky rast i përmendur padyshim edhe nga tjerë. Është folur gjerësisht kështu që unë nuk po ndalem në vendimin që u ndërmorr për të ndaluar hyrjen e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë nga Republika e Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut. Do isha ndalur te pika 8 e ankesës sonë e marrë drejtpërdrejt nga raporti i OSBE-së, unë dëshiroj t'ua lexoj duke cituar raportin i cili thotë: Për 25 prillin në Shqipëri u pilotua votimi dhe numërimi elektronik i votave i një prej KZAZ-ve të Qytetit të Tiranës që përfshinte 32 qendra votimi me 23 mijë e ca votues të regjistruar. Procesi i prokurorimit të pajisjeve të votimit u mbyll një muaj para ditës së zgjedhjeve, kurse konfigurimi i programit kompjuterik Softwer një javë para ditës së zgjedhjeve. Pavarësisht objektit të kufizuar pilotimit koha jashtëzakonisht e shkurtër nuk lejoi mundësi për diskutime publike thelbësore apo për një mbikëqyrje të pavarur duke përfshirë dhe nga Shoqëria Civile që janë të dyja komponentë të rëndësishëm për garantimin e besimit në një teknologji të re votimi. Nga 3 deri në 11 prill në demonstrimet publike morën pjesë 547 zgjedhës, megjithatë konfigurimi i fletës elektronike të votimit që u përdor në ditën e zgjedhjeve nuk ishte i njëjti me atë që u demonstrua publikisht. Pra në fillim të prillit testohet një lloj fletë votimi elektronik në një konfigurim të caktuar në një Softwer të caktuar një javë para ndryshon gjithçka dhe votimi elektronik kryhet përmes një konfigurimi krejt tjetër nga ai i testuar me 500 e ca qytetarë, këtë e thotë raporti i gjendjeve paraprake të OSBE/ODIHR-it dhe besoj se këtu gjithkujt i lind e drejta të ngrejë pikëpyetje mbi vlefshmërinë e mënyrës sesi ka proceduar votimi në ato qendra ku votimi ka qenë elektronik me këtë konfigurim fletë votimi të ndryshuar në minutë të fundit. Dua të shprehem sigurisht dhe për pikën 9 në ankesën tonë që është çështja e DATABAS-ës për publike kështu që unë nuk po ndalem dhe pse mendoj se është një nga çështjet tejet të rëndësishme çështja e patronazhistëve, por padyshim në mbështetje do të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

përfshihem edhe vetë për çfarë do lloj ndjekje të mëtejshme të organeve të drejtësisë. Besoj që KAS e ka një lloj rëndësie kjo çështje që të analizohet në tërësinë e provave të dorëzuara, sepse DATABAS-et për publike prek pikërisht Qarkun Tiranë 900 mijë zgjedhës të Qarkut Tiranë, të cilët përmes DATABAS-et publike janë lehtësisht të intimidueshëm apo të frikësueshëm nga Organet e Shtetit ose nga partia që e ka përdorur këtë DATABASE. Sigurisht ja vlen për të përmendur faktin se ka qenë në ligj e drejta për të votuar jashtë shtetit por nuk u arrit që kjo gjë të realizohet në këto zgjedhje për bashkatdhetarët tanë që jetojnë jashtë Shqipërisë dhe pa dyshim që ka pasur një ndikim të rezultati përfundimtar dhe janë dhënë prova të shumta kemi dhënë dhe ne provat tona për keqpërdorimin e punësimeve në Administratën Publike, fondeve publike me synimin për të ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve. Ju falenderoj për vëmendjen por para se ta mbyll besoj se ka dhe interes për pulikun dhe për më tepër edhe për mua si kandidat i pavarur të kuptojmë nëse ndonjë anëtar i KAS-it ose vet KAS-i si organ apo nëse KQZ-ja, sekretariati, komisionerët kanë depozituar kallëzim penal për videot që ne kemi dorëzuar në ankësën tonë si dhe videon e bërë publike dje mbase për këtë të djeshmen nuk ka pasur kohë, por për këto tjerat që janë bërë publike prej datës 26 prill çfarë ka ndodhur, a është ndërmarrë ndonjë masë administrative. A është kërkuar të ndërmerret ndonjë masë administrative? Nëse po a mund ta dimë çfarë mase, nëse jo a mund ta dimë pse jo. A është depozituar ndonjë kallëzim penal për këto raste me videot e KQZ-së jo vetëm me videon tonë amatoriale e bërë publike me 26 prill nga vëzhguesi ynë i akredituar por me videot e KQZ-së dëshmohet deformimi i vullnetit të qytetarëve përmes vendosjes së shenjave nga anëtarët e grupeve numëruese gjatë procesit të numërimit këto janë vepra penale. A ka ndërmarrë ndonjëri prej jush hapa për të bërë kallëzimin penal



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

apo jo? Nëse po a mund ta dimë çfarë është ndërmarrë, nëse jo a mund ta dimë pse jo? Ju falenderoj.

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Abazi për pyetjet që keni në lidhje me këto procedurat që janë ndërmarrë, kur të vijë sekretari i përgjithshëm, ai mund të japë përgjigje në lidhje me se çfarë ka kryer Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më saktë administrata. Ne si KAS jemi organ kolegjal, nuk kemi bërë ndonjë kallëzim penal për Qarkun e Gjirokastrës i kemi kërkuar Administratës së KQZ-së të paktën për ato raste siç ishte rasti i komisionerëve të rezultojnë të kenë votuar dy herë i kemi kërkuar që të procedohet me kallëzim penal. Ndërkohë që siç e cituat dhe ju vetë këto janë të gjitha informacionet publike tashmë se edhe videot që ju keni denoncuar dhe patjetër që Prokuroria kompetente mundet që të nisë ose mund t'i ketë nisur hetimet kryesisht pra të ketë regjistruar një procedim penal për këto raste. Gjithsesi sekretari i përgjithshëm mund të na japë një informacion më të detajuar, në qoftë se nga ndonjë prokurori janë kërkuar prova në lidhje me këto çështje. Nëse nuk ka asnjë informacion të tillë atëherë patjetër unë personalisht nuk e di në qoftë se mbështetem nga anëtarët e tjerë të KAS-it i bëj thirrje Administratës së KQZ-së që të procedojë në lidhje me kallëzimet penale dhe për këto raste në qoftë se nuk është bërë ende. Ndërkohë për sanksionet administrative, Kodi Zgjedhor parashikon që është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ai që propozon sanksione administrative apo masa disiplinore për të gjithë administratën zgjedhore dhe më tej është KAS-i që merr vendim. Deri tani nuk kemi pasur ndonjë kërkesë të tillë, kur të kemi patjetër që do i vlerësojmë në përputhje me ligjin. Atëherë fjala për përfaqësuesin e subjektit Lëvizja Socialiste për Integrim kësaj here në cilësinë e subjektit të interesuar.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit zoti Braho të nderuar anëtarë të Komisionit ne dakortësojmë me atë që është qëndrimi i mbajtur në kërkesën ankimore me objekt “Shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në Qarkun e Tiranës”, nga subjekti zgjedhor PD-AN ndajmë shqetësimet që solli në vëmendje në mënyrën shteruese dhe të themi në qëndrimet e mbajtura në provat e depozituara..

Z. L. Braho: Zoti Kaziaj më fal vetëm një moment që duhet të ndërpres meqënëse Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka njoftuar dje që do të ketë një mbledhje në orën 12:00, në orën 12:00 duhet ta pezullojmë seancën për rreth 15 minuta për t’u rikthyer sërish, kështu që ju vazhdoni deri në orën 12:00 keni kohë që ta keni parasysh.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Domethënë mua më latë vetëm këmbanën e parë zoti Braho..

Z. L. Braho: Jo mund të vazhdoni prapë pas këmbanës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit do të mundohem të jem shterues brenda kohës që më dhatë në dispozicion. Po thojta që dakortësojmë çdo qëndrim të mbajtur nga PD-AN, ne vet si subjekt politik kemi denoncuar pranë Organeve Kompetente qofshin këto hetimore apo administrative të gjitha aferat, paligjshmëritë tentativat dhe qëllimet e arritura nga subjekti qeverisës lidhur me këto zgjedhje dhe në këtë qark. Jemi të gjithë të vetëidjshëm që Qarku i Tiranës përveçse është kryeqyteti është qarku më i madh në Shqipëri dhe domethënë



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

korrespondon me pothuajse 1/4-ën e vendeve në Kuvendin e Shqipërisë. Këtu është luajtur loja më e pisët themi nga ana e Administratës Shtetërore e cila mjafton të bëni ose më mirë të themi kush pa pasur veshë ka dëgjuar në atë periudhë se çfarë ka ndodhur dhe kush ka pasur sy e ka parë se çfarë është bërë në atë periudhë. Mjafton që të shikoni të gjithë Administratën Shtetërore si ka proceduar të paktën gjatë periudhës 4 mujore deri në datën e zgjedhjeve. Pra janë dhënë masivisht leje ndërtime, janë dhënë masivisht certifikata pronësie, leje legalizimesh, pajisje me aktet e marrjes së tokës pronësi. Është bërë publicitet i ndaluar në bazë të një qakti të Komisionit Rregullator të çdo momenti të themi që e kam parë të nevojshëm për interesa partiake dhe elektorale kjo qeveri me çdo mjet, me çdo përfaqësues të saj. Për këtë Lëvizja Socialiste për Integrim ka paraqitur rreth 40 kallëzime në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, po duke qenë se ky numër është shtuar më tej nga kallëzimet e bëra nga subjektet e tjera nga qytetarë apo nga personat e interesuar siç duket Administrata e KQZ-së nuk ka pasur kohën e mjaftueshme t'i shkonte deri në fund atyre kallëzimeve duke bërë në pjesën më të madhe të tyre mosfillim ose pushim të vazhdimt të hetimit administrativ mbase kjo me urdhra partiak të themi. Për raste shumë sporadike administrata e KQZ-së ka marrë vendimmarrje të karakterit sanksionues administrativ vetë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet tyre në qoftë se kanë qenë vendimmarrje të limituara në fund të fundit po gjithmonë vendimmarrje janë. Ka sanksionuar të paktën në dijeninë tonë dy kryetarë bashkish, Kryetarin e Bashkisë Tiranë dhe Kryetarin e Bashkisë Vorë. Ju komision i nderuar si gjithmonë me 3 anëtarët tuaj të nderuar të cilët me dëshirë të madhe dalin kundër vendimmarrjes sanksionuese të përgjegjësve të paligjshmërisë në këto zgjedhje e keni shfuqizuar atë gjobë.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sankcioneve
Dt.25.05.2021*

Z. L. Braho: Zoti Kaziaj pa anatemi për asnjë nga anëtarët, vazhdoni ligjërimin tuaj ju jeni djegur...

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Është e një e vërtetë që ju keni marrë një vendimmarrje apo jo unë nuk zura emra.

Z. L. Braho: Jepni pretendimet tuaja por sot sot është që jam dhe në gjykim në dijenin time Gjykata Administrative e Shkallës së Parë.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Zoti Braho ju lutem se as gongun e kishës nuk do më lini që të bjerë. Tani ose përmbahuni fjalës së parë ose po rrimë të fillojmë pas gongut. Siç keni vepruar gjithmonë pa anatemi sipas zotit Braho, po ashtu LSI ka kallëzuar të themi ngjarjet të karakterit penal pranë Organeve Kompetente qofshin këto prokuroritë pranë rretheve gjyqësore dhe Prokuroria e Posacme. Këto ngjarje kanë ndodhur në dritën e diellit pa asnjë farë logjike nga personat që janë kryer pa asnjë farë frike, se siç duket kanë pasur bekimin që kundër tyre nuk do të ndërmerren asnjë masë në çfarë do lloj karakteri qoftë ajo. Ne i gjejmë të mbështetura të gjitha pothuajse dhe pjesë e asaj kandidati i pavarur relatoi këtu në këto momente, ne nuk jemi njohur me provat e tij ju jeni njohur me to. E dimë se këtu është bërë një masakër, e dimë që në kohën e internetit informacioni është më i shpejtë dhe përcillet lehtë dhe secili prej nesh del në konkluzione në bazë të asaj që vlerëson dhe sheh. Është një shqetësim i madh për Qarkun e Tiranës sesi mund të fitohen 17 mandate pa pasur një program në qoftë se dikush nga ju mund të më thotë një pikë të programit për të fituar 17 mandate. Do e ndërprisja fjalën time edhe përpara se të ma heqë zoti Braho, por unë nuk e di që të ketë një pikë të



*Procesverbal i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

programit që unë si qytetar i Tiranës të them po kjo pikë e programit mua më përllqen se kjo pikë e programit ka të bëjë me të ardhmen e fëmijve të mi.

Z. L. Braho: Mbase të ndihmon zoti Salianji po t'i lesh kohë, do të ndihmojë në pikën e programit.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Për momentin e shoh që heziton gjithsesi.... Kjo është e vërteta e hidhur e një populli të frustruar, e një populli që vidhet nga mëngjesi deri në darkë, një populli që në një mënyrë apo në tjetrën iu diktua të themi ky qëllim final në çdo mënyrë pa frika fare nga ana e përgjegjësve, të cilët e kanë paramenduar këtë arritje. Kjo është shumë shqetësuese nga ana jonë, ne i qëndrojmë çdo gjëje e përsëris për herë të tretë se ka shumë rëndësi ndonëse në këtë prooes jemi si palë e interesuar në mbështetje të kërkesave ankimore të bëra nga ana e kolegëve tanë. Ne i qëndrojmë çdo gjëje që ata kanë parashtruar se vetë ne kemi hasur aq shumë gjëra të paligjshmërisë të nivelit shumë të lartë saqë ky proces ka qenë i deformuar që para nisjes së vet jo më në momentin kur është hedhur vullneti i qytetarit në kutinë e votimit. Shoh që kemi dhe një përfaqësues të OSBE/ODIHR-it vet kjo organizëm ndërkombëtare ka bërë një raport paraprak të themi në qoftë se do të përdorni një ngjyrë krejtësisht ka ngjyrën e zezë ai raport ka gjetur paligjshmëri, parregullsi përfshirje e administratës. Mospërfillje të këtij komisioni jo tuajin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve themi nëpërmjet akteve vendimmarrëse, të cilat limitonin fuqinë e makinerisë që mund të ketë një ekzekutiv, i cili zotëron çdo gjë në këtë republikë po asnjëherë nuk është treguar i vetpërmbajtur të paktën ekzekutivi përkundrazi. Kam programuar në hollësi çdo gjë që në fund të fundit morën ose vodhën nga ajo që kishin vjedhë. Vet Kryetari i Bashkisë ka anatemuar këtë komision pasi nga ana e këtij komisioni ose



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve është marrë masa sanksionuese administrative me gjobë. Vetë ai në dalje publike ka thënë kush janë këta të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve domethënë kush jeni ju të gjithë bashkë këtu që paskeni vendosur një masë administrative kundrejt Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Pra ky është shteti ynë të nderuar anëtarë të komisionit kërkoj që provat e kërkuara nga kolegu Logu të administrohen të merren në shqyrtim të gjitha janë prova të mjaftueshme.

Z. L. Braho: Nuk kemi arritur ende te ajo fazë zoti Kaziaj, t'i parashtrojë një herë provat dhe kërkesat për provat zoti Logu, pastaj mund ta mbështesni ju te prapësimet tuaja.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Zoti Braho e shoh që sot e paskeni filluar ju si relator mund të prisni fjalën faleminderit për herën e tretë që ma ndërprisni vazhdoni se bie gongu po e ndërpres.

Z. L. Braho: Faleminderit ju që respektuat kohën e dhënë, po zoti Salianji fjala për ju.

Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së: Faleminderit për sa u përket ankimeve të paraqitura siç u relatua dhe në këtë seancë në asnjë prej parashtrimeve të relatuara nuk gjen mbështetje nga Kodi Zgjedhor me atë çka parashikon neni 160 nuk u dëgjua nga asnjë shprehje po them pale në ankim se në cilin qendër votimi është shkelur ligji dhe këtë kërkon Kodi Zgjedhor shkeljen e ligjit në qendrën e votimit në një ose disa dhe pastaj kërkohet pavlefshmëria. Këtu ana formale procedurale e kërkesës është në kundërshtim me ligjin. Kodi Zgjedhor nuk parashikon pavlefshmërinë e një qarku, por parashikon pavlefshmërinë dhe shkeljen për



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

qendrër konkrete. Nga të dy ankimuesit nuk u paraqit asnjë shkelje për sa u përket qendrave të votimit. Unë besoj iu kujtoj kolegëve që parashtuan ankimin që fushata elektorale ka mbaruar, këto janë deklarata të rilexuara gjatë fushatës elektorale dhe tashmë këto deklarata politike janë mbledhur dhe paraqiten si fakte në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. E vetmja vlerë që kanë pasur këto kanë pasur në fushatë për deklarimet dhe besoj janë gjykuar nga zgjedhësit shqiptarë këto deklarata dhe tashmë dihet dhe rezultati. Rileximi i këtyre deklaratave besoj nuk mundet të justifikojë ose të përbëjë një provë për të parashtuar para këtij komisioni. Kërkoj që të dy këto kërkesa të rrëzohen, faleminderit.

Z. L. Braho: Mbase nuk ka pasur mbase është e vërtetë ajo që thatë ju.

Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së: Besoj do keni kohë pas 4 vjetësh ta dëgjoni programin prapë se nuk është ky momenti.

Z. L. Braho: Zoti Salianji të them të drejtën nuk kemi interes për programin partish jemi këtu për ligjin. Duke qenë se siç e thashë dhe më parë në orën 12:00 është njoftuar një mbledhje publike e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve mbledhje që sipas sekretarit të përgjithshëm zgjat diku tek 15 minuta. Po e pezullojmë këtë seancë për Qarkun e Tiranës për dy kërkesat ankimore për t'u rikthyer sërish në orën 12:30, për të vijuar me parashtrimet në lidhje me provat që kanë subjektet ankimuese, provat që kanë depozituar apo që do të depozitojnë si dhe kërkesa të tjera në qoftë se ka. E deklarojmë seancën të mbyllur, faleminderit.



Rifillon mbledhja

Ora 12:43

Z. L. Braho: Atëherë, rinisim seancën. Besoj se është duke ardhur dhe subjekti zgjedhor... Zoti Abazi, duhet t'u tërheq vëmendjen edhe në mëngjes me vonesë dhe tani me vonesë. Viojmë me procesin, me shqyrtimin e kërkesave ankimore të subjekteve zgjedhore Partia Demokratike dhe kandidati i propozuar nga zgjedhësit zoti Bojken Abazi. Pasi mbaruam pretendimet, parashtrimet e kërkesave ankimore dhe prapësimet e subjekteve të interesuara, viojmë me relatimin e provave që subjektet ankimore kanë depozituar së bashku me kërkesat ankimore. Me provat shtesë që mund të kenë në lidhje me shqyrtimet administrative dhe me kërkesat për prova në qoftë se kanë të tilla. Viojmë me ju zoti Logu meqenëse kërkesa ankimore e Partisë Demokratike është depozituar e para, faleminderit!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Braho! Për sa i përket provave që ne do të depozitojmë së bashku me kërkesën tonë ankimore, janë të cituara në faqen 86, 87, 88 dhe 89 të kërkesës tonë ankimore. Në qoftë është e nevojshme t'i lexojmë, po i lexojmë, në qoftë se për efekt ekonomi kohe...

Z. L. Braho: Nuk e di për anëtarët e KAS-it, ka nevojë t'i lexojë zoti Logu të gjitha provat që ka depozituar?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Janë 88 prova në numër katër faqe.


Z. L. Braho: Atëherë, zoti Logu që të mos lexojmë të gjitha provat, ne besoj e garantojmë procesin në lidhje me faktin që të gjitha provat do të vlerësohen një nga

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

një dhe më pas në qoftë se do të pranohen për shqyrtim do të jenë pjesë e vendimmarrjes së KAS-it. Mjafton të citoni që keni 88 prova që i keni depozituar së bashku me kërkesën ankimore. Kështu që mund të vazhdoni me pjesën tjetër.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Braho, siç e thashë që janë të cituara në faqen 86, 87, 88 e 89. Janë 88 prova të cilat pata mundësinë dhe ti përmend gjatë parashtrimeve të mia. Kështu që besoj se u ezarua kjo fazë. Për sa i përket provave që ne kërkojmë të merren, po ashtu janë të cituara në faqen 78, 79 dhe 80 të kërkesës tonë ankimore. Janë 20 prova që ne kërkojmë të merren ashtu siç dhe në rastet e mëparshme janë prova të cilat kanë të bëjnë me marrjen e informacioneve zyrtare pranë organeve të administratës publike, në përputhje me nenin 136, pika 3, germa "c" dhe nenin 137, pika 1 të Kodit Zgjedhor. Nga ana tjetër zoti Braho, në përputhje me nenin 136, pika 1, germa "c", kërkojmë gjithashtu që të administrohen nga të dhënat, apo provat që ka vetë në dispozicion Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Të dhënat e kryqëzuara ndërmjet paisjeve të identifikimit elektronik PEI për zonën zgjedhore Qarku Tiranë, por këto të dhëna të krahasohen jo vetëm me të dhënat që janë për qendrat e votimit në Qarkun e Tiranës, por me të gjitha qendrat kudo që ndodhen në Shqipëri. Sigurisht që Qarku i Tiranës duke qenë qarku më i madh në republikë. Ka shumë qytetarë që mund të kenë votuar edhe në Qarkun e Tiranës siç ne kemi informacione, por dhe në qarqe të tjera. Kështu që krahasimi i të dhënave të paisjeve PEI, të kryhet jo vetëm ndërmjet qendrave të votimit të Qarkut të Tiranës, por të kryhet edhe ndërmjet qendrave të votimit kudo në Republikën e Shqipërisë. Teknikisht na është thënë që është proces i mundshëm, kështu që e kërkojmë në listën e provave që ne kemi kërkuar nga ky komision që të administrohen, faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Logu! Zoti Abazi!


Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Faleminderit! Unë e kam shprehur dhe në ankesën e dorëzuar. Një kërkesë për disa prova shtesë. Në se do të mundja ti përmendja dhe me gojë do t'u thoja që ato lidhen me Shkollën "Arben Broci". Ne kemi kërkuar kamerat për qendrën e votimit që është e shënuar në ankesë edhe kamerat e shkollës në lidhje me fletën e votimit të gjetur në koridor të nesërmen e ditës së votimit.

Z. L. Braho: Atëherë, zoti Abazi, përpara se të vijoni me provat e tjera. Ju kërkoni filmimin e qendrës së votimit, nga ku ka dalë ajo fletë votimi, pra nga ajo qendër votimi. Tani ju kërkoni provën që është filmimi i të gjithë ditës në qendrën e votimit përkatëse? Po ashtu kërkoni dhe filmime nga shkolla. Tani..., pra që i përket korridoreve të shkollës ku ka dhe qendra votimi të tjera. Së pari, duhet të sqarojmë administratën në qoftë se ka kamera jashtë qendrave të votimit? Dhe së dyti, na sqaroni se çfarë do të provoni, në qoftë se do t'ua vinim në dispozicion filmimin për qendrën e votimit përkatëse. Pra, ju kërkoni që të njiheni me këtë filmim ta shihni të gjithën dhe pastaj të ngrini pretendimet tuaja në lidhje me këtë? Apo ju kërkoni që ne ta administrojmë si provë dhe ta shohim ne anëtarët e KAS-it filmimin e gjithë ditës në këtë qendër votimi?

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Logu! Fjala për ju zoti Kaziaj!

Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Dyshimi ynë është që kutia e votimit mund të jetë hapur pas procesit të votimit. Këtë dyshim ne e bazojmë në faktin që është gjetur një fletë votimi, nga ajo qendër votimi në korridorin e shkollës.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Kjo që kërkojmë lidhet kryesisht me momentin afër përfundimit të votimit, pra afër orën 19 në mbrëmje. Pamjet brenda klasës, brenda qendrës së votimit që normalisht duhet t'i disponojë KQZ-ja, por që ne s'kemi shanset se aty edhe mund të shohësh se kush voton e kush nuk voton, duke shkelur privatësinë e qytetarëve. Kështu që për të mos hyrë tek dita e votimit, unë e përqëndroj kërkesën time vetëm tek ora 19 e tutje për pamjet brenda klasës e më tej për pamjet e korridorit të shkollës deri në momentin që largohen kutitë e votimit nga shkolla.

Z. L. Braho: Zoti Merkaj, ka pasur kërkesa nga subjekte zgjedhore për marrjen e filmimeve nga qendrat e votimit dhe a kanë qenë të lejuara, në qoftë se do të kishte kërkesa të tilla? A mundej zoti Abazi po ta kishte kërkuar së bashku me filmimet e tjera t'i vihej në dispozicion dhe filmimi për qendrën e votimit? Pyetja tjetër është, a ka filmime të korridoreve të shkollës "Arben Broci" ditën e zgjedhjeve?

Z. Y. Merkaj: Jo, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas vendimeve të Rregullatorit dhe të Komisionerit, kamera duhet të punojë vetëm brenda qendrës së votimit nga ora 7 e mëngjesit deri në orën 19 të darkës me mbylljen e kutive. Për korridoret e shkollave, të paktën KQZ-ja nuk disponon pamje filmike të korridoreve. Në lidhje me kërkesën e parë tuajën, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nuk mund të japë pamjet filmike subjekteve zgjedhore për procesin e votimit të datës 25 prill, të qendrës së votimit.

Z. L. Braho: Po zoti Logu!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Nuk mund të jepen pamjet filmike të qendrave të votimit?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. Y. Merkaç: Në fund të procesit të votimit,

Z. L. Braho: Zoti Logu, për subjektet zgjedhore, nuk mund të merren pikërisht për arësyet që citoi dhe zoti Abazi, që kanë të bëjnë me privatësinë e votuesve. Gjithësesi është një nga provat që në qoftë se kërkohet mund ta konsultojmë në KAS.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Ndoshta, mund ta themi, ajo që mendoj unë se zoti Abazi po parashtronte, ka të bëjë me faktin që pas përfundimit të procesit të votimit, mund të ketë pasur hapje të kutive ...


Z. L. Braho: E kuptova këtë, por gjithësesi, kjo do të jetë pjesë e vendimmarrjes së KAS-it, në qoftë se do të kërkohet..

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Meqenëse jemi pjesë për sa na takon, ne si përfaqësues të PD-AN, e mbështesim kërkesën e zotit Abazi.

Z. L. Braho: Po, pasi të mbarojë zoti Abazi, gjithësesi ju e shprehët mendimin tuaj, po zoti Kaziaj!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Vetëm një kërkesë kisha lidhur me administratën dhe në këtë rast me Sekretarin e Përgjithshëm. Kamerat në qendrën e votimit janë futur për herë të parë në këto zgjedhje, Sekretar i Përgjithshëm, me një akt të karakterit normativ të Komisionit Rregullator. Cili ka qenë qëllimi i këtyre kamerave nga momenti që ne nuk mund të disponojmë, po themi fizikisht, pamjet filmike në një qendër votimi?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. Y. Merkaj: Në bazë të nenit 167 të Kodit Zgjedhor, këto janë në përdorim të KQZ-së për veprime të mëtejshme për të parë se si ka ecur procesi i votimit dhe në se ka pas persona që kanë tentuar të votojnë dy herë. Kjo do të bëhet pas procesit zgjedhor, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Do të përdoren vetëm nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe në rast kur e kërkon prokuroria për hetime dhe veprime penale.

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Merkaj për përgjigjen shterruese. Besoj se ishte e qartë dhe për zotin Kaziaj. Po zoti Abazi, mund të vijoni me kërkesat e tjera!

Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Atëherë, më falni në se e përsëris për ta specifikuar. Duke pasur parasysh çështjen e privatësisë së zgjedhësve, edhe njëherë kërkesa lidhet me orën 19 e tutje, brenda qendrës së votimit, kamerën që disponon KQZ-ja. Pjesa e dytë e kërkesës lidhet me kamerat që ka vetë shkolla. Në dijeninë time në shkollën "Arben Broci" ka kamera që janë të vendosura në korridor. Në qoftë se KAS-i e sheh të arësyeshme, sepse unë e shoh të arësyeshme të kemi mundësi të shohim ato kamera, pas orën 19 deri në nxjerrjen e kutisë jashtë shkolle. Provë shtesë që ne kërkojmë që u përmend dhe pak më herët është mundësia për të pasur ekspertizë mbi fletët e shpallura të pavlefshme të cilat për bindjen tonë janë bërë të pavlefshme pas votimit. Këtë e kemi të shprehur dhe në kërkesë si ankesë. E treta, lidhet sërish me pamjet filmike të tre ZAZ-ve që u përmend pak më herët në ankesë. Muzeu Historik Kombëtar, pamjet e plota filmike. Për ne është e rëndësishme të kemi mundësinë t'i analizojmë. Kjo nuk lidhet me rastin e qendrave të votimit. Është diçka që subjektet zgjedhore mund ta kërkojnë. Këto janë për momentin dhe tjetra që u përmend pak në fillim, përfshirja si provë edhe e faktit të njohur publikisht prej publikimit të djeshëm që u bë të videos në KZA-në 80 në

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*


Gjirokastrë, përfshirjen atij rasti si provë, për të kuptuar dhe eurinë e këaj ngjarjeje meqenëse aty duket se mund të jetë implikuar drejtë për drejtë Ministri i Brendshëm Bledi Çuçi. Unë besoj shumë qoftë se kjo gjë verifikohet tek mënyra se si më tej vlerësohen zgjedhjet jo vetëm në Gjirokastrë, edhe në Tiranë, por besoj dhe më gjerë. Aty kemi të bëjmë me konsumimin e një veprë penale dhe personi që e ka kryer veprën penale, menjëherë pasi mbaron së kryeri veprën penale, kontakton me një numër telefoni ku është shënuar emri i ministrit Bledi Çuçi, faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit, zoti Abazi! Zoti Çefa ka një pyetje.

Z. E. Çefa: Kisha një pyetje për zotin Abazi. Ndoshta, unë mendoj se duhet ta sqarojmë pak këtë fakt, përpara se të vijojmë me vlerësimin e pjesës tjetër të kërkimit për marrjen e provave. Për filmimet e kamerave në shkollën "Arben Broci". Ju thatë që "është konstatuar të nesërmen një fletë votimi e gjetur nga studentët rastësisht në korridoret e shkollës". Pyetja ime është: nëse fizikisht kjo fletë votimi është administruar diku? E keni ju, apo e ka prokuroria? Sepse që ta mbaroj deri në fund. Mund të lindë një dyshim i arësyeshem që mbase ajo nuk ka qenë fletë votimi e vërtetë. Mund të ketë qenë nga ato fletë votimi që janë udhëzuese. Rëndom ka ndodhur që subjekte të ndryshme elektorale, kanë bërë fletë votimi ilustruese për të udhëzuar elektoratin e vet për të votuar në një mënyrë të caktuar dhe për të mos t'i konfunduar këto dy raste, ne duhet të kemi fletën për ta vërtetuar këtë gjë. Më pas eventualisht vendosin nëse është rasti, ne, apo prokuroria, apo kushdo qoftë tjetër organ hetimor kompetent, për të hapur pastaj edhe filmimet.

Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: E kuptoj pyetjen, ju falenderoj për pyetjen. Nuk e kemi fletën e votimit. Arësyeja pse nuk e kemi është se maturantia

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

që e ka gjetur, kur e mori vesh që kjo çështje u bë publike, u tremb. Nuk na e ka sjellë fletën e votimit. Ama çfarë ka ndodhur, po të shihni dhe fotografinë që ne ju kemi dorëzuar, aty vërehet qartë nr. i qendrës së votimit. Ashtu e kemi verifikuar edhe ne. Nuk jemi ndalur vetëm tek si të thuash dëshmia e rrjeteve sociale, e fotos së bërë publike, por kemi parë numrin e qendrës së votimit është lehtësisht e dallueshme dhe lidhet me Shkollën "Arben Broci". Për më tepër aty edhe barkodi duket i rregullt. Ne si subjekt nuk kemi prodhuar fletë votimi të tilla. Mund të ketë prodhuar dikush tjetër, nuk mund të them, por ne jo. Këto janë arësyet pse ne e kërkojmë.


Z. E. Çefa: Kam dhe dy pyetje më saktë për administratën. Nga subjekti ankimues zoti Abazaj, u pretendua që votimi elektronik, apo më saktë konfigurimi i votimit elektronik më atë njësi që është aplikuar në Tiranë, ka qenë i ndryshëm nga ai i testuar dhe i njoftuar paraprakisht. A është i vërtetë ky fakt?

Z. Y. Merkaj: Është i vërtetë sepse kemi pas disa..., fillimisht ideja ishte që të bëhej votimi elektronik me emra, pastaj kemi pas ankesën e subjektit zgjedhor i cili pretendoi me të drejtë që fletët e votimit elektronikisht të ishin ashtu siç ishin dhe fletët e votimit fizikisht. Kështu që u përshtat fleta e votimit fizike me fletën e votimit elektronike.

Z. E. Çefa: Pra, me a kuptova unë, është ndryshuar vetëm konfigurimi..., ose më saktë janë hequr emrat e kandidatëve të subjekteve dhe janë zëvendësuar me numra sikurse ishte dhe në fletën e votimit, apo jo? ky është i vetmi ndryshim, apo jo?

Z. Y. Merkaj: Po!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*


Z. E. Çefa: Dakord! Edhe një pyetje tjetër për administratën. Në ZAZ-në e cila ndodhej tek Muzeu Kombëtar, nga subjekti ankimues u pretendua që nuk kishte kamera 360 gradë, pra që filmonte 360 gradë. Është i vërtetë ky fakt? Nëse nuk ka pas kamera pse nuk ka qenë kamera aty?

Z. Y. Merkaç: Në të gjitha ZAZ-të e Shqipërisë ka pas kamera 360 gradë. Edhe në ZAZ-në n. 39 që i përket Muzeut Kombëtar ka pas kamera 360 gradë të cilat i janë dhënë subjektit ankues. Është hera e dytë dhe e tretë që e kërkon kamerat dhe ia kemi dhënë kamerat, konfirmohet dhe nga Drejtori i IT-së së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që është sqaruar dhe i është dhënë për herë të dytë kamera zotit Bojken Abazi. Nuk e di çfarë pretendon më tepër.

Z. E. Çefa: Zoti Abazi, po!

Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Unë kam pas mundësinë të komunikoj me drejtorin teknik edhe ditën e sotme. Mund të them që bashkëpunimin me të dhe me KQZ-në ka qenë shumë korrekt dhe më janë përgjigjur në kohë në lidhje me këtë çështje me kamerat filmike 360 gradë, përveç këtyre tre rasteve që u përmend. Pra, komunikimi ka qenë i shpejtë, ndihma e tyre ka qenë, për bindjen time, e vlerësueshme dhe i falenderoj për të gjithë asistencën teknike që më kanë dhënë, mua dhe kandidatëve të tjerë të pavarur. Ama ne nuk na janë dhënë asnjëherë, pamjet filmike 360 gradë të Muzeut Historik Kombëtar, të cilat janë pamje aktualisht që ne disponojmë dhe vazhdojnë deri në momentet para se të vijmë kutitë e votimit në Muzeun Historik Kombëtar. Pra, natën e votimit, 25 prill, janë 4 orë, më duket se 7 me 8, 8 me 9, 9 me 10 e diçka e tillë. Këto 4 orë ekzistojnë në këto pamje me 360

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

gradë, ku nuk ndodh asgjë aty, sepse ende nuk kanë ardhur kutitë e votimit. Nga momenti që vijnë kutitë e votimit ne nuk kemi më pamje. Pra, mungojnë krejtësisht deri në përfundim të procesit. Në se KQZ-ja i ka këto pamje, unë nuk them, kjo mund të jetë çështje teknike, nuk jam duke vendosur ndonjë verdikt. Unë thjesht do të përpiqem, ne na intereson që t'i kemi ato pamje, të kemi mundësinë të vlerësojmë çfarë ka ndodhur.

Z. E. Çefa: Tani meqenëse kjo çështje u bë pak enigmatike, ja vlen që ne ta sqarojmë deri në fund. Besoj se ndoshta kur ne të tërhiqemi për të vlerësuar provat, administrata mund të komunikojë me zotin Abazi për ta sqaruar defenitivisht këtë problem. Kur ne të rimarrim seancën pastaj dhe ne vetë jemi të... u bë pak çështje enigmatike.

Z. Y. Merkaç: Për ne zoti anëtar i KAS-it është i sqaruar, i kemi dhënë të gjitha pamjet. Janë të plota pamjet, edhe procesi i numërimit është i plotë.

Z. E. Çefa: Dakord, nuk dëshiroj të përdor këtë term, por dikush njëra nga palët nuk po thotë të vërtetën, me gjithë respektin, pa dash me paragjykuar asnjë. Dakord, ndoshta zoti Abazi duhet të bësh një inventar të atyre filmimeve që keni.

Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Unë nuk dua ta kthej këtë çështje në "çfarë të kam thënë, e çfarë më ke thënë". Mënyra se si jepen videot janë në mënyrë dixhitale. Kështu që këtu do të jetë fjala ime kundër dikujt tjetër që pretendon se mi ka dhënë. Unë nuk kërkoj të futem në këtë debat. Unë kërkoj thjesht që sekretariati i KQZ-së le t'ia dorëzojë KAS-it pamjet e këtyre tre ZAZ-ve, në formë elektronike të lexueshme për të gjithë ata që janë të interesuar. Unë vetëm këtë po

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

kërkoj. Pra, në qoftë se qenkan dorëzuar, unë nuk i disponoj. Nuk po them, mund të kenë humbur rrugës, dakord! Është hera e dytë që unë e ngre si shqetësim, sepse nuk i kemi këto pamje. Në se sekretariati mund ti sigurojë dhe t'i dorëzojë pranë jush që të mos kemi nga ato çështjet "ti dhashë, nuk t'i dhashë", atëherë nuk ka asnjë problem., faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Abazi, po zoti Logu!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Dy gjëra, sepse pak më parë ndoshta nuk u përmend. Ashtu siç keni relatuar edhe për prova që ne kemi depozituar në Qarkun e Shkodrës dhe meqenëse jemi në të njëjtat kushte të nenit 136, pika 1, germa "c". Ne i kemi vënë në dispozicion për Qarkun e Shkodrës, nëse mund të merren nga administrata zgjedhore, ose ne mund t'ua vemë përsëri në dispozicion 100 kërkesa që ka depozituar Partia Demokratike në datën 15 Maj 2021, drejtuar institucioneve në lidhje me marrjen nga ana jonë të provave që ne i vlerësojmë të rëndësishme për këto procese, së bashku me mandatet postare. Kështu që në administrimin e provave që do të bëhet nga ana juaj, do të kërkoja që të administronit dhe këto prova, në mënyrë që më pas të mos ketë aludime se subjekti zgjedhor PD-AN nuk e ka ezauruar rrugën e kërkimit dhe të provave. Ndjesë, pika e dytë zoti Braho, meqenëse jemi palë ankuese në këtë proces, ne jemi plotësisht dakord me çdo kërkesë të subjektit zgjedhor, kandidat i pavarur, zoti Bojken Abazi, për të cilat besojmë për sa kohë që janë të mundshme dhe janë në dispozicion të KQZ-së, mund dhe të merren për një kohë të shkurtër dhe le të bëhet një transparencë e plotë për çdo pretendim që ngrihet nga palët. Kështu që në këtë kuptim nga ana e PD-AN mbështeten plotësisht këto kërkesa, faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Logu! Nuk di ka ndonjë pyetje tjetër nga anëtarët e KAS-it, para se të kalojmë tek zoti Kaziaj për ndonjë prapësim që mund të ketë në lidhje me provat? Unë në fakt kisha një pyetje zoti Abazi, sepse e cituat disa herë që “vëzhgues të subjektit tuaj zgjedhor, janë penguar të marrin pjesë në procesin e numërimit në KZAZ”. Keni ndjekur ju ndonjë procedurë ankimore në lidhje me gjithë këto raste kur janë penguar nga Policia e Shtetit, apo nga KZAZ-ja?

Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Të them të vërtetën duke qenë se kjo ka qenë hera e parë që unë po garoj në zgjedhje, e kemi pas shumë të vështirë të ndjekim këtë çështje që lidhet me depozitimin e ankesave. Ne kemi mbajtur evidentim të tyre dhe kemi menduar që në momentin kur i depozitojmë është ky, kur depozitojmë ankesën tonë të plotë me gjithë këto raste. Çfarë kemi bërë është që kemi lajmëruar mediat. Unë kam kontaktuar brenda KQZ-së, përfaqësues të ndryshëm në KQZ për tu njoftuar se këto raste po ndodhin. Në rastin e Shkollës “Bajram Curri” aty erdhën në fakt staf i KQZ-së për të parë se çfarë po ndodhte dhe as ata nuk u lejuan të hynin brenda, nga policia. Pra, stafi i KQZ-së i ardhur aty pasi unë komunikova me KQZ-në që po ndodhte kjo situatë, nuk u lejua. Po flas për orën 1, 2 e mëngjesit, data 26 Prill, duke u gdhirë e Hënë, nuk u lejua të hynte me urdhër të drejtuesit të KZAZ-së, përmes veprimeve të Policisë së Shtetit. Kjo ka qenë situata. Pra, komunikimin e kam bërë përmes telefonit, kryesisht për raste të tilla.

Z. L. Braho: Faleminderit, një pyetje tjetër, po tek qendra e votimit në Shkollën “Arben Broci” ku ju pretendoni se mund të kenë ndodhur veprime të jashtëligjshme gjatë ditës së zgjedhjeve, ose në përfundim të ditës së zgjedhjeve, keni pas vëzhgues të subjektit tuaj?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Jo nuk kemi pas vëzhgues aty.

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit!

Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Faleminderit!

Z. L. Braho: Zoti Kaziaj mund të vazhdoni në qoftë se keni prapësime në lidhje me çështjen e provave.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Unë jam dakord me ato që u relatua nga zoti Logu për sa i përket pjesës së provueshmërisë së provave të mbajtura dhe qëndrimit në tërësi lidhur me këtë qark.po ashtu ndaj shqetësimin tim për sa u relatua dhe sa kanë depozituar në cilësinë e provave materiale kandidati i propozuar nga zgjedhësit, në këtë rast zoti Bojken Abazi. Në kuadër të transparencës së procesit, të besueshmërisë së procesit, kërkesat e tij janë të ligjshme dhe të logjikshme. Duhet t'i vihet në dispozicion, pavarësisht se Sekretari i Përgjithshëm thotë që disa nga provat e listuara nuk mund të merren si të tilla dhe të vihet administrim administrativ përpara këtij organi kolegjal. Shqetësimet e sjella nga zoti Abazi, ndahen dhe nga ana jonë, janë të karakterit, le të themi, shumë fyes deri diku, të jashtëligjshëm po e po. Mos lënia qëllimisht e përfaqësuesve të tij, vëzhguesve nëpër qendrat dhe ZAZ-të përkatëse, apo në vendet e numërimit të votave, besoj se i ka sjellë atij një dëm. Normalisht jo vetëm atij, por gjithë besueshmërisë së procesit, një dëm të konsiderueshëm. Këto argumenta duhet të mbahen parasysh edhe nga përfaqësuesi i OSBE/ODIHR-it që e kemi të pranishëm, i cili me objektivitet duhet t'i shqyrtojë ato. Ashtu si dhe ky komision duhet t'i shqyrtojë me objektivitet të gjitha kërkesat e ligjit. Risitë e reja të futura së fundmi me ndryshimet e bëra në ligjin 101/2020 dhe

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

më pas në ligjin abuzues të bëra nga mazhoranca duke thyer atë që ishte besimi i Këshillit Politik me ligjin 118/2020, që kanë të bëjnë në thelbin e tyre me garanci të mëtejshme nëpërmjet futjes së teknologjisë në zgjedhje. Nuk duhet të jenë mjet ndalues për forcat politike, ose në këtë rast për kandidatin e pavarur, por duhet të jenë mjet aksesues, lehtësues, i pozitës së çdo subjekti që ka interes të ligjshëm në një proces administrativ të karakterit elektoral në këtë rast. Pra, teknologjia duhet të na vinte në dihmë se kjo ka qenë fryma e ligjvënësit, jo të ishte pengesë siç po e bën Sekretari i Përgjithshëm. Sekretari i Përgjithshëm për çdo kërkesë që është bërë këtu, ose nuk ka pas dijeni, ose ka dalë një penges për një proces hetimor administrativ të karakterit ...


Z. L. Braho: Zoti Kaziaj, do të më duhet përsëri të të tërheq vëmendjen. Nuk jemi këtu për t'i bërë gjyqin Sekretarit të Përgjithshëm, ju lutem prapësimet në lidhje me provat dhe vendos KAS pastaj do të bëhet transparencë apo jo për të gjitha ato që pretendon zoti Logu dhe zoti Abazi.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Zoti Braho, vazhdoni të më ndërprisni fjalën. Nuk jemi as në orën e përcaktuar për këmbanat në këtë rast, por më lini të vazhdoj. Ju preka një pikë të dobët Sekretarin e Përgjithshëm tuajin. Më lini të them mendimin tim të lirë...

Z. Y. Merkaçaj: Sekretari i Përgjithshëm zbaton urdhërat e KAS-it, ju lutem!

Z. L. Braho: E muarët përgjigjen zoti Kaziaj dhe është e vërtetë.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*


Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jo nuk e mora, ajo ishte ndërhyrje. Ndërkohë që po flisja unë, Sekretarit të Përgjithshëm nuk i tha KAS të ndërpriste zotin Kaziaj..

Z. L. Braho: Në qoftë se e keni vënë re edhe nga takime të tjera, në çdo rast që Sekretari i Përgjithshëm ka dalë tej kompetencave të veta, duke bërë interpretime, i kemi tërhequr vëmendjen. Në këtë rast tha atë që do të thotë gjithmonë, pra zbaton urdhërat e KAS. Kështu që ju lutem, vazhdoni me prapësimet për prova dhe në qoftë se do të vendoset nga KAS për t'u marrë ndonjë provë do të jetë patjetër gatishmëria e Sekretarit të Përgjithshëm siç ka qenë gjithmonë.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit zoti Braho, siç duket e shohim në këndvështrime të ndryshme, gjithsesi po vete tek thelbi siç thashë dhe në fillim të fjalës sime jam plotësisht dakord me provat e kërkuara qoftë nga përfaqësuesi i subjektit PD-AN qoftë nga kandidati i pavarur i cili ka interes të ligjshëm dhe e ka bërë atë që është "lufta e vet" për ta arritur qëllimet e pasura nga propozuesit. Provat janë shteruese, duhen marrë të gjitha edhe ato që zoti Logu relatoi për të cilat në bazë të Kodit Zgjedhor i është kërkuar institucioneve përkatëse, informacion i detajuar lidhur mbi problematika të caktuara. Pra, ka shteruar atë që është të themi një kërkesë e kodit gjë të cilën ju e nxorrët në seancat e mëparshme duke kërkuar vet atij nominalisht në qoftë se ai ishte ose subjekti që ai përfaqëson e kishte shteruar këtë rrugë të karakterit administrativ. Kështu në përfundim të fjalës sime kërkoj që të merren, të administrohen të gjitha provat e kërkuara si nga zoti Abazi si nga zoti Logu.

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Kaziaj në qoftë se nuk ka ndonjë pyetje nga anëtarët e KAS-it? Tërhiqemi për vendim në lidhje me vendimmarrjen për provat e

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

depozituara nga palët. Kërkesat që palët bëjnë për prova në zbatim të nenit 136,137 të Kodit Zgjedhor dhe do të rikthehemi në orën 13:30 për të shpallur vendimin në lidhje me provat e depozituara dhe ato të kërkuara. Para se ta mbyllim një pyetje për IT në qoftë se do të vendoset për t'u administruar prova që kërkohet nga zoti Abazi që ka lidhje me kamerën e qendrës së votimit. Zoti Abazi na ndihmon dot me numrin e qendrës së votimit dhe një herë?

Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Ato janë të shënuara dhe në ankesë po i hap që të mos bëj ndonjë gabim.

Z. L. Braho: Sa ta gjeni ju atë sa kohë do të duhet për ta administruar si provë vetëm pjesën nga ora 19:00 e në vijim sa ka punuar kamera?


Z. N. Mezini, Drejtor i IT në KQZ: Për të marrë kamerën në qendrën e votimit do të duhet 24 deri në 48 orë për arsye se janë në Lundër duke u ekstraktuar. Mund të jetë një nga kamerat që ne e kemi regjistruar tashmë. Kemi regjistruar deri tani..., kemi kopjuar rreth 3 mijë nga 5 mijë e 199, mund të jenë tek ato 3 mijëshet e duhet shumë më pak kohë na kërkon kohë ekstraktimi pak.

Z. K. Bele: Më fal kisha një pyetje mu duk sikur tha Sekretari i Përgjithshëm që kamerat kanë punuar deri në orën 19:00 pasdite.

Z. N. Mezini, Drejtor i IT në KQZ: Po.

Z. K. Bele: Dhe si provohet po themi çfarë ka ndodhur? Janë instruktuar në orën 19:01 ta fikin?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. N. Mezini, Drejtor i IT në KQZ: I nderuar zoti Bele pyetja ishte për sa kohë e marrim kamerën? Besoj e marrim nga ora...

Z. K. Bele: Bëra një pyetje shtesë...

Z. L. Braho: Besoj se kjo i jep më shumë zgjidhje, ka punuar kamera pas orës 19:00.

Z. N. Mezini, Drejtor i IT në KQZ: Pas momentit të mbylljes së qendrës së votimit kamerat nuk kanë regjistruar për arsye, sepse janë hequr nga ushqimi kështu që...

Z. L. Braho: Pra, procesi i mbylljes së kutisë së votimit, procesi i mbylljes së materialeve zgjedhore nuk është pjesë e filmimeve?


Z. N. Mezini, Drejtor i IT në KQZ: Aty varet nga operatori domethënë në qoftë se e ka hequr më vonë por unë besoj se nuk ka pse të ketë regjistrime mbasi është mbyllur votimi në një qendër votimit.

Z. K. Bele: Pra, ky ka qenë instruksioni për operatorët.

Z. N. Mezini, Drejtor i IT në KQZ: Logjikisht kur mbaron votimi normalisht ai ka mbyllur procesin se kamera ka qenë vetëm për procesin e votimit në qendrën e votimit.

Z. L. Braho: Deri të votuesi i fundit?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. N. Mezini, Drejtor i IT në KQZ: Deri te votuesi i fundit sidoqoftë në qoftë se ju do e administroni si provë ne e marrim dhe ua servirim.

Z.L.Braho: Zoti Abazi në qoftë se jemi në këto kushte ju keni më interes për këtë provë? Apo si doni që të jetë? Doni ta administroni?

Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Nuk e dëgjova mirë herën e parë mendova se u tha në orën 23:00 e natës që kanë thënë në orën 19:00. Unë kam një pyetje pse nuk është menduar që të vazhdojë të funksionojë kamera gjatë procesit që mbyllen të gjitha procedurat dhe futen nëpër zarfe dhe kutitë le të themi materialet zgjedhore. Nuk është menduar e rëndësishme kjo pjesë?

Z. L. Braho: Nuk është kamera 360 gradë? Kamera e qendrës së votimit?


Z. N. Mezini, Drejtor i IT në KQZ: Kamera e qendrës së votimit është e drejtuar në një kënd ku të respektohet e drejta e votës, fshehtësia e votës dhe pamja e qendrës së votimit.

Z.L.Braho: Kush është drejtimi i këndit sheh vetëm një komisioner apo operatorin?

Z. N. Mezini, Drejtor i IT në KQZ: Përballë kutive të votimit duke ruajtur sekretin e votimit.

Z. K. Bele: Pra kamera ka qenë përballë dhomës së fshehtë dhe nuk shikonte nga tavolina e administratës zgjedhore sipas jush?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. N. Mezini, Drejtor i IT në KQZ: Çfarë ka kapur këndi i pamjes e ka kapur logjikisht, kurse në qoftë se më lejoni një sqarim është zbatuar rigorozisht akti i Rregullatorit mbi përdorimin e kamerave në qendër votimi. Kështu që dhe orari i mbylljes është....

Z. L. Braho: Faleminderit duke qenë se e shtymë dhe 5 minuta këtë çështje do të tërhiqemi për t'u kthyer në orën 13:35.

Z. K. Bele: Më fal për të ndihmuar procesin meqënëse na kanë ardhur këto të Durrësit edhe është e disata herë që na vijnë PEI në të cilat janë të sigluara nga menaxheri i projektit, unë mendoj që do të duhet që këto të siglohen ose të kenë një shkresë apo qoftë dhe një sigël nga KQZ-ja mbasi ne praktikisht ia kërkojmë administratës dhe jo menaxherit sigurisht ai e përgatit por mendoj që duhet të vijë ai...

Z. Y. Merkaj: Menaxheri është pjesë e administratës, është specialist këtu.


Z. K. Bele: Dakord po nuk kemi numër protokolli nuk kemi vulë që do të thotë do të duhej një shkresë përcjellëse juaja që kjo do të japë..., ka të bëjë me ekstremitete dhe përçueshmërinë e shkresës.

Rifillon mbledhja

Ora 13:47

Z. L. Braho: Për të gjitha këto kërkesa ankimore dhe për provat që kërkohen të merren shtesë, KAS-i, Vendosi: Të administrojë të gjithë provat e depozituara nga

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

palët ankimore, së bashku me kërkesat ankimore dhe ato që u depozituan sot në seancë nga përfaqësuesi i PD – AN-së. Të rrëzojë kërkesën e kandidatit propozuar nga një numër i caktuar zgjedhësish, zotit Boiken Abazi për të kryer ekspertizë në lidhje me një sërë fletësh votimi që janë pjesë e materialeve zgjedhore për Qarkun Tiranë. Të rrëzojë me shumicë votash kërkesën e subjektit zgjedhor koalicionit PD –AN për kërkimin e 19 provave shtesë në bazë të nenit 137 të Kodit Zgjedhor. Të rrëzojë me shumicë votash kërkesën e subjektit zgjedhor zotit Boiken Abazi për administrimin e kamerave të shkollës “Arben Broci”, po ashtu dhe të qendrës së votimit në këtë shkollë. Në zbatim të nenit 36 të Kodit Zgjedhor, pika 2, dy anëtarë të KAS kërkojnë që materiali që është kqyrja e pajisjeve të identifikimit biometrik për Qarkun Tiranë, brenda përbrenda Qarkut Tiranë dhe bashkë me të gjithë qarqet e tjera, të administrohet si prove. Po ashtu kërkojmë që materialet filmike nga ora 18:50 dhe deri sa të ketë funksionuar kamera në qendrën e votimit pretenduar nga kandidati i propozuar nga zgjedhësit, zoti Boiken Abazi, po ashtu të administrohet si prove, t’i vihet në dispozicion kandidatit dhe KAS-it. QV-në që është cituar në ankimin e zotit ...

Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Mund t’ua them sërisht.

Z. L. Braho: Vetëm numrin e qendrës.

Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Janë tre qendra votimi

Z. L. Braho: Jo atë zoti Abazi, për qendrën e votimit në shkollën Arben Broci.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

Z. B. Abazi, kandidat i propozuar nga zgjedhësit: Më falni, një sekondë, ua gjej menjëherë. Është Qendra e Votimit 1907/1.


Z. L. Braho: Për këtë qendër votimi. Ndërkohë në lidhje me pretendimet që ngriti zoti Abazi në lidhje me filmimet e KZAZ-ve, duke qenë se kishte paqartësi nga kandidati dhe meqënëse nga administrata pretendohet që janë dhënë, unë do të propozoj që kjo çështje të zgjidhet jashtë kësaj seance dhe të bëhet dhe një rakordim në lidhje me këto prova, në mënyrë që zoti Abazi të ketë mundësinë që atë se çfarë pretendon t'a relatojë së bashku me konkluzionet përfundimtare të kërkesës së tij ankimore. Kjo seancë do të pezullohet deri në vënien në dispozicion të provave që u kërkuan nga KAS dhe me vënien në dispozicion të tyre do të riçelet kjo seancë, në mënyrë që të vijojmë me pretendimet përfundimtare. Zoti Bele në lidhje me vijimin e seancës për Qarkun Shkodër duke qenë se ju jeni relatori.

Z. K. Bele: Atëhere, do të rikthehem sot në seancë në orën 17:00 ku do të vijojmë me kërkesat ankimore të Qarkut Durrës dhe me të mbaruar Qarku Durrës, do të vijojmë dhe me kërkesat ankimore të Qarkut Shkodër, po ashtu t'i mbyllim sot. Në lidhje me pavlefshmërinë. Ndërsa për Qarkun Durrës gjithmonë për vendimmarrjen e ndërmjetme, për pavlefshmërinë.

Z. L. Braho: Nëqoftëse zoti Kaziaj do të mund të jetë gati për të relatuar dhe kërkesën...

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Unë besoj se procesi nuk ka nevojë për vonesa të mëtejshme dhe ju besoj se jeni gati për komision, në mënyrë që nëqoftëse do të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.25.05.2021*

pranohet nga ana juaj të vazhdohet me numërimin që nga dita e nesërme. Unë jam gati, kështu që mund t'a bëjmë pas orës 17:00.

Z. L. Braho: Kjo ishte me kusht që ti të jesh gati për relatimin, a do të vendoset për numërim apo jo...

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po patjetër, unë thashë vendimmarrja nga ana juaj do të pranohet, patjetër.

Z. L. Braho: Dakord zoti Kaziaj, atëhere edhe njëherë rimblidhemi në ora 17:00.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

